

**UNITED
NATIONS**
United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**T R A N S K R I P T I
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 21 DHJETOR 2006**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 21. DECEMBRA 2006.GOD.**

DHJETOR –DECEMBAR 2006

RENDI I DITËS

1. Debat sipas kërkesës së Grupit Parlamentar për Integrim lidhur me vendimin për shtyrjen e zgjidhjes së statusit politik të Kosovës,
2. Debat sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së lidhur me gjendjen energjetike në Kosovë.

DNEVNI RED

1. Rasprava o zahtevu Parlamentarne grupe za integracije u vezi sa odlukom o odlaganju utvrđivanja političkog statusa Kosova,
2. Rasprava o zahtevu Parlamentarne grupe DPK u vezi sa energetske stanjem na Kosovu.

AGENDA

1. Debate base to the request from Parliamentary Group for Integration on the decision made regarding the postponement to solve the political status of Kosovo,
2. Debate base to the request made by the PDK Parliamentary Group regarding the current situation of electricity in Kosovo.

Mbledhjen e kryesoi kryetari i Kuvendit Kolë Berisha.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Të nderuar deputetë, të nderuar ministra, mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës. Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 81 deputetë, prandaj mund të fillojmë me punë.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI - Z. kryetar, të nderuar deputetë.

E kërkova fjalën për t'i shprehur shqetësimet e mia, shqetësimet e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, shqetësimet e qytetarëve të Kosovës për ndodhjen kriminale të ditës së djeshme në komunën e Drenasit. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës nga fillimi i kësaj legjislature ka shtruar nevojën dhe domosdoshmërinë që institucionet e Kosovës të merren seriozisht me çështjen e sigurisë në Kosovë ,me krimin e organizuar të instaluar në institucione. As Parlamenti dhe as Qeveria shqetësimet tona asnjëherë dhe në asnjë kohë nuk i kanë marrë seriozisht. Si duket të gjithë jemi të shqetësuar përveç Qeverisë dhe kabineti qeveritar që sipas të gjitha gjasave edhe politika është e inkriminuar në krimin e organizuar, janë të inkriminuar në krimin e organizuar institucionet që duhet ta luftojnë krimin. Institucionet që duhet t'i zbardhin veprat edhe të krimit politik edhe të krimit ekonomik. Politika është ajo që duhet të merret me krimin e organizuar, me krijimin e hapësirës së sigurisë në Kosovë, me ndërtimin e institucioneve të përgjegjshme për t'i luftuar dukuritë negative dhe këtë përgjegjësi nuk e kanë vetëm Qeveria, Ministria e Rendit dhe Ministria e Drejtësisë. Të nderuar deputetë këtë përgjegjësi e kanë partitë e koalicionit qeverisës, për faktin se në asnjë kohë nuk kanë qenë të gatshme ta dëgjojnë zërin e arsyeshëm të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Duhet ta dini që as partitë demokratike të koalicionit e as Qeveria dhe as kryeministri nuk mund të tejkalojnë situatën e inkriminimit në institucionet e Kosovës me deklarata politike.

Qeveria dhe ministrinë përkatëse duhet të veprojnë mbi bazën e ligjeve dhe mbi bazën e përgjegjësisë që e kanë marrë nga qytetarët e Kosovës dhe nga ligjet në fuqi. Askush më nuk mund të thotë se Qeveria dhe ministrinë janë pak të papërgjegjshme dhe nuk mbajnë përgjegjësi për maskat, për krimin e organizuar dhe për armët që barten nëpër Kosovë, kundër kujt mbahen ato armë? Ne kemi qenë të bindur se maskat janë të grupeve ordinere që shfrytëzojnë emra për të plaçkitur qytetarët, por nuk kemi dashur të besojmë se maskat dhe armët në Kosovë kundër Kosovës barten me automjetet e Qeverisë .Qeveria sot do të duhej të del dhe ka obligim që të del para këtij Parlamenti me një informatë të detajuar që edhe ne si Parlament dhe qytetarët e Kosovës të dinë çka po ndodh në Kosovë dhe kryeministri që sot është dashur të na informonte edhe për masat që i ka marrë kundër të gjithë atyre që janë të implikuar në këtë vepër kriminale, por ai sot as që ka ardhur në seancën e Parlamentit. Unë kërkoj që kjo çështje të shtrohet si pikë më e ngutshme për debat dhe ministri i rendit si njeri i parë përgjegjës për rendin në Kosovë të na informonte dhe mbi bazën e kësaj informate ky Parlament sot të debatojë për çështjen e sigurisë në Kosovë dhe për shkallën e inkriminimit të njerëzve të Qeverisë dhe të subjekteve politike në këtë vepër kriminale. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Z. Krasniqi, ju kisha lutur që fjalët kriminale dhe kriminalitet dhe inkriminim t'i hiqni nga fjalori dhe të mos hyjnë në transkript, të përdoret një fjalor parlamentar.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, unë jam i gatshëm ta tërheq fjalën, por nuk e di a më të rënda janë veprimet apo fjalët, nëse fjalët janë më të rënda se veprimet unë e tërheq fjalën.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e ka Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar i Kuvendit.

Që nga dita e konstituimit të Kuvendit të Kosovës Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës është deklaruar se fuqimisht angazhohet për transparencë institucionale, për sundim të rendit dhe të ligjit dhe me këtë rast ne e rikonfirmojmë përcaktimin tonë. Ne jemi ai grup që kemi kërkuar debat për siguri dhe është zhvilluar ai debat dhe për çështje të sigurisë ,si njëra prej çështjeve më të rëndësishme për zhvillimin e institucioneve demokratike të Kosovës. Ne një kërkesë të tillë do ta mbështesim sa herë që të jetë e nevojshme. Me këtë rast e kundërshtojmë fuqimisht deklaratën e mëparshme të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës për akuza pa kryerje të hetimeve.

Mendoj se vlerësimet e tilla janë ekskluzivisht politike, ne duhet t’u japim kohë organeve të rendit që ta kryejnë punën e vet dhe pas të gjeturave ne mund të debatojmë. Ne kemi një Qeveri të koalicionit dhe ne nuk kemi Qeveri të krimit, ne qëndrojmë fuqimisht për mbikëqyrje parlamentare të të gjitha institucioneve të Kosovës, por ju lutem të mos keqpërdoret foltorja e Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Naim Maloku.

Për replikë paraqitet Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Unë nuk kam pritur nga ata që nuk e kanë gatishmërinë vërtet që të angazhohen për një rend, për një qetësi dhe standarde për qytetarët e Kosovës. Unë e di që nuk është lehtë për Grupin e LDK-së ,i cili në kontinuitet ka votuar shumë paligjësi në këtë parlament dhe tenton ta hedhë përgjegjësinë në deklaratën e Grupit të PDK-së. Z. Gashi nuk mund t’i ikni përgjegjësisë se në këtë vepër të ndaluar dhe të rrezikshme për proceset politike në Kosovë është e implikuar Qeveria që gjithëherë keni votuar paligjësitë e kësaj Qeverie.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Naim Maloku.

DEPUTETI NAIM MALOKU - Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë, ministra. Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së të përgëzoj Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Policor të Kosovës, KFOR-in, UNMIK-un dhe të gjitha segmentet e tjera legale të sigurisë në aksionin e identifikimit, kapjes dhe parandalimit të veprimeve të paligjshme në Kosovë, ky aksion përfundoi në ditën e djeshme me një ngjarje të rëndësishme, por ende nuk ka përfunduar në tërësi.

Z. kryetar, Qeveria e Kosovës ka marrë kompetenca në rend dhe siguri, por ka filluar të marrë edhe kompetenca në këtë vit, krejt çka mund të bëj ky parlament, është mirë që t’i

japë mirënjohje ministrit të Punëve të Brendshme, për punën dhe angazhimin e tij në ngritjen e strukturës së Ministrisë së Punëve të Brendshme në fuqizimin e Shërbimit Policor të Kosovës, në vënien nën kontroll dhe mbikëqyrje të segmenteve legale të sigurisë, në krijimin e rrethanave dhe parakushteve që segmentet vendore të sigurisë të përballen me efikasitet dhe fuqishëm kundër të gjitha veprimeve kriminale që kanë ndodhur dhe që do të ndodhin në të ardhmen në Kosovë. Grupi Parlamentar i AAK-së mbështet dhe u jep përkrahje drejtësisë dhe rendit dhe u japim mbështetje hetimeve të mëtutjeshme, çdo keqpërdorim dhe dalje jashtë ligjit duhet të dënohet dhe çdo individ pavarësisht në cilin nivel të përgjegjësisë është, duhet të përballlet me veprimet dhe mosveprimet e veta të ndërmarra në të kaluarën, por edhe tash.

Z. kryetar pas luftës Kosova ka qen pa ligje, shumë individë e kanë keqpërdorur këtë, ky kuvend duhet të nxjerrë ligje edhe për të kaluarën edhe për marrjen e masave ndaj keqpërdorimeve që janë bërë prej kur është çliruar Kosova e deri më sot. Ne po ndërtojmë kapacitete të sigurisë dhe të drejtësisë që të përballen me veprime të tilla. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Ju faleminderit z. kryetar.

Në cilindo vend demokratik gjetja e armëve jashtë institucioneve të cilat janë përgjegjëse që t'i kenë ato, është një çështje shumë serioze. Edhe në rastin tonë gjetja e armëve të cilat janë jashtë TMK-së dhe jashtë Shërbimit Policor të Kosovës është një çështje e cila meriton një qasje shumë serioze nga ky parlament edhe nga secili institucion i Kosovës. Për këtë arsye ne i përkrahim shqetësimet të cilat i ngriti Partia Demokratike e Kosovës. Duke pasur parasysh që këta persona të cilët u gjetën të implikuar në këtë çështje janë në një farë mënyre, janë punëtorë, janë persona të cilët janë në ministri të kësaj Qeverie, mendojmë që ky rast edhe më tepër e ngrit shqetësimin për implikimin e këtyre personave dhe njëkohësisht këta persona janë të punësuar në ministri. Fatkeqësisht ky nuk është rasti i parë, ky është rasti i dytë, rasti i parë ishte edhe kur me veturat e kësaj ministrie u bartën ngjyrat me të cilën u bën pikturat, u ngjyrosën institucionet tona, prandaj mendojmë që Shërbimi Policor i Kosovës ka kryer një punë jashtëzakonisht të mirë, e përkrahim institucionin e policisë dhe si parti dhe si Grup Parlamentar çdo herë jemi angazhuar për sundimin e ligjit dhe për rregullin në shoqëri dhe shpresojmë që kjo iniciativë do të vazhdojë përderisa të mos ekzistojnë armët të cilat janë jashtë institucioneve. E përkrahim SHPK-në që i ka gjetur ato armë dhe e përkrahim në shkatërrimin e atyre armëve dhe që armët të jenë vetëm aty ku duhet dhe ku pritët të jenë. Sa i përket këtij rasti mendojmë se nuk do të duhej të heshte, por do të duhej të analizohej, ndoshta do të duhej të formohej një komision i cili do ta analizonte implikimin e Qeverisë në këtë rast. Me këtë rast do të sqarohej se a ka ndonjë implikim apo nuk ka dhe do të hiqeshin dyshimet prej Ministrisë apo do të gjendej kush janë ata, prandaj si Grup Parlamentar i Orës e përkrahim përsëri punën të cilën Shërbimi Policor i Kosovës e ka kryer. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

Fjalën e kakKryeministri, urdhëroni.

AGIM ÇEKU, kryeministër – I nderuari z. kryetar, të nderuar deputetë.

Unë si kryeministër i kuptoj plotësisht shqetësimet e ngritura në këtë kuvend nga Grupi Parlamentar i PDK-së dhe i Orës dhe plotësisht i ndaj këto shqetësime. Janë shqetësime edhe të miat dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës, por ky është një akt kriminal i kryer nga kriminelët dhe unë dua ta përgëzoj Shërbimin Policor të Kosovës për një hap të tillë, njerëzit që e kanë bërë këtë akt kriminal që është shumë i dëmshëm për Kosovën, janë të arrestuar, janë para drejtësisë dhe ata do ta japin të vërtetën e këtij rasti. Nuk mendoj se ne duhet të ngutemi me këtë, sepse njerëzit janë arrestuar dhe njëherit dua t'i përgëzoj Shërbimin Policor të Kosovës, dua ta distancoj edhe vetën edhe Qeverinë nga veprimet e tilla. Absolutisht në Qeveri nuk ka vend për njerëz që janë të inkriminuar dhe janë të përfshirë në rastet e tilla, por i kemi organet tona të drejtësisë, e kemi Shërbimin Policor të Kosovës i cili edhe në këtë rast ka dëshmuar që është ofiqient, e ka një performancë shumë të mirë dhe e ka fituar besimin tonë ,atëherë ta lëmë që Shërbimi Policor i Kosovës ta kryejë punën e vet dhe të mos ngutemi të japim kualifikime politike dhe t'i shmangemi mentalitetit të vjetër të mendimit se nëse një anëtar i familjes është i përfshirë në ndonjë veprimtari ,e tërë familja është e inkriminuar apo jo, kështu që të kemi besim tek organet tona të drejtësisë dhe ta lëmë që kjo çështje të zgjidhet përmes procedurave të rregullta. Ajo çka mund të them është se veturat që janë zënë nuk kanë qenë të Ministrisë as të Qeverisë, ku është zënë ky armatimi, veturat e para të cilat i përmendi Teuta po kanë qenë, por këto nuk kanë qenë të Qeverisë dhe nuk kanë të bëjnë me Qeverinë. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BEREISHA – Ju faleminderit z. kryeministër, fjalën e ka Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASINIQI – Unë e bëra kërkesën dhe sot unë e kam rendin, më vjen keq prej juve.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Jakup Krasniqi ka kërkuar replikë, ndërsa nga AAK-ja e ka pasur fjalën Naim Maloku.

DEPUTETI JAKUP KRASINIQI – Por një gjë duhet të thuhet dhe mendoj se edhe kryeministri është dashur ta thotë të vërtetën se kësaj radhe KFOR-i është ai që i ka zënë në flagrancë njerëzit e Qeverisë, natyrisht këtu ka marrë pjesë edhe Shërbimi Policor i Kosovës, por dua t'jua përkujtoj se ne kërkuam informatë nga ministri i Rendit, por veturat kanë qenë të Qeverisë për të mos thënë të një ministrie dhe të kryeministrit dhe përgjegjësia e Qeverisë nuk mund të hiqet aq lehtë ,pasi është implikuar në këto raste, prandaj ne kërkojmë që kjo çështje të jetë e ngutshme. Qeverinë dhe ministrin nëse këta e kanë arritur suksesin duhet t'i përgëzojmë, duhet dhënë një informatë të saktë se vërtet çka ka ndodhur dhe si ka ardhur deri te ai veprim dhe ai zbulim dhe mbi bazën e kësaj informate ne do të duhej të debatim për siguri, për fatin e sigurisë së qytetarëve të Kosovës, qytetarëve që e kemi marrë votën znj. Nekibe. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLOË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit z. kryetar, i nderuari z. kryeministër ,të nderuar anëtarë të kabinetit qeveritar, deputetë të nderuar.

Mendoj se e vërteta është se ekziston të menduarit institucional dhe përgjegjësia institucionale dhe individuale. E hedh poshtë plotësisht atë që e tha z. Krasniqi se Qeveria është e inkriminuar. Z. Krasniqi përgjegjësia institucionale dhe individuale është e ndarë, si institucion e merr përgjegjësinë për vepra të bëra dhe individ për vepra të bëra e merr përgjegjësinë. Besoj që këtë tani e keni kuptuar. Sa i përket Grupit Parlamentar dhe Aleancës ne edhe mëtej do të mbesim shumë të përkushtuar në sigurimin e gjendjes dhe të sigurisë për qytetarët e Kosovës ,sepse në fund të fundit jemi edhe ne qytetarë të Kosovës dhe gjithashtu mbështesim mekanizmat e rendit, të drejtësisë dhe të gjitha strukturave të tjera, duke përfshirë edhe strukturat ndërkombëtare, si KFOR-in në punën të cilën e bëjnë, por gjithashtu edhe të gjithë mekanizmat mbikëqyrës të cilët i posedon edhe ky Kuvend në mbikëqyrjen e strukturave të sigurisë, prandaj nuk shoh ndonjë arsye tjetër për të debatuar më shumë. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka profesor Daci.

DEPUTETI NEXHAT DACI – Ju faleminderit z. kryetar, unë po u kërkoj falje parlamentit të respektuar, kolegeve dhe kolegëve ,sepse ndoshta ishte e mjaftueshme në nivel të shefave të grupeve parlamentare, por po e ndjej të nevojshme vërtet ta shpreh një brengë të thellë timen.

Sikur po përsëritet e kaluara, por në formë të spirales, më kujtohen ditët e para të institucioneve edhe e Qeverisë së përkohshme, por në veçanti pas konstituimit të Parlamentit dhe institucioneve të tjera. Ishte atëherë një konspiracion dhe një teori që në Kosovë do të fillojë luftë vëllavrasëse, nuk e them që ishte nga institucionet e ndonjë vendi mik ose anmik, por qëndronte si hipotezë kjo dhe ky parlament, këta deputetë që janë sot ndoshta 70 -80% të tyre janë të njëjtit me mençurinë e vet e prunë Kosovën së bashku me presidentin dhe me Qeverinë në fazën përfundimtare të vullnetit të saj politik. Unë mendoj se nuk na ka hije sot të dy grupacioneve, edhe koalicionit qeverisës edhe opozitës, në fund të vitit, në prag të hapjes së pakos së presidentit Ahtisari për institucionet për Kosovën e ne e kemi një mori dokumentesh që duhet të jetë pavarësi e plotë dhe pa prefikse dhe sufikse, por kuptohet brendia e saj si cilësi dhe si pragmatizëm do të jetë bashkë e realizuar me bashkësinë ndërkombëtare. Unë do të doja që Partia Demokratike e Kosovës të jetë në nivel të përgjegjësive që i ka pasur, jo si parti, por si udhëheqje e pjesërishme dhe si ushtarë të UÇK-së për çlirimin e Kosovës dhe që të realizohet ai vizion që shumë kush në Kosovë ka sakrifikuar. Nuk po mbaj ligjëratë, por po e shfrytëzoj shumë rrallë foltoren ka sakrifikuar më të shtrenjtën dhe nuk është përgjegjës politik as morale e as njerëzore që ajo të njolloset. Le të më lejoj pozita të them, sepse shpesh ose rrallë herë e kamë ngritur zërin që nuk duhet menjëherë konfrontimi me shqetësimet me vend dhe reale për siguri në këtë fazë të ndishme të procesit të finalizimit të procesit politik, por ajo që më shtyn të mospajtohem me shefin e Grupit Parlamentar të PDK-së është mënyra se si e shpreh atë brengosje dhe kohën dhe

momentet kur donë aty për aty në atë minut të ketë përgjigje kur organet profesionale vendore dhe ndërkombëtare, d.m.th Shërbimi Policor i Kosovës, KFOR-i dhe shërbimi policor i UNMIK-ut me sukses po e kryejnë një punë edhe në shkencë edhe në politikë duhet të ketë rregull, askush para organeve të caktuara profesionale të mos nxitojë, por shprehja e brengës është legjitime dhe nuk më pëlqen që ne të fillojmë sikur në stacione. Ndoshta është pjesë e demokracisë ajo, ne nuk jemi në atë fazë kur mund të shkojmë deri në atë konfrontim sa që të nxehen gjakrat. Unë po ju lus, po e përcjellim situatën globale në botë, në veçanti se çka po ngjan në mes një populli në Lindjen e Mesme, të mos mundohemi që në atë koncept politik pa vullnetin e askujt, nuk mendova në Grupin Parlamentar të PDK-së, por që duhet të rritet përgjegjësia individuale dhe kolektive, në veçanti e institucioneve. Në tërësi, pa dyshim, ajo dhe në një moment të caktuar është e drejtë legjitime, siç tha profesor Alush Gashi që LDK-ja ka kërkuar që siguria të jetë në rend dite, një moment PDK të kërkojë në një moment shumë të afërt që Ministria përkatëse, Qeveria dhe institucionet ta informojnë Parlamentin, këtë të drejtë nuk ia mohon askush, prandaj të akuzohet një subjekt politik, një lutje mediave! Ajo që pashë sot në pasqyrën e shtypit që e japin mediat është e frikshme, në një mënyrë si bëhet paraqitja në media, nuk i shërben as paqes, nuk i shërben as progresit, as sigurisë edhe pse po bëjnë punë të shkëlqyeshme të gjitha mediat dhe po mundohen, prandaj është hera e dytë ose e tretë në këtë kartel të deputetit 5 – 6 vjeçare në liri dhe në një mandat gjatë luftës që në momentet kur e ndiej të nevojshme ta lus pozitën, sepse është përgjegjësi shumë e madhe në radhë të parë e pozitës për këtë dhe në atë përgjegjësi të inkuadrohet opozita dhe të ecim përpara. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, ministri Rexhepi e ka kërkuar fjalën.

FATMIR REXHEPI, MINISTËR - Ju faleminderit z. kryetar, i nderuari kryeministër, të nderuar deputetë.

Ruajta e stabilitetit politik, e sigurisë dhe e rendit publik është përgjegjësi e të gjithë neve, qoftë si deputet, qoftë si parti politike për me mund me ecë me proceset ashtu si i kemi projektuar dhe me kriju stabilitet të përgjithshëm edhe për rendin, por edhe për të tjerët. Ngritja e çështjes që u bë sot nga shefi i Grupit Parlamentar dhe kërkesa që ministri ose Ministria e Punëve të Brendshme të përgatitë një informatë e cila ka të bëjë me rastet që janë në zhvillim e sipër dhe të cilat realisht e shqetësojnë çdo qytetar, mendoj që është e arsyeshme dhe unë do ta përgatis atë në pajtim me përgjegjësitë që më takojnë në momentin kur ajo bëhet kërkesë zyrtare nga ana e Parlamentit dhe së bashku me mekanizmat e tjerë do të jap informacionin e plotë i cili besoj se do të jetë në shqyrtim para juve. Mendoj se nuk qëndrojnë kualifikimet se Qeveria e vendit ose anëtarët e saj janë të inkrimuar ose ashtu siç u tha nga shefi i grupit parlamentar, por ne jemi të përkushtuar që të punojmë në luftimin e krimit në mënyrë institucionale, për çka edhe po punojnë organet e rendit vendor dhe ndërkombëtar që e kanë po ashtu përgjegjësi të cilën e kanë dhe të cilën e dimë të gjithë dhe mendoj se secili prej nesh duhet të distancohet nga aktet kriminale, ndërsa ata që i kryejnë këto akte, aktorët e tyre. të vihen para drejtësisë dhe të marrin përgjegjësinë për aktet të cilat i kanë kryer dhe kanë krijuar destabilizim ose shqetësime të tjera me dëm dhe pasoja. Prandaj., unë mendoj se përgjegjësia duhet të ndahet drejtë dhe ju siguroj që jemi duke punuar dhe do të punojmë

bashkarisht që në këtë parlament vërtet t'i trajtojmë çështjet drejt edhe mirë pa etiketime. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Meqenëse po debatojmë ende pa hyrë në rendin e ditës ,preferoj që të kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës. Fjalën e kërkon Xhavit Haliti.

DEPUTETI XHAVIT HALITI - Z. kryetar, të nderuar kolegë ministra, kryeministër. Mendoj se kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës ka ngritur një çështje e cila sa na ka shqetësuar neve si grup parlamentar ,i ka shqetësuar të gjithë në Kosovë dhe besoj që edhe të gjitha grupet parlamentare që janë prezente këtu, duke e përfshirë edhe Qeverinë. Nëse dikush i ka vu vetës detyrë me na vu në lajthitje përmes dezinformimit, është një problem tjetër. Mirëpo ,siç thotë populli, me zënien e peshkut në dorë gjithmonë dikush jep llogari dhe në veçanti ne kemi përvojën e së kaluarës, kemi dëgjuar dhe kemi parë që kur njerëzit që punojnë pranë politikave zihen me vepra të rënda penale, zihen duke bërë krime, ka argumente dhe në veçanti në qoftë se përdoren automjetet e përmendura , është krejtësisht normale që të kërkohej llogari nga personat përgjegjës që i rrethojnë ata njerëz. Unë nuk kam informacion qysh jam i bindur se asnjë nga deputetët e Parlamentit të Kosovës nuk kanë informacion se çfarë ka ndodhur dhe si është situata. Informatat i kemi nga mediat kryesisht të gjitha, prandaj kërkesa e Grupit Parlamentar për një seancë debati me ministrin e Brendshëm është krejtësisht normale , e drejtë , e domosdoshme dhe po insistoj që lidhur me këtë seancë të mos mbetet vetëm deklarata e ministrit që ne do të vijmë të raportojmë, por ne sot të marrim vendim dhe ta caktojmë datën se kur duhet të mbahet kjo seancë. Së dyti unë mendoj se nuk e destabilizon kjo procesin . Vetë fakti se ne po reagojmë për çështje të tilla nuk e destabilizon procesin e negociatave dhe të bisedimeve rreth statusit të Kosovës ,sepse ne po marrim një përgjegjësi që të dënojmë fenomenet negative, fenomenet negative që na kanë shoqëruar neve si shoqëri ndoshta në këto 5-6 vite të rënda do t'i quaja edhe në të kaluarën.

Sa i përket Ministrisë së Brendshme unë mendoj që e kam ngritur edhe më herët një akt të krimit që ka ndodhur në Pejë. Është hera e dytë që përsëritet që në duar të policisë vriten qytetarët e lidhur në pranga. E përgëzoj për largimin e atyre përgjegjësve të stacionit të policisë, por mendoj se do të duhej të thellohej kjo mënyrë e veprimit, përndryshe mendoj se mund të ndodhin edhe raste të tjera të reja. Prandaj, mendoj se ne duhet të vendosim sot për një seancë debati lidhur me ngjarjen që ka ndodhur dhe të kemi një informatë të saktë rreth kësaj. Në qoftë se hetimet konstatojnë që makinat e përdorura në transportimin apo çka është bërë me ato armë, unë nuk e di, janë të ministrive përkatëse të kryeministrisë apo të kujdoqoftë, llogaria politike u takon edhe ministrave dhe kryeministrit të Qeverisë së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, Sabri Hamiti e ka fjalën.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. kryetar, z. kryeministër, kolegë deputetë. U diskutua një problem i cili në kuptimin e përgjithshëm është diskutuar shumë shpejt në Parlament. Çështja e sigurisë në Kosovë, tash një ngjarje e freskët ,e shtyn Grupin

Parlamentar të PDK-së ta shtrojë si problem të ngutshëm në Parlament. Herën e parë nga kryetari i Grupit dhe herën e dytë të relativizuar nga kolegu i tij Xhavit Haliti. Unë i pranoj pluralitetet në mënyrën e artikulimit të problemeve, se i kemi edhe ne në LDK-ë këto shpesh dhe ju i keni, por në këtë rast duhet me qenë pak ma precizë, ju lus shumë ,sepse jemi në Kuvend dhe në Kuvend duhet të vendoset, kërkesë elementare është të diskutohet ngutshëm, kurse e dyta është të bëhet një interpelancë që është një përvojë shumë e ushtruar dhe me sukses në Parlamentin tonë rreth të gjitha problemeve, pra nën një. Sa më përket mua rreth këtij rasti, rasti i djeshëm nuk është një problem, por është një sukses, problem është nëse mbahen armët pa leje. Zënia e tyre është sukses dhe Parlamenti duhet të thotë se dje ka ndodhur një sukses. Ky është kualifikimi, por në anën tjetër sa u përket thirrjeve që të luftohet krimi i organizuar ose implikimi i tij në politikë ose në Qeveri, kjo është thënë me muaj të tërë kjo frazë nga shefi i krejt PDK-së Hashim Thaçi dhe ju e dini kur kam dalur në këtë foltore dhe kam thanë se unë e përkrah 100%, edhe tash e përkrah 100% kërkesën, vetëm se e përkrah si veprim jo si retorikë, se ne jemi në një gjendje si Parlament dhe nganjëherë po i themi njëri -tjetrit mos mbaj ligjëratat e të mos mbaj mësimet, por është e vërtetë që shoqëria jonë dhe Parlamenti ynë është ende në gjendje që të mësojë edukatë edhe shoqërore edhe parlamentare, kjo është normale. Mendoj se megjithatë jemi institucion që vendos, pra unë po i bie shkurt dhe po e kryej. Nëse kërkesa e PDK-së është që Parlamenti të diskutojë edhe një herë për këto probleme e ka votën time. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka Hashim Thaçi.

DEPUTETI HASHIM THAÇI – Faleminderit z. kryetar i nderuar, të nderuar qeveritarë, të nderuar të gjithë ju parlamentarë. Më tepër do të orientohem në çështjen rreth zhvillimeve për statusin politik dhe përkushtimet e Parlamentit të Kosovës dhe të politikës kosovare në momentin aktual që gjindemi, si politikë dhe si qytetarë ,në prag të rekomandimeve të presidentit Ahtisari për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Z. Thaçi, megjithatë e kemi një rend dite të caktuar.

DEPUTETI HASHIM THAÇI – E kam theksuar dhe e ritheksoj edhe sot këtu para jush. Tri janë çështjet kryesore që i hapin rrugë suksesit për statusin politik të Kosovës. E para është stabiliteti, e dyta është uniteti ynë i qëndrueshëm politik dhe gjithëqytetar dhe e treta është partneriteti me bashkësinë ndërkombëtare. Implementuam suksesshëm në këtë proces këta muaj do të kemi sukses për status, por nëse dështojmë në këto prioritete, do të dështojmë apo do të kemi një status të padëshiruar, por jam i bindur se do të kemi sukses. Statusi politik i Kosovës zgjidhet drejt zgjidhet në përputhshmëri me vullnetin e qytetarëve të Kosovës dhe me zotimin tonë të politikës, jo duke e toleruar të keqen, por duke e luftuar. Prandaj dihet adresa politike e të keqes në Kosovë, qëndrimi ynë, nuk dëshiroj tash të përmend emra edhe të atyre që ma përmendën, por qëndrimi ynë është shumë i qartë, kërkohet një seancë e jashtëzakonshme për të diskutuar në Parlamentin e Kosovës, ku do të jenë edhe autoritetet e tjera qeverisëse ,në mënyrë që të diskutohet për

gjendjen e përgjithshme të sigurisë në Kosovë. Asgjë nuk është e izoluar në zhvillimet rreth gjendjes së sigurisë në vend. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Të bëhet kërkesa me shkrim dhe sigurisht që në njërën nga seancat e ardhshme do të jetë në rend dite.

Ju lutem po diskutojmë pa pikë të rendit të ditës.

Fjalën e ka znj. Nekibe Kelmendi

DEPUTETI NEKIBE KELMENDI – I nderuari kryetar, i nderuar kryeministër me kabinetin tuaj, të nderuar deputetë.

Edhe unë kam qenë jashtëzakonisht e shqetësuar dhe kur kam parë atë skenë në Televizion, një grumbull armësh, autorsia apo pronësia e të cilave akoma nuk duhet, sepse ngjarja ka ndodhur dhe, kurse ne sot po tentojmë që ta inkriminojmë tërë Qeverinë, të gjitha institucionet e Kosovës, ani pse lidhur me ato armë janë të burgosur dhe mbahen të dyshimtë dy persona civilë. Për mua është me të vërtetë shqetësuese që të konsiderohet e përfshirë në këtë inkriminim të tërë Qeveria apo ndonjëra nga ministrat, kur dihet mirëfilli se kjo qeveri deri më tash ka punuar drejt, ka punuar mirë, i ka realizuar të gjitha detyrat që i ka shtruar para veti. Askush nuk dëshiron sot **ta abonojë** atë veprim që ka ndodhur dhe, por të nxitohet me paragjykime aprioristike se këto veprime u përkasin institucioneve të Kosovës. Mendoj se në këtë kohë është jashtëzakonisht e dëmshme dhe këtë memxi apo si të shprehem ndryshe kënaqen kur ta dëgjojnë kundërshtarët e Kosovës jashtë saj Prandaj, pa përfunduar mirë hetimet më duket se është e ngutshme edhe të qitet në rend dite kjo çështje e lëre ma sot të debatohet për të. Një armë e thjeshtë po të gjendet në ndonjë shpi të ndonjë qytetari e cila supozohet se mbahet për mbrojtjen e tij personale kërkon një hetim e lëre ma një veprim çfarë është zbuluar dhe. Është për të ardhë mirë që po tregohemi të aftë që vetë të ndihmuar edhe nga faktori ndërkombëtar po i luftojmë të këqijat dhe do t'i luftojmë, prandaj nuk jemi ata që po i abonojmë ato veprime, por le të na lejohet që organet përgjegjëse t'i kryejnë si duhet punët dhe të dalin me një qëndrim të tyre ose për një seancë tjetër të ftohen edhe përfaqësuesit e policisë së UNMIK-ut. Pse jo edhe përfaqësuesi i KFOR-it bashkë me ministrin e Rendit dhe ta kemi një shpjegim më të hollësishëm lidhur me gjetjen e tyre armëve. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Nëse vazhdojmë me debat

Për replikë është paraqitur z. Kuçi.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI – Unë nuk e pata ndërmend të flas, por pas fjalës së znj. Kelmendi në veçanti si koleg, jurist, e kam ndërmend t'i them dy tri fjalë dhe znj. Kelmendi është një juriste jashtëzakonisht me emër në Kosovë, por po ju them se përgjegjësinë politike dhe juridike sot nuk po e ndan si duhet. Sa i përket përgjegjësisë juridike dhe penale as ky Kuvend dhe askush tjetër nuk mund t'i përzihet gjyqësorit të Kosovës dhe ajo duhet të vazhdojë me ose pa ne. Ndërsa përgjegjësinë politike ky kuvend ka të drejtë. Unë nuk dua ta marr ndonjë shembull në Japoni se është shumë larg për ne Japonia, por po e marr shembullin me Malin e Zi. Në Mal të Zi kanë bërë ndeshje trenat dhe ministri ka dhënë dorëheqje. Besoj se Kuvendi nuk ka pasur nevojë ta vërtetojë se a ka qenë ministri në tren apo jo dhe këtë ta kemi të qartë se përgjegjësia politike duhet

të ndahet nga përgjegjësia juridike. Ana tjetër, unë e kuptoj se kemi jetuar në sistemin paralel, por sot Kosova i ka institucionet e veta. Deklaratat politike nuk janë veti të institucioneve, moralizimet i bëjmë diku tjetër. Ky kuvend dhe Qeveria duhet të dalin me vendime dhe në fund duke e përfshirë edhe z. Hamiti dhe z. Gashi. Më habit pak qasja indiferente ndaj proceseve të mëdha që janë në Kosovë dhe në veçanti më habit që jeni nga shumica. Kosova nuk do të ketë institucione të forta, nëse ata që e kanë shumicën në Kuvend nuk janë të gatshëm t'i forcojnë ato. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Znj. Nekibe replikë.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI - Unë di të bëj dallimin e përgjegjësive politike dhe të përgjegjësive penalo-juridike, mirëpo nuk dua t'i identifikojë personat civilë me institucionet e Kosovës, janë arrestuar persona civilë e jo qeveritarë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e kërkon Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI - Nëse Kuçit i duket sharmante që të bisedojmë para të gjithë të tjerëve për sende që mund t'i bisedojmë duke pirë kafe, nuk ka problem, Mua më bën përshtypja anbllok e emrave, unë do të abstenoja tanë kohën. Këtë jua kam thënë edhe një herë tjetër- grupit tuaj.-runu nga përgjithësimet, runu nga përmendja e grupit tërësisht. Unë nuk do ta bëja këtë kurrë. E dyta, ju po i përmendni 3 – 4 emra ku po i futni edhe emrin tem. Është e vërtetë që këtu ka nuancime në probleme dhe në artikulime dhe po e bëni edhe gabimin e dytë, prandaj unë nuk kamë asgjë çka të them sa u përket institucioneve, institucionet formohen prej atyre që janë institucionalisht. Kush e deklaroi vetën që institucionalisht nuk është unë nuk di si i formon. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – Faleminderit z. kryetar i Kuvendit, zotërinj qeveritarë, kolegë deputetë znj. dhe z. të pranishëm.

Sot ne kemi debat lidhur me vendimin për shtyrjen e zgjidhjes së statusit politik të Kosovës. Unë e kam kërkuar fjalën më herët edhe ndërkohë erdhën edhe anëtarë tjetër i Ekipit Negociator, kryeministri Çeku, pastaj kryetari i oponencës Thaçi. Ende nuk kanë ardhur edhe 2 anëtarë të tjerë të Grupit Negociator. Nëse ata nuk e shohin të denjë me ardhë këtu para Kuvendit edhe unë jam dakord që ata të mos vijnë, ndoshta ju tre mundeni të përgjigjeni tamam çka duhet para Kuvendit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Faleminderit z. kryetar më në fund e hoqët pengesën për të marrë fjalën për së dyti edhe grupi ynë parlamentar, ndërkohë që grupet e tjera parlamentare folën sa deshtën nga 2 – 3 herë.

Nevoja për të debatuar këtë çështje po shihet vetë me interesimin e deputetëve për të marrë fjalë lidhur me këtë problematikë, sepse nuk e ka vetëm një aspekt ngjarja e djeshme. Ka më shumë se një aspekt dhe të nderuar kolegë deputetë ky kuvend

funksionon sipas dy blloqeve, është koalicioni qeverisës, Qeveria dhe është opozita edhe që të dyja blloqet ndodhen në një proces shumë të rëndësishëm që u tha edhe nga të tjerët, në procesin e definimit të statusit final të Kosovës. Procesi i definimit të statusit final të Kosovës është shumë i varur nga përgjegjësia që manifestojnë qoftë blloku qeverisës, qoftë blloku opozitar. Sa herë që blloku qeverisës është në nivel të lartë të përgjegjesisë ajo pavarësi afrohet, kushtëzimet rreth asaj pavarësie zvogëlohen edhe të gjithë e kemi pranuar me gojë plot që të gjitha këto kushtëzime që kanë lindur në këtë proces janë për shkak se Qeveria nuk ka shfaqur mjaft përgjegjësi dhe është e kundërta kur opozita tregohet e përgjegjshme. Po ashtu është e njëjta gjë, pra pavarësia ofrohet edhe nuk rëndojnë kushtëzimet në pavarësinë e Kosovës. Ju jeni përgjegjës për të qeverisur, kurse ne jemi përgjegjës për ta luftuar përgjegjësinë tuaj. Kjo është esenca dhe në qoftës e ju vazhdoni me këtë sjellje të papërgjegjshme, atëherë të jeni të sigurtë që jo që do të shtyhet, por do të shtyhet përsëri statusi dhe kufizimet do të jenë shumë herë më të mëdha. Ministri që është personazhi kryesor i ngjarjes së djeshme është njeriu i cili ka qitur me armë në qendër të Prishtinës. Ministri në fjalë është personi vetura e të cilit është gjetur dhe i ka lyer me bojë institucionet tona dhe institucionet ndërkombëtare. Ky raport ka shkuar edhe në Këshill të Sigurimit. Këshilltari i ministrit në fjalë nuk është person civil, të gjithë zyrtarët e Ministrisë janë persona civilë, nuk ka ushtarakë aty, nuk është në uniformë, por është person zyrtar i Qeverisë dhe për këtë punë dhe puna e parë që do të ndodhë është të shkojë ministri, por kjo nuk ndodh. Madje nuk ka ndodhur as shkarkimi i një zyrtari përgjegjës për përdorimin e automjeteve në Ministrinë e tij me rastin e keqpërdorimit të makinës zyrtare, me rastin e bajtjes së ngjyrave, nuk mund të ecet para me këso papërgjegjësish. Me këso papërgjegjësish Kosova vetëm sa do ta shtyjë statusin e vet, vetëm do ta rëndojë kufizimin edhe më shumë në barrën tonë, prandaj rrjedhoja është shumë e logjikshme. Ky kuvend është i thirrur që ta kontrollojë këtë Qeveri, e ka detyrë dhe detyrën mund ta bëjë në mënyra të ndryshme dhe një mënyrë elementare është një komision hetimor, i cili do ta analizojë edhe para këtij kuvendi do të dalë me raport se sa janë të implikuar zyrtarët e tjerë të kësaj ministrie në këtë proces. A ka ditur ministri për këtë punë apo jo, a është edhe ky i përfshirë në atë ngjarje apo jo? Krejt këto janë analiza politike, hetime politike joligjore, ligjoret i bën dikush tjetër dhe për atë sigurisht që do të përgjigjen, por është çështja për ta gjetur përgjegjësinë politike në këtë proces, prandaj ju lutem shumë të ngritemi në nivelin e përgjegjesisë se vetëm duke u ngritur në nivelin e përgjegjesisë tregojmë se jemi të pjekur për ta marrë barrën e Qeverisjes në këtë vend. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka z. Kuçi, replikë.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI - Faleminderit z. kryetar, mendoj se tashmë e ka humbur efektin, por nuk ishte qëllim imi dhe as që do të jetë që t'i përgjithësoj gjërat. Besoj që edhe profesor Hamiti e di këtë, gjatë qasjes që e kemi pasur në Kuvend dhe jashtë tij. Unë mendoj se edhe z. Hamiti nuk duhet ta konsiderojë institucionalit vetëm atë që është në Qeverinë e Kosovës. Institucionalistë janë të gjithë ata që e respektojnë vendimet e institucioneve të Kosovës edhe unë jam ai që kërkoj që institucionet të kenë vendime të ligjshme dhe unë do t'i respektoj. Në drejtim të saj ne duhet të jemi të kujdesshëm se nuk është problemi që ta vëmë dikend në bankë të zezë, problemi është se është një problem,

jo vetëm kjo, por është një zinxhir që ne duhet ta diskutojmë dhe nëse një grup parlamentar kërkon diskutimin për një çështje ,pa marrë parasysh pozitë apo opozitë ,duhet ta fitojmë guximin intelektual edhe ta themë në anën tjetër si njerëz që jetojmë në këtë vend t'i diskutojmë gjërat. Përfundimi i këtij kuvendi cilido që të jetë ju e keni shumicën unë do ta respektoj dhe Grupi Parlamentar i PDK-së do ta respektoj.

KRYETARI I KUVENDTI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, ministri Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI, MINISTËR – Faleminderit z. kryetar. Z. kryeministër, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Mendoj se sot prapë sikur shumë herë në Kuvend të Kosovës, po u ikim disa detajeve, mendoj se duhet të ketë kolegjalitet, duhet të ketë rregull dhe respekt për njëri-tjetrin të paktën për ata që ulen këtu në këtë Kuvend. Deputetë të nderuar, pajtohen me njëri-tjetrin, z. Sahatçija pajtohet me z. Krasniqi që është shumë në rregull, mirëpo kjo është në një formë edhe injorim i asaj se çka thonë kolegët këtu në sallë. Juve mund t'ju pëlqejë më tepër z. Krasniqi se z. Maloku, por në fakt znj. Sahatçija dhe z. Maloku e thanë të njëjtën gjë e pse ju atëherë nuk pajtoheni edhe me z. Maloku . që e thanë të njëjtën gjë që e thatë ju, vetëm se e tha në mënyrë tjetër. Kemi edhe çështje të tjera të cilat ju duhet të mësoni me ndëgjju, kur të gjithë e shprehin brengën ,atëherë brenga është e përbashkët dhe mund të diskutohet, por nuk mund të ndahet në këtë mënyrë si e ndani ju. Ka edhe diçka tjetër këtu. Dje ka ndodhur një ngjarje dhe sot deputetët po kërkojnë përgjegjësi. Janë dy çështje, është mbështetja dhe besimi. Ju po i jepni mbështetje shërbimit policor të Kosovës dhe organeve të hetuesisë, por duhet të keni edhe besim se ata do ta zgjidhin këtë çështje, ata do të vijjnë dhe t'i tregojnë gjërat si kanë ndodhur. Nëse dikush nuk din të bëjë hetime, atëherë le të na tregoj, këto janë kritere të cilat duhet t'i nxirni këtu, të gjithë ne duhet t'i nxjerrim, çdonjëri mban përgjegjësi, çdonjëri e ka përgjegjësinë e vet dhe në gjuhën neolatine është oportunist, ndërsa në turqisht qelepir ose qelepirxhi me lyp sot shpjegime prej ministrit se çka ka ndodhur dje, nëse dikush i ka shpjegimet le t'i jep sot. Qeveria do t'i jep shpjegimet kur t'i marrë prej policisë. Z. të nderuar, nëse doni me diskutu caktojani datën për me diskutu dhe diskutojmë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. E vë në votim formal propozimin , sepse po diskutojmë pa objekt, jashtë rendit të ditës, objekti është shumë i madh. prandaj ta vemë në votim. Fjalën e ka Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Unë kam menduar se ngrita shqetësimet edhe tuajat jo vetëm të miat, por unë protestoj z. kryetar edhe ndaj jush edhe ndaj Parlamentit që më të shqetësuar jeni në deklaratën time se në veprimet e paligjshme që ndodhin në Kosovë. Nëse ky Parlament dhe ju z. kryetar nuk e shihni të nevojshme të debatohet çështja e sigurisë, nëse ju nuk e shihni të nevojshme që kryeministri ose ministri i Rendit të japë informacion të plotë lidhur me atë që ka ndodhur dje dhe natyrisht që nuk është vetëm e djeshit edhe unë tërhiqem dhe e lëmë kështu si ka qenë deri më tani, por mendoj se përgjegjësinë e merë koalicioni dhe ju z. kryetar dhe Qeveria.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Vë në votim propozimin, fjalën e kërkon Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar i Kuvendit. Grupi Parlamentar i LDK-së që në fillimi e kundërshton kualifikimin e veprës pa u kryer hetimi. Nën dy, e kemi mbështetur dhe e mbështesim mbikëqyrjen parlamentare të Qeverisë. Kërkesa që këtu të kemi raport për gjendje të sigurisë është kërkesë që e kemi mbështetur të gjithë dhe do ta mbështesim sa herë që të jetë e nevojshme, prandaj z. kryetar ju vendosni sipas rregullave, por ne e mbështesim kërkesën për debat për siguri sa herë që të jetë e nevojshme. Kur të përgatitet Qeveria dhe ne sugjerojmë që përgatitjet të bëhen sa më parë që të jetë e mundshme, në kudër të kësaj e mbështesim deklaratën dhe diskutimin e anëtarit të Kryesisë së Kuvendit nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës z. Sabri Hamitit. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – E pyes propozuesin. Z. Krasniqi jeni për çështje urgjente që të debatohet për këtë çështje apo të caktohet një seancë e veçantë.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar ne fillimisht e shtruar këtë çështje si një çështje të ngutshme dhe mendojmë se është e ngutshme, pas fjalës së ministrit se ai do të punojë dhe do të bie një informacion ose raport në Parlament. Mendoj se ajo duhet të ndodhë në afatin sa më të shpejtë të mundshëm, pastaj edhe duke e parë gatishmërinë e të tjerëve ne jemi që sot mos të hyjë në rend të ditës, por në një seancë të ardhshme qoftë e rregullt, qoftë e jashtëzakonshme, por të mos kalojë 10 ditë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – E vë në votim propozimin. Kush është për që kjo pikë të shtrohet në një nga seancat e ardhshme?
Aprovohet.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

1. Debat sipas kërkesës së Grupit Parlamentar për Integrim lidhur me vendimin për shtyrjen e zgjidhjes së statusit të Kosovës.

Në pajtim me rregullën 6.5 të Rregullores së punës, Grupi Parlamentar për Integrim ka kërkuar debat lidhur me vendimin për shtyrjen e zgjidhjes së statusit politik të Kosovës. Kërkesa është trajtuar në Kryesi të Kuvendit dhe u është shpërndarë të gjithë deputetëve.

Shkojmë në një pauzë për kafe dhe vazhdojmë me këtë pikë të rendit të ditës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Vazhdojmë me punë. Po e përsëris edhe një here. Në pajtim me rregullën 6.5 të Rregullores së punës, Grupi Parlamentar për

Integrim ka kërkuar debat lidhur me vendimin për shtyrjen e zgjidhjes së statusit të Kosovës.

Kërkesa është trajtuar në Kryesi të Kuvendit dhe u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Por , më lejoni, ta përfundoj unë professor. Ju njoftoj se Grupi I Unitetit e ka marrë kërkesën e Grupit Parlamentar për Integrim e ka shqyrtuar dhe e ka këtë qëndrim. Në momentin kur është marrë vendimi i Ahtisarit për shtyrjen e procesit të statusit të Kosovës, ne kemi qenë si grup i unitetit në mbledhje, kemi marrë qëndrimin tonë rreth asaj dhe e kemi bërë publik. Pas atij momenti nuk ka pas zhvillime të tjera rreth këtij problemi, prandaj nuk ka diçka të re që mund të thuhet, nuk ka pas zhvillime të më vonshme që Grupi i Unitetit të vijë në sallë e të sqarojë. Urdhëroni z. Xhemajli.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Të lutem shiko, zhvillime z. kryetar ka pas edhe zhvillime të idhëta bile, është shtyrë afati për zgjidhjen e statusit të Kosovës edhe pse u thanë të zgjidhet 2006-tën. Mirëpo, kjo nuk prish punë, që nukka ardh Grupi i Unitetit , është e qartë që nuk i ka respektuar ata që i kanë kërkuar që këtu të vihet dhe të debatohet edhe për këtë çështje. Bile unë nuk po kam dëshirë që nuk janë këtu, se nuk po kam dëshirë me i pa sot këtu, ndonëse ju jeni mjaft edhe ju përgjigjeni ju për gjithë se edhe ti je në Grupin e Unitetit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, Gjergj Dedaj e ka fjalën, aty është në emër të propozuesit

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Ju faleminderit shumë z. kryetar. Pikë së pari dua me shpreh pakënaqësinë time mënyrën si po e drejton seancat, dua me thanë në mënyrë shumë të dobët, shumë të ligë, duhet ta ushtroni funksionin si kryetar i Kuvendit të Kosovës. Të këtë rregull në Kuvendin e Kosovës, të respektohen procedurat.

Grupi Parlamentar për Integrim tash e një muaj e gjysmë kemi kërkuar jo debat, ju e keni me shkrim para jush, informatë nga ekipi si e quani ju i Unitetit që nuk pajtoheni me këtë nocion për shtyrjen e statusit politik të Kosovës dhe ndërlidhjen e këtij statusi me zhvillimet e brendshme në Serbi, respektivisht me zgjedhë në Serbi të 21 janarit, që është nonsens e pa pranueshme dhe dua të them shumë shqetësuese për deputetët e Kuvendit të Kosovës nëse e ndiejnë veten deputetë ,që unë gjithëve shumë ju respektoj. Nëse nuk jemi delegatë, por jemi delegatë ,por jemi deputetë nëse jemi këtu me votën e lirë qytetare të Kosovës, atëherë ne duhet t'i dalim zot kësaj vote dhe ta respektojmë këtë vullnet politik të qytetarëve të Kosovës.

Afër dy orë u bë për një çështje shumë të rëndësishme debat pa u marr vendim me votë që ju duhet ta kishit paraqitur këtu që të debatojmë për çështjen çfarë ka ndodhur dje. Po jua përkujtoj që askush nuk mund të amnistohet, d.m.th. nëse një zyrtar ose disa zyrtarë të Qeverisë implikohen në çështjet të cilat kanë ndodhur dje, ju përkujtoj, ju e dini se unë e kam marrë fjalën, d.m.th. jua përkujtoj si e dini ministri i Komunikacionit në Sllovakia pas rrëzimit të aeroplanit me ushtarë të KFOR-it me fajin e pilotit ai menjëherë ka dhënë dorëheqje, ndërsa te ne është krejtësisht normale dhe vazhdoni kështu. Sa i përket rëndit të ditës i nderuar z. kryetar, ne kemi kërkuar një informatë nga Ekipi Negociator, të cilën e kemi pritur një muaj e gjysmë dhe ndërkohë ky kuvend ka pas mundësi me

biseduarar, për bletë, për peshqit, për bimët, për insektet dhe për të gjitha tjerat, por s'e ka pa të arsyeshme që para deputetëve dhe para elektoratit, para popullit të Kosovës që po i ndrydhet vullneti i tij .të debatojë dhe t'i sqarohet, t'u thuhet e vërteta qytetarëve të Kosovës dhe popullit të Kosovës.

Koalicioni qeverisës i ka marrë votat në sajë të premtimeve kryesore që i ka bërë. Ju përkujtoj nëse i keni harruar, shfletoni gazetatat, votoni për ne, do ta bashkojmë Mitrovicën, cili prej jush mundet me shkuar me pi kafe në Mitrovicë, Mitrovicën në veri, me truproje, me polici speciale shkoni. Kanë thënë votoni për ne në vitin 2004, në vitin 2005 do ta bëjmë realitet pavarësinë e Kosovës, ka kaluar viti 2005 nëse nuk e dini, pastaj keni thënë qershori i vitit 2006, ka kaluar edhe qershori i vitit 2006, pastaj keni thënë brenda vitit 2006 do të bëhet realitet pavarësia e Kosovës dhe kjo nuk ka ndodhur.

Bile disa herë me ngulm keni thënë që nuk do të ketë negociata me Serbinë për statusin e Kosovës dhe është ky ekip negociator i cili me buzëqeshje kanë shkuar në Vjenë, kanë biseduar edhe me Tadiqin, edhe me Koshtunicën për statusin politik të Kosovës. Nuk besoj që keni biseduar atje për futboll se në atë kohë ishte Kampionati Botëror i futbollit, por keni biseduar për statusin politik të Kosovës. Domethënë janë bërë pa keqkuptim, mashtrime eklatante ndaj premtimeve që ju ia keni dhanë elektoratit dhe ne si grup grupi për integrim kemi kërkuar informatë ,sepse ky ekip negociator që e ka zgjedhë ky Kuvend i Kosovës me propozimin e ish- presidentit Rugova. d.m.th. nuk e ka pasë mandatin nga ky Kuvend, as me aprovuar shtyrjen e statusit, as me biseduar me Serbinë për statusin e Kosovës dhe as që tash po do me marr kompetenca të tjera edhe për simbolet kombëtare pa e pyetur fare Kuvendin e Kosovës. Donë me marrë kompetenca me biseduar ky grup edhe për kushtetutën e Kosovës, pa i konsultuar grupit parlamentar edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës, bile edhe për ligjin për zgjedhjet dhe ky ekip është krijuar në një farë mënyrë një miniqeveri ose një substitut, domethënë nuk i keni pasë këto kompetenca, këto kompetenca po ia jepni vetvetes.

Ky kuvend është ai që e ngarkon ose nuk e ngarkon Ekipin Negociator me çështjet kryesore që kanë të bëjnë me statusin politik të Kosovës. Prandaj ,Grupi Parlamentar për Integrim ka kërkuar një informatë që po mungon, dhe askush nga qytetarët e Kosovës nuk e ka të qartë se pas vitit 99-të kur me gjakun e 15 mijë viktimave e arritëm lirin e Kosovës dhe tash tentohet që Serbia të bëhet hisetare, të bëhet palë me fajin e Ekipit Negociator të Kosovës për m'u zgjidhë statusi politik i Kosovës.

Mali i Zi pa asnjë viktimë s'e pyeti Serbinë, as Maqedonia, s'e pyeti Serbinë as Beogradin se si duhet zgjidhur problemet brenda në Malin e Zi. A ne po u dashka me negociuar me Serbinë, na po u dashka me pyet Beogradin, na po u dashka me i pritë zgjedhjet në Serbi kush po fiton atje, pastaj me marrë një vendim për statusin politik të Kosovës dhe kjo është e pa pranueshme. Nëse asgjë tjetër, Ekipi Negociator i Kosovës ka qenë dashur së paku të kërkojë falje publike para këtij Kuvendit .Kujt nuk i dëgjohet-dera, dy dyrë janë përmas hapur e dy dyrë përpara si në aeroplan, domethënë kujt nuk i dëgjohet dëgjimi im lirisht delni e pushoni.

Domethënë, çka kërkon Grupi Parlamentar për Integrim. Kërkojmë që Ekipi Negociator të vijë para deputetëve dhe të jepë një informatë pse është shtyrë statusi? Pse nuk i kanë mbajtur premtimet, pse u lidh çështja e statusit me zgjedhjet në Serbi dhe të kërkojmë përgjegjësinë e tyre dhe deri më 31 dhjetor të vitit 2006 për mendimin tim dhe për mendimin e Grupit për Integrim kjo Qeveri ka legjitimitet dhe duhet urgjentisht ta rishqyrtojë shkarkimin e saj, dorëheqjen e saj, para se ta bënë këtë Kuvendi i Kosovës. Pra, Kuvendi i Kosovës ka me bërë po ju premtoj shumë shpejtë.

Për shkak të mospërbushjeve të premtimeve kryesore, për shkak lojës së pandershme që po bëhet me vullnetin politik të popullit të Kosovës, jo për me ju shitur mend ,por dy herë brenda 15 ditëve jam thirr , jam ftuar në Parlamentin Evropian në Bruksel ,në njërin prej takimeve, ku në qenka tash ministri i Brendshëm ka qenë prezent edhe ministri i Brendshëm.

Kosova zotërinjë , zonja dhe deputetë të nderuar, na mundemi me ia bërë qefin vetit sa të domë, as në çështje të liberalizimit dhe të lehtësimit për vizat e vetmja është Kosova që është lënë anash dhe nuk është përfshirë. Edhe Serbia është e futur në çështjen e lehtësimit të proceset e vizave, çështje të lëvizjes së lirë në vendet e Bashkimit Evropian, përveç Kosovës. Kosova ka qenë dashur me qenë e para, sepse jemi nën administrimin e UNMIK-ut, e kemi euron, e kemi administratën ndërkombëtare, ka qenë dashur me qenë vendi i parë nga Ballkani Perëndimor që do të ishte përfshirë në këtë proces. Prandaj kërkoj që të pushojë, sikur që kam kërkuar edhe përpara, mandati legjitimiteti i Ekipit Negociator, të krijohet një qeveri e gjerë në procesin shumë të rëndësishëm që po kalon Kosova, se dikush e përmendi këtu që jemi institucionalistë, jo individë, por institucione të Kosovës, Qeveria e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, presidenti i Kosovës t'i merrë të gjitha kompetencat në vitin 2007 në të cilat po kalon Kosova, se ne e kemi tash, ju e pat edhe dje, ky koalicion nuk ka ma forcë, nuk ka ma besim, nuk ka ma mandat ta aprovojë as buxhetin për vitin 2007 dhe kjo është një krizë nëse duhet me pranuar qeveritare dhe parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar për Integrim gjithë qytetarëve të Kosovës ua uroj krishtlindjet, bajramin, edhe Vitin e Ri, ishalla viti 2007 nuk e zenë më këtë qeveri. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputeti Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI - I nderuari z. kryetar, zonja dhe zotërinj deputetë dhe ju ministra, më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së të rikonfirmojmë përcaktimin për pavarësi të plotë dhe pa vonesë. Grupi Parlamentar i LDK-së e rikonfirmon mbështetjen për delegacion të unitetit dhe për bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare lidhur me statusin përfundimtar të vendit tonë që është pamvarësi e plotë dhe pakushtëzime. Lidhur me vonesën e paraqitjes së propozimit të presidentit Ahtisari, delegacioni i Unitetit dhe presidenti Sejdiu në të njëjtën ditë është deklaruar publikisht dhe ne e mbështesim atë deklaratë e cila është shqetësim i fuqishëm, dhe si të tillë e mbështesim me plotësi dhe kërkojmë zbatimin në përpikëri të rezolutës të Kuvendit të Kosovës të miratuar me 17 nëntor të vitit 2005.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi.

DEPUTETI MARK KRASNIQI – Ju faleminderit z. kryetar, ju përshëndes të gjithëve, qeveritarë dhe deputetë këtu. Më vjen shumë keq që edhe me këtë rast dua ta marrë fjalën për një punë e cila po përsëritet këtu për herën e tretë. Fjala është konkretisht për listën të cilën e ka nënshkruar grupi parlamentar që sot debatojmë për këtë që u tha që është në rend ditës. Unë nuk jam kundër këtij debati dhe kundër këtij rendi të ditës, por jam kundër kësaj që ky grup parlamentar i ka lejuar vetes që të dalë me këtë listë para Parlamentit dhe me një falsifikuat të palejueshëm. Fjala është se këtu në nr. 7 figuron Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës. Ky është falsifikuat, Partinë Shqiptare Demokristiane të Kosovës e përfaqësoj në këtë parlament vetëm unë, askush tjetër, këtu e kemi emrin e z. Zef Morinës, i cili ka nënshkruar këtë. Kjo është hera e tretë që unë po duhet me demantua këtë mashtrim këtë falsifikuat dhe këtë rrenë që e përsërit ky person. Ky duhet me pas për veti konsideratë ,sepse unë jam këtu që duhet me reaguat kur në emër të partisë që të paraqitet, që është i përjashtuar nga partia.

Kot mundohet, kot përpiqet çdo kush në qoftë se paraqitet si parti në qoftë se nuk është i regjistruar në OSBE, vetëm Partia Shqiptare Demokristiane është e tillë.

E lus edhe Kryesinë, se edhe Kryesia e Parlamentit mirë e di se e ka edhe shkresën zyrtare si mos t'ia lejojë Zef Morinës me u paraqitur rrejshëm këtu se paraqitja rrejshëm është edhe vepër penale dhe unë do ta ndjek si maca minin çdo herë kur të paraqitet këtu. Ai është përjashtuar edhe si ministër tash është paraqitur edhe si ministër hala, e ky zotëria tjetër le të shkojë me i ruajtur dhentë, paraqitja e rrejshme është vepër penale. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – ju faleminderit profesor. Urdhëro Zef Morina.

DEPUTETI ZEF MORINA- Të faleminderit kryetar. Unë e bëra kërkesën shumë ma herët me folë pikërisht në lidhje me këtë listë, meqenëse profesori u shpreh me këto fjalë të cilat nuk i kanë hije si akademik dhe si i moshuar, si do që të jetë ia fal të gjitha ato që i tha. Unë këtu nuk jam nënshkruar si anëtar i Grupit Parlamentar për Integrim ,më vjen shumë keq që kjo është keqpërdorur, sepse edhe Bislim Hoti nuk është i Grupit Parlamentar për Integrim, por është i Grupit Parlamentar të Aleancës, nëse nuk gaboju.

Unë jam në Grupin Parlamentar të LDK-së, është e drejtë imja si deputet, si kryetar i një partie dhe si qytetar, që të marrë informata të drejtëpërdrejta ose nga dora e parë nga ekipi të cilit ia kemi dhënë votën të gjithë ne,e në mesin e tyre edhe unë dhe të mos marrim informacione vetëm nga shtypi për një çështje shumë madhore. Plotësisht pajtohem me fjalët që i tha deputeti Alush Gashi. Në mbështesim Grupin Unitetit që ka mbështetjen e plotë, nuk është mirë që të humbim kohë kush është në cilën parti është, kush është kryetar e kush është anëtar. Këtu është duke u biseduar për një çështje shumë madhore, për të cilën edhe profesori i nderuar disa herë thotë që është shumë me rëndësi, por tash iu ka përzier koncepti, ma interesant i duket vendi në parti, se çështja e Kosovës. Unë edhe një herë po them jam anëtar i Grupit Parlamentar të LDK-së, edhe pse me

ndikimin e profesor Markut nuk marr pjesë në mbledhje. E di kryetari i grupit parlamentar se iu ka drejtuar: Nëse Zef Morina merr pjesë unë nuk do të vij, unë dëshiroj më të të jem shumë i sinqertë, dëshiroj të punoj si deputet, si qytetar e jo të merrem me gjana të cilat janë në dëm të interesit tonë. Edhe një herë ju lutem ,po them sinqerisht, interesi im ka qenë si deputet të marr informata nga dora e parë dhe të mos marr informata nga gazetatat, sepse është një çështje shumë me rëndësi, kjo përndryshe është edhe kërkesë e Kryesisë së Partisë Shqiptare Demokrsitiane dhe për këtë arsye unë kam me shkruar nuk jam në Grupin Parlamentar për Integrim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA –ju faleminderit, fjalën e ka Xhavit Haliti

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Zoti kryetar, këto çështje të cilat po na dalin, mendoj që do të duhej të zgjidhen në atë gjykatën e veçantë, pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, edhe në OSBE edhe mos të na vijnë në Parlament, të dytë janë deputetë dhe mendoj që nuk ka nevojë të marrin kohë, megjithatë po kaloj te çështja.

Ne që në fillim edhe gjatë kohës së mandatimit të Grupit Negociator kemi zhvilluar debate se kush duhet të jetë dhe sa duhet të jenë se është zgjedhë formula që është zgjedhë dhe i kemi mbështetur të gjithë me një votim në Parlamentin e Kosovës edhe formulën edhe njerëzit që na kanë përfaqësuar në bisedime.

Bisedimet në qoftë se do të përfundonin sipas dëshirës vetëm tonë, nuk do të zhvilloheshin fare, por do të na çonin një telegram prej Këshillit të Sigurimit të OKB-së për hajrë ju koftë pavarësia dhe shkoni te shpija. Mendoj se do të duhej me ardhë disa mandate shtesë në Kuvendin e Kosovës dhe ndoshta një pjesë me u zëvendësuar. Nuk është e lehtë në fazën që jemi ta akuzojmë as Grupin e Unitetit, as atë, sepse nuk e besoj që edhe ata me dëshirë kanë pranuar që të shtyhen këto negociata. Nuk e besoj që ka qenë vërtet as dëshira e Ahtisarit që t'i shtyjë se edhe ai është përpjekë dhe ka ngarkesat e veta. Por është problem ma madhor, është problem ma i madh ,është problem i Këshillit të Sigurimit ,do të thosha dhe i Grupit të Kontaktit të cilët të mos të hyjë në analizën e vlerësimeve të tyre i kanë vlerësuar si të tilla dhe i kanë shty. Tani arsyet janë interpretuar në mënyra të ndryshme, megjithatë, ne kemi mbështet dhe do ta mbështesim kërkesën për debat, por mendoj që në debat do të duhej të ishin të gjithë protagonistët, komplet Grupi Unitetit dhe presidenti i Kosovës, i cili është në krye të këtij Grupi të Unitetit dhe pastaj të zhvillojë debatin dhe të merrnim përgjigje kualifikuese. Ky është qëndrim edhe i Grupit Parlamentar të PDK-së që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë kur vërtet do të jenë anëtarët e Grupit Negociator. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, Gjylnaze Syla e ka fjalën.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit, i nderuari z. kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra..

Më lejoni të filloj duke ripërtëritë mbështetjen e Grupit Parlamentar të Alenacës, për Ekipin e Unitetit dhe mbështetjen për bashkësinë ndërkombëtare për zgjidhjen sa më të shpejtë të statusit të Kosovës. Në vazhdim dëshiroj të bëjë një pikëvështrim kohor.

I nderuari z. kryetar, populli i Kosovës është i lodhur nga pritja. Populli i Kosovës është lodhur nga përsëritjet se ne duhet të presim para se të kemi jetë normale, ekonomi normale, raporte normale në pjesët e tjera të botës.

Ne kemi pritur për tre vjet me radhë pas vitit 1999, sepse na është thënë se aq duhet, kalon, kjo na sollti në vitin 2002 që tanimë duket se është larg. Ne kemi pritur derisa bashkësia ndërkombëtare sajoi mënyra të reja për të shtyrë shprehjen e plotë të lirisë sonë. Ne kemi pritur derisa standardet u krijuan për ne nga bashkësia ndërkombëtare, edhe pse e kuptoi se standardet janë ato që na duhen për t'u bërë shtet, ne pritëm përtej besnikërisë për miqtë tanë që na ndihmuan me 1999-tën, ne pritëm me respekt dhe durim për Kombet e Bashkuara dhe Unionin Evropian. E vërteta është se ne pritëm pavarësisht nga Kombet e Bashkuara dhe Unioni Evropian, ne pritëm në radhë të parë vetëm për shkak të miqve, le të jemi të sinqertë miqtë tanë amerikanët dhe britanezët na kanë lutur.

Deri në fund të vitit 2004 çdonjeri nga ne e dinte se pritja ishte mjaft e gjatë, ne ishim atëherë me mjaft fat që të kemi kryeministrin Haradinaj dhe Përfaqësuesin Special Petersen të cilët e patëm energjinë dhe vizionin që pritjes sonë t'i japim fund. Tani, gati po përfundon, por ne ende shohim mungesë guximi moral nga aktorë të caktuar ndërkombëtarë ,të cilët do të kërkonin nga ne që të presim prapë dhe sërish populli i Kosovës ishte i përgatitur të presë, të qëndrojë i lënë edhe për këtë dimër me status të pa vendosur ,derisa Beogradi vendos se çfarë Parlamenti do, parlament ksenofobik apo diçka tjetër.

Ne kemi pritur derisa Vojisllav Shesheli në mënyrë të suksesshme i bëri shantazh Tribunalit të Hagës, ne presim për zgjedhjet e një vendi që vazhdimisht tallet me rregullat e ligjit ndërkombëtar, të nderuar miq, stabiliteti i rajonit fillimi i demokracisë, zhvillimi ekonomik, zvogëlimi papunësisë, hapja e perspektivës evropiane, janë arsye të mjaftueshme që bashkësia ndërkombëtare të tregojë vullnetin politik, ta njohë pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës. Mesazh i thjeshtë dhe i qartë duhet të dalë nga ky Kuvend sot, nuk duhet të ketë më pritje, vendimi duhet të merret së shpejti pa vonesë, ky është suksesi ynë i përbashkët i Kosovës dhe i bashkësisë ndërkombëtare. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka profesor Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Kolegë të nderuar, e respektojë vullnetin e çdo deputeti që t'ja jap fjalën e vet për çfarëdo problemi që del në Parlament. I respektojë dëshirat e njerëzve që për probleme kaq madhore ta japin fjalën nga një herë edhe kur është në rend dite, por t'u respektojnë rregullat e këtij parlamenti ato që ne i kemi bërë vetë dhe është mirë t'i respektojmë. Duhet ta kemi të qartë që ne kemi provë ta shqyrtojmë në rend dite një raport të Grupit të Unitetit para Parlamentit. Një diskutim unë e dëgjova në mënyrë pak më të shqueme ,në mënyrë tjetër nga propozuesi Dedaj që i përket ekipit grupit që e ka

propozuar, Ne e kemi sjellur në Parlament propozimin e një grupi. Në momentin që ekipi nuk është këtu unë kujtoj që në kuptimin e qëllimit parlamentar diskutimi nuk vlen, nuk ia mohoj askujt të drejtën që të jep brengat e veta, dhe unë e di që s'kemi nevojë të bëjmë gara t'i shqiptojmë këto brenga se i kemi njësoj, po objekti i bisedës parlamentare pushon në momentin kur ekipi nuk është këtu, po ashtu kërkohet që ata të flasim, jo ne të flasim, kur na caktojmë të flasim ne, ne flasim edhe pa ta. Nëse ekipi propozues e ka kërkuar Grupin e Unitetit dhe ai nuk është këtu unë mendoj që është, unë i dëgjova dy propozime racionale edhe të Alush Gashit edhe të Xhavit Halitit që me të vërtetë mendoj që nuk di, nuk ka ndonjë rezultat nëse na vazhdojmë t'i shprehim brengat këtu, sepse nuk mërijmë kurrkund. Sa më përket mua personalisht, unë mendoj që Grupi i Unitetit, qoftë edhe nëse thotë që nuk kemi çka themi, duhet të vijmë në Parlament dhe të na thonë një fjali, nuk kemi çka themi. Kjo është një.

Nën dy, qoftë të vijmë këtu dhe të ripërkufizohet mandati i tyre, sepse dikush e tha mua më duket që Dedaj -ai grup- e ka mandatin për një punë në parlament dhe është mirë nëse i ngarkon vetit punë tjera që ta marrë mandatin në Parlament. Sa i përket bisedës, për Grupin e Unitetit rreth çështjes së shtyrjes së propozimit të statusit të Kosovës, unë me të vërtetë në bazë të rregullave parlamentare nuk shoh që do të kemi sukses në qoftë se vazhdojmë kështu, ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, urdhëroni z. Ferid Agani

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryetar

, në kërkesën e Grupit Parlamentar për Integrim, e cila nuk është nënshkruar vetëm nga anëtarët e Grupit Parlamentar për Integrim, ta theksoj këtë dhe ta qartësoj atë situatë edhe është mirë e thanun që është mbështetur nga deputetët e partive të tjera politike dhe në këtë aspekt në shkresë nuk ka asgjë të paqartë. Është kërkuar informata e Ekipit të Unitetit lidhur me shtyrjen e vendimit për përcaktimin e statusit politik të Kosovës, ndërsa Kryesia e Kuvendit ka vendosë që kjo të jetë jetë informatë, por kjo pikë e rendit të ditës të jetë debat sipas kërkesës së Grupit Parlamentar për Integrim lidhur me vendimin për shtyrjen e zgjidhjes statusit politik të Kosovës. Pra është kërkesë e Kryesisë kjo pikë e formuluar nga ana e Kryesisë së Kuvendit që të jetë debat lidhur me kërkesën tonë, e jo informatë nga ana e Grupit të Unitetit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, unë do ta veja në votim propozimin që kjo që është në rendin e ditës të shtyhet për njërin nga seancat e radhës. Kush është për që kjo çështje të shtyhet për një seancë të ardhshme, të marrë pjesë edhe Grupi i Unitetit.

Kush është për, shumica janë për..

Kundër..... 4,

Abstenim..... nuk ka

Konstatohet se propozimi aprovohet.

Shkojmë në pikën e dytë të rendit të ditës,

2. Debat sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së lidhur me gjendjen energjetike në Kosovë në pajtim me rregullën 6.5, urdhëroni z. Xhemajli

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Ju faleminderit z. kryetar për mirëkuptim. Nëse ka mundësi që të drekojmë, për shkak se edhe shefi i grupit parlamentar momentalisht nuk gjendet, është në një takim të ngutshëm dhe deri atëherë sigurisht që do të vinte, kishit bërë mirë, nëse jeni dakord, nëse jo po vazhdojmë, në emër të grupit kërkova ,jo si individ.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, a keni propozim për me bë pause? Urdhëroni z. Xhavit.

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Më sa kuptova z. Xhemajli kërkoi që të jepet pauzë për drekë, jo të shtyhet seanca pika e rendit të ditës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, a pajtoheni, kush është për. Ju lutem vazhdojmë mbledhjen. Urdhëroni z. Dugolli,

DEPUTETI BUJAR DUGOLLI – Unë mendoj pse nuk është kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së nuk është arsye ta ndërprejmë seancën ,ne mund ta vazhdojmë në rast se debati zgjat edhe pas gjysmë ore, ne e bëjmë pauzën ,por nuk është arsye vetëm për këtë që e tha z. Xhemajli të ndërpritet séanca. Mendoj të fillojmë, në rast se zgjat debati ma shumë se gjysmë ore atëherë, ikim në pauzë dhe kthehemi, propozim imi është.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, Urdhëroni z. Xhemajli,

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Për mua, fundi i fundit bëni çka të doni, por nuk është fer, sinqerisht po them, ne po e kërkojmë kohën e drekës me hëngër drekë për një arsye tjetër për të cilën nuk është shefi i grupit parlamentar. Ne e kemi kërkuar këtë debat dhe nëse doni vazhdoni nese s’e vazhdoni, nuk është fer. Ne mundemi edhe pa te natyrisht. Unë thashë për një çështje që mund të kryhet në mënyrë gjentëlmente, mirë, po ju nuk po doni ,vazhdoni nuk është problem si të doni. Ju faleminderit,

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, nuk thamë se nuk po domë, urdhëroni z. Maloku

DEPUTETI NAIM MALOKU – Z. kryetar, të nderuar deputetë, Grupi Parlamentar i PDK-së është mësuar me lëshuar seancën herët dhe e ka qitë kohën e drekës para orës 12,00. Kanë kërkuar këtë debat ,ne e kemi qitur në rendin e ditës, ne jemi për të punuar dhe kjo është fer pra, është fer që ne të punojmë ,nuk është fer me e lëshuar seancën. Ne nuk e lëshojmë seancën, por vendi i punës yni është këtu, imi është këtu vendi i punës, zoti kryetar ju lutem më lejoni të punoj pra sot, ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, urdhëro z. Koci.

DEPUTETI GANI KOCI – Ne e kemi ditur që aleanca është një orë ma mrapa, gjithmonë ecë një orën mrapa, le ta shikojë orën nuk është para dymbëdhjetave, por është pas dymbëdhjetave. Po ata janë mësuar me të vërejtjen dhe ne nëse doni ne jemi të përgatitur që të vazhdojmë. Ishte një kërkesë për pauzë dhe nuk di ndoshta po krijohet një presedan i ri që debatojmë këtu në Kuvend dhe të votojmë për pauza. Është qesharake dhe absurde z. kryetar që çështje të tilla të shtroni edhe për votim, Ne jemi të gatshëm të vazhdojmë edhe tani ishte kërkesë,por nuk patëm mirëkuptim,

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, vazhdojmë, e kemi pra pikën e dytë të rendit të ditës

2. Në pajtim me rregullën 6.5. të Rregullores së punës Grupi Parlamentar i PDK-së ka kërkuar debat lidhur me gjendjen energjetike në Kosovë, kërkesa i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit bashkë me informatën e Ministrisë u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Ftoj propozuesin e mocionit, përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të PDK-së ta marrë fjalën. Urdhëroni Safete Hadergjonaj.

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë, është konstatim i konfirmuar nga gjendja faktike e përditshmërisë sonë se gjendja në energjetikë është tepër e rëndë për të mos thënë se është në kolaps, pa shenja përmirësimi,por vetëm përkeqësimi. Këtë në një mënyrë e vërteton edhe raporti i Ministrisë që na është sjellë këtu. Problemi i energjetikës është i hershëm, daton që nga vitet 90-ta të shekullit të kaluar, qe 7 vjet menaxhmentet janë ndërruar disa herë, por çdo herë nderimez janë bërë në rreth, por asnjëherë nuk ka pasur ndërrime esenciale sikur të kishin qëllim ta ruanin gjendjen stabile të keq menaxhimit në të gjitha segmentet vitale të korporatës energjetike të Kosovës. Dështimet janë në politika programore në menaxhimin si dhe mjetet financiare në miniera ashtu edhe në kuadro logjistike, në mihje e miniera në termoelektrana në distribucion në faturim si dhe në inkasim. Deri tani me KEK-un ka menaxhuar edhe AKM-ja, me menaxhmente të jashtme, këshilltarë të brendshëm, tani KEK-u po drejtohet gjithë politikisht nga Ministria e Energjetikës dhe e Minierave, dhe menagjmenti vendor, Ministria e Energjetikës dhe minierave në vend që t'i bënte politikat ,kurse mbikëqyrjen ajo është në bordin udhëheqës dhe e drejton inkasimin . kështu që dështimi i KEK-ut është edhe i vetë Qeverisë, po të shikohet me vëmendje sidomos kuadrot vendore asnjëherë nuk ka pasur ndryshime cilësore ,sidomos nuk ka pasur e nuk ka ndryshim në sektorin e mihjeve dhe minierave. Në segmente e tjera ka pasur nderim të individëve brenda një rethi vicioz rreth që nuk kërkon menaxhim cilësor të përgjegjshëm dhe profesional. Edhe politikat që po i ndërton Ministria e Energjetikës dhe Minierave nuk garantojnë ndryshim cilësor. Kjo ministri flet se çka do të bëhet pas 10 apo 15 vjetëve ,por nuk është e gatshme të tregojë një dalje të shpejtë nga kolapsi energjetik, nga terri që e ka mbuluar Kosovën. Në ndonjë rast mund të thuhet se ka edhe konflikti interesi ku babë e birë udhëheqin politika e menaxhojnë me minierat e linitit.

Menaxhimi i minierave ka qenë dhe vazhdon të jetë pika më e dobët në energjetikën e Kosovës. Këtu ka ndodhur avaritë më të mëdhaja dhe askush asnjëherë nuk ka dhënë

asnjë përgjegjësi as morale, politike dhe as ligjore, në këtë nivel të pa përgjegjësive atje nuk mund të ketë ndryshime meritore. Rrëshqitjet e njëpasnjëshme të dheut, shpenzimet e shumta në këtë sektor, problemet në prodhim dhe humbjet e shumta të rrymës, riparimet dhe investimet prej 300 milion euro nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe 500 milion euro nga AER-i dhe donacione, paaftësia për furnizim, faturim dhe inkasim, vjedhjet dhe fshehjet e auditimit e të tjera. Pra, të gjitha këto dukuri e kanë karakterizuar KEK-un në këtë periudhë kohe. Nuk duhet të kalojnë në heshtje pa dhënë asnjë llogari të gjitha këto gjëra të këqija të cilat kanë ndodhur në KEK..

Ne jemi të bindur se me një politikë ndryshe, me një menaxhim ndryshe të fuqisë njerëzore, të mjeteve financiare dhe të resurseve të tjera në Koorporatën Energjetike të Kosovës, Kosova do të dilte më shpejtë nga kollapsi energjetik dhe do të kishte më shumë dritë, më shumë energji për zhvillim ekonomik. Ne jemi të bindur se pa i ndryshuar të gjitha politikat, pa bërë ndryshime rrënjësore, pa i ndalë të gjithë keqpërdoruesit e pasurisë kombëtare, pa i ndalë të gjitha format e vjedhjeve në Koorporatën Energjetike të Kosovës, pa i larguar si të themi hajnat nga KEK- dhe Qeveria, Kosova dhe energjetika nuk do të kenë fat, ashtu si edhe nuk do të ketë investime në zhvillim dhe punësim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Berat Luzha.

DEPUTETI BERAT LUZHA- Ju faleminderit z. kryetar. Krizën energjetike në Kosovë po e shkakton që afër 8 vjet Koorporata Energjetike e Kosovës e cila është shprehur në kollaps energjetik të Kosovës, ose në kancer energjetik të Kosovës, ose thënë ndryshe në katastrofën energjetike të Kosovës.

Katastrofa nuk është vetëm një fenomen i shkaktuar nga natyra, katastrofë sot është edhe kur mungon energjia elektrike, 12 e më shumë orë në ditë, si ndodhë anëkend Kosovës, e sidomos në komunat më të vogla e më periferike të Kosovës, siç ndodhë ta zëmë në komunën e Kaçanikut, e cila sot përballet me terrin si të mos ishte e elektrifikuar fare, atëherë bëhet pyetje: Pse është kjo gjendje? Kush e shkakton këtë gjendje katastrofike? Cili është roli i UNMIK-ut në këtë gjendje dhe cili është roli i Qeverisë. KEK-u ky glltitës galepant i parave të popullit ,i cili deri tash ka gëlltitur rreth 1 miliard euro nga buxheti i Kosovës dhe nga donatorët ende vazhdon ta furnizojë me avazin e vjetër, të kërkojë para e të mos furnizojë me energji.Kërkon nga populli ta paguajë rrymën në të njëjtën kohë kur këtë popull nuk e furnizon me rrymë, kërkon para jo për të prodhuar apo për të importuar më shumë rrymë, por për të mbushur xhepat e shefave, për t'i bërë pagat marramendëse për vete. Kërkon para në faturat e reduktuara nga njerëz që luftojnë për ekzistencë në kohën kur në këtë ndërmarrje ka plotë afëra për keqpërdorime të parave.

UNMIK-u apo AKM-ja e cila ka fytyrë të kërkojë nga buxheti i Kosovës dhjetëra milion euro në emër të energjisë më duket se është e interesuar ta mbajë Kosovën në këtë kollaps energjetikë deri sa të jetë këtu, në mënyrë që ta pengojë zhvillimin ekonomik të vendit, dihet se pa energji nuk ka zhvillim ekonomik dhe si rrjedhim as stabilitet politik, nëse donë ta rrënosh një vend atëherë shkatërroja sistemin energjetik të tij, më duket se në këtë

drejtim po shkon UNMIK-u dhe agjencia e tij AKM-ja, ose agjencia kosovare keq besimit.

Qeveria e Kosovës për fat të keq është vetëm një vëzhguese e mirë në këtë krizë, dhe në këtë katastrofë, ministria e energjetikës kot është formuar, ajo përveç shpenzuesit e fondeve nga buxheti i Kosovës, nuk ka asnjë ndikim për të bërë diçka ose më mirë ajo e mbanë tupanin të cilit i biejnë të tjerët, atëherë pse është kaq indiferentë qeveria dhe ministria në këtë katastrofë energjetik, pse është kaq e mirë në këtë kaos, pse ministri qëndron dhe nuk jep dorëheqje kur e dinë që nuk mund të bëjë asgjë, pse ekziston fare kjo ministri e cila tash më ka marrë epitetin si ministria e territ. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, zoti Kumnova e ka fjalën

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA – Z. kryetar, ministra, Grupi Parlamentar i AAK-së e ka shqyrtuar me kujdes informacionin për gjendjen energjetike në Kosovë dhe me këtë rast konsideron se informacioni është i plotë në kuadrin e kompetencave dhe të përgjegjësive të kësaj ministrie në sektorin e energjetikës.

Problemet e grumbulluara të energjetikës për të cilat jemi të vetëdijshëm të gjithë nuk janë të mandatit të qeverisë së sotme as të mandatit të qeverisë së djeshme, fillet dhe problemet duhet kërkuar që nga viti 1990-te, plaçkitja dhe degradimi që ju bë nga pushteti i dhunshëm serbë, sidomos në termocentrale dhe mihje, por edhe mungesa e investive për sanimin e kësaj gjendje pas vitit 1999 dhe menaxhimi i huaj i instaluar nga administrata e UNMIK-ut e ndihmuan krijimin e krizës në energjetikë. Pa dyshim, ngritja e ministrisë përkatëse me kufizimin në kompetenca sidomos në menaxhim nuk çon drejtë zgjidhjes së problemit të furnizimit me energji, çfarë i mbetet kësaj ministrie e përballur me këto probleme. Pa dyshim studimi i gjendjes reale, ngritja e infrastrukturës ligjore dhe hartimi i strategjisë ishte e vetmja kompetencë dhe e strategjisë dhe kjo është bërë, shpallja e strategjisë dhe veprimet konkrete për zbatimin në saj kanë nxitur kundërshtime për të rrëzuar këtë strategji. Ku nuk kemi asnjë alternativë tjetër të ofruar por vetëm fjalë prefekte politike na duken veprime jo serioze, zhvillimin ekonomik të Kosovës nuk mund ta ndërtojmë ashtu si po pretendojmë me fjalë dhe gjobë, e jo me vizione të qarta dhe konkrete dhe bindëse. Synimi i Ministrisë që nga një sistem energjetik që varet nga importi, jo gjithnjë i sigurt dhe me çmime të larta domethënë vetëm në pozitën e konsumimit Kosova në bazë të strategjisë e merr pozicionin e prodhuesit edhe për eksport, është hap i guximshëm që krijon një siguri ekonomike të Kosovës dhe të ashpër, zërat që duhet shtyhet kjo nismë dhe për një kohë ose duhet pritur gazin nga Rusia nuk janë serioze dhe krijohen një varshmëri totale të Kosovës, jo vetëm në rafshin e sigurisë ekonomike, por edhe politike dhe është shprehje e mentalitetit të robit, sepse nuk mund të planifikojmë një zhvillim ekonomik të Kosovës vetëm me lëmosha de donacione. Një zhvillim i qëndrueshëm ekonomik ,një siguri jo vetëm ekonomike por edhe sociale dhe politike ka edhe faturën e saj. Unë nuk e shoh një siguri nëse e ndërtojmë një strategji të zhvillimit të Kosovës, nëse ajo jeton me ndihmën e aparateve si një i sëmurë që jeton pa funksionet e organeve vitale, duhet ta paguajmë një çmim dhe kjo ma mirë të jenë pasuritë tona si limiti, xehet dhe resurset tjera për një

periudhë të caktuar deri sa ta marrim veten të sigurojmë një zhvillim dhe një mirëqenie të dinjitetshme dhe pastaj mund të ndërtojmë strategji të tjera.

Pa dyshim gjendja e keqe në furnizim me energji dhe për të tejkaluar këtë situatë kërkon mobilizim të institucioneve të qytetarëve të biznesit ,sidomos ndaj detyrimeve për të realizuar inkasimin, për kundër varfërisë dhe pamundësisë objektive për shlyerjen e borxheve të familjeve të skajshëm të varfër duhet pranuar se ka edhe shpërdorime mungesa kursimeve kyçe ilegale dhe formave të tjera të papërgjegjshme. Sthurja e KEK-ut duhet të shkojë deri në fund për të filluar një ristrukturim efikas, tërheqja e investorëve duhet përshpejtuar si edhe shumë masat tjera të cilat i janë shpalosur në këtë material , janë një zgjedhje për tejkalimin e krizës së rëndë energjetike me të cilën po përballlet Kosova

KRYESUESI SABRI HAMITI – Fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi –

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Ju faleminderit për fjalën, zotëri kolegë deputetë, z. ministri i vetëm paska mbetur këtu, si duket nuk ka ndërmend të jap dorëheqje do të qëndrojë deri në fund.

Kriza energjetike tashmë ka marrë përmasa të një katastrofe që po destabilizon shoqërinë tonë në tërësi .jo vetëm aspektin ekonomik, por edhe një destabilizim shpirtëror psikik të qytetarëve tanë dhe po shkakton vërtet trauma që do të çojnë drejtë traumatizmit të përgjithshëm të shoqërisë sonë, megjithëse qytetarët tanë kanë pritur se pas luftës pas gjithë atij tmeri që përjetuan do të rehabilitohen të paktën me këto shërbimet elementare për një jetë normale aq sa mund të ishte normale në Kosovë, por ndodh e kundërta. Sikur po vazhdon traumatizimi pa mbarim. Një çështje tjetër që po e ndihmon ta them kushtimisht terrorizimin e qytetarëve tanë është edhe insistimi i Qeverisë tash edhe me forcë e polici e ku e di unë që qytetarët detyrimisht ta paguajnë rrymën që nuk e kanë. Unë sinqerisht po ju them që nuk ndodh në botë diku që të paguhet një mall që nuk e ke. Kjo ndodh vetëm me Qeverinë tonë dhe me KEK-un tonë që kërkon t'i paguhet një mall që nuk ta afron, nuk ta jep.

Prandaj në këtë kuptim ju po e diskreditoni qeverisjen dhe pushtetin duke insistuar në pagimin e rrymës ,të mallit që qytetari duke ia prerë rrymën i cili sapo kthen shpinën policia ose punëtori i KEK-ut e lidh rrymën e ky është një diskreditim i mëtejshëm i Qeverisë dhe i pushtetit.

Të jeni të sigurtë që një shtresë e caktuar që nuk kanë pagë .duke filluar nga kategoria arsimtarëve, e njerëzve, nëpunësve që kanë rrogën aty te 200 eurosh dhe familje pesë, gjashtë anëtarë të jeni të bindur që nuk kanë mundësi as s'keni me muajt kurrë me i detyrua me i pagua nga 2000 € e 3000€ që i kanë përveç se me i marrë e me i qua në burg dhe këtë mund ta bëjnë në qoftë se mund ta bëni, por më duket as nuk ka burgje as vende të mjaftueshme për me i qu krejt ata njerëz që nuk mund ta paguajnë rrymën.

Prandaj Qeveria kudo në botë nuk është të krijojë probleme që t'i thellojë problemet ,por që t'i zgjidhë problemet. Në Qeverinë tonë dhe kuptohet këtu nuk po e përjashtoj as

UNMIK-un që është përgjegjësi kryesor, në vend që të zgjidhen problemet e të ofrohen zgjidhje, kërkohen zgjidhje këtu prodhohen probleme, prodhohen situata të pakëndshme që detyrimisht qojnë drejtë përplasjeve, pakënaqësisë, protestave, siç kanë fillua në shumë komuna me u bë edhe kundër KEK-ut edhe kundër Qeverisë edhe kundër UNMIK-ut.

Prandaj, mos të ndodhë që siç po ndodh, siç janë mësuar disa politikanë tanë me dal e veç me i dënua pakënaqësitë e qytetarëve. Se nuk jemi ne qeveritarë e as Kuvendi që t'i dënojmë pakënaqësitë e qytetarëve tanë, por të gjejmë zgjidhje për qytetarët tanë, në qoftë se najëherë kemi me gjet. Sepse kështu Qeveria po shndërrohet në një uzinë më të madhe të mashtrimit, krijimit të problemeve, të prodhimi të problemeve.

Një çështje tjetër është e fundit që është krejt politike, por që ne jemi mësuar kështu t'i gëlltisim si ndihme përkrahje tjera e tjera plot formulime tjera që i gjejmë ne edhe UNMIK-u. Ndërhyrja tash e drejtpërdrejtë e Serbisë në furnizimin e një pjese të qytetarëve tanë me energji elektrike. Për mua është një ndërhyrje e patolerueshme, një partneritet është siç po bëhet edhe në sfera të jetës në Kosovë i Qeverisë dhe i UNMIK-ut me Serbinë. Mos lejoni dhe nuk duhet të lejoni se për atë e keni fituar votën që Serbia të bëhet partnere në çështjet e Kosovës dhe në çështjet e qytetarëve tanë. Sepse pakica serbe është pakicë dhe janë qytetarë të Kosovës nuk janë të Serbisë.

Nuk besoj që do t'u lejoni juve zotërinj qeveritarë dhe as UNMIK-un që të ndërhyjnë në zgjidhjen e aq shumë problemeve që ka vërtet pakica shqiptare në Serbi. Dhe nuk janë pak ata shqiptarë, nuk besoj që do të pranonte një ndihmë çfarëdo qoftë që të jetë te Qeveria jonë dhe të bëjë partnere atje,

Prandaj, unë kërkoj që të mos lejohen allesh verishe të tilla me Serbinë të mos na e bini Serbin brenda ,siç e keni pru në këto shtatë vjet. Faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. Bislimi. Fjalën e ka ministri Çeku. Urdhëro.

MINISTRI ET'HEM ÇEKU – Faleminderit z. kryesues, të nderuar deputetë. Unë kam përgatitur një informacion. Jam munduar të përgatiti si Ministri një pako informative për gjendjen në fushën e energjisë elektrike. Edhe më lejoni edhe një herë të them të shprehi falimenderimet që ma keni mundësuar me pyetjet e juaja që unë bashkë me ju t'i ngrisim disa shqetësime, duke mos i ikur asnjëherë të gjitha atyre përgjegjësive që më takojnë si ministër e ndonjë herë të ashtuquajtur ministri i territ i paaftësive dhe të cilat thuhet ndonjëherë dhe nuk merret për bazë të gjitha zhvillimet dhe kompetencat që unë i kam si ministër edhe pse e themeluar qe dy vite si institucion nuk i kemi dy vite të plota të ndërtuar si Ministri.

Siç kemi parë në informata të dërguara praktikisht Ministria është përpjekur që t' ju informojë përmbledhasi informacionet e plotë mbi gjendjen aktuale në sektorin e energjisë elektrike me theks të veçantë gjatë periudhës gjatë dy vjetëve të fundit të ngritjes së Ministrisë brenda kompetencave tona.

Në fjalimin tim do të përpiqem të fokusohem me çështjet kryesore dhe t'ju informojë për disa të dhëna që kryesisht kanë të bëjnë me nevojën për mbështetje nga Kuvendi për tejkalimin e situatës energjetike të cilën edhe ne e klasifikojmë si të rëndë, por jo pa rrugëdalje. Synimet e MEM-it përqendrohen në realizimin e strategjisë së energjisë të cilën ju tash e keni miratuar për këtë kemi përgatitur e po e zbatojmë një program trivjeçar ecuria e zbatimit të të cilit është relativisht e mirë, por të kemi parasysh burimet e kufizuara financiare përballë nevojave të mëdha të këtij sektori. Unë jam i bindur në atë që ju e dini sa ka qenë buxheti i Ministrisë sonë për vitin e kaluar dhe sa është planifikuar për vitin e ardhshëm.

Objektivisht, objektivi i përgjithshëm për sektorin energjetik ka qenë dhe mbetet reformimi dhe transformimi i tij në mënyrë që ai të tërhiqë investime duke krijuar kushte dhe mundësi reale për të mbështetur fuqishëm zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të Kosovës. Për realizimin e këtyre objektivave të rëndësishëm për Kosovën. Ministria është e orientuar në këto drejtime kryesore.

Mbështetjen për përmirësimin e situatës së furnizimit me energji elektrike. Ndërmarrja e veprimeve që do të sigurojnë furnizimin e qëndrueshëm me energji elektrike në periudhën afatmesme duke pakësuar varshmërinë energjisë nga të dhe definitivisht shkëputja nga kjo varshmëri. Rehabilitimi i kapaciteteve ekzistuese, hapjen e minierës së re të Sibovcit, ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike duke shfrytëzuar në mënyrë eficiente dhe racionale burimet natyrore dhe vendore dhe forcimi i rrjeteve të linjave për ndërlidhje ndërkombëtare sidomos ato me Shqipërinë integrimet rajonale.

Për të përmirësuar situatën të furnizimit me energji elektrike Ministria e ka mbështetur KEK-un me kuadër të taskforcës duke përcjellë nga afër dhe duke koordinuar aktivitetet që lidhen me rrjetin e inkasimit të energjisë së faturuar, jo të energjisë të cilat nuk e marrin qytetarët. Do të thotë flasin për energjinë të cilët e pranojnë qytetarët edhe të cilët nuk kanë obligim për të paguar. Këtu duhet ta përmendi se vetëm në nëntor bashkërisht është arritur që të kemi diku 37% të rritjeve më të mëdha se në vitin paraprak apo të themi diku mbi 3 milion më shumë inkasim gjatë kësaj periudhe.

Në zbatimin e strategjisë për energji në Kosovë të miratuar nga ky Kuvend. Ministria ka iniciuar ndërmarrjen e masave të rëndësishme për ristrukturimin e sektorit energjetik. Mbase këto që kryesisht lidhen meKEK-ut në përputhje me ligjin në fuqi dhe inkorporimi i korporatës së re të mihjeve të limitit. Sa i përket nismës për tërheqjen e investimeve të mëdha private në bashkëpunim me Bankën Botërore, Agjencionin Evropian, USAID ka filluar intensivisht puna në mënyrë që brenda vitit 2007, 2008 të kryhen të gjitha hapat e nevojshëm për përzgjedhjen e investitorit privat që të angazhohet për hapjen e minierës së re në Sibovcë ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe rehabilitimin e disa blloqeve të Kosovës A. Them edhe një herë gjatë periudhës të vitit 2007 dhe në fund të vitit 2008 parashohim përmbylljen e kontratës financiare me investitorin. Mund të jetë kohë shumë e gjatë apo për disa kolegë e deputetët mund të jetë

hapa edhe të përshpejtuara por për të cilën ne kemi marrë si komitet drejtues që t'i analizojmë dhe një herë të gjitha ato që na vinë nga Grupi i deputetëve ORA.

Sa u përket proceseve integruese gjatë vitit 2006 Kosova ka vazhduar në rrugën e nismës së parë më procesin e integrimeve evropiane, MEM-i ka arrit t'i realizojë Ministria në bashkëpunim me UNMIK-un dy kontrata të rëndësishme, dy marrëveshje të rëndësishme të bashkëpunimit me Shqipërinë.

Një ndër çështjet tjera të rëndësishme të cilat i kemi në trajtimin e sipër ,siç jeni njoftuar në hollësi në informatën që e keni përpara, janë edhe këto. Trajtimi i problemeve sociale për të cilat në vitin 2005 buxheti i konsoliduar i Kosovës ka mbështet pagesën e energjisë elektrike për rastet sociale në 12,5 milion i keni nda ju që të eliminojmë ngarkesat e rasteve sociale. Prandaj, ndonjëherë ajo që thuhet që nuk kanë qytetarët, ne e dimë se buxheti i përgjithshëm i qytetarëve nuk është i kënaqshëm, por janë nda 12.5 milion për rastet sociale është eliminua në vitin 2005 rastet sociale në raport me KEK-un. Po ashtu edhe në këtë periudhë është paraparë në 2007 ndarja e 4.5 milion euro për trajtimin e rasteve sociale.

Të nderuar deputetë,

Unë dua ta tërheq një paralele që ju të shihni se këtu nuk kemi të bëjmë me raste sociale. Në qoftë se rastet sociale janë të regjistruara në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në qoftë se ka marrë nga KEK-u që është i regjistruar në KEK si rast social ai për një shumë të caktuar të shpenzimeve të energjisë elektrike lirohet nga pagimi për një shumë të caktuar të energjisë elektrike, por jo për krejt shumën e mundshme të shpenzuar dhe Ministria konsideron shqetësues faktin që ka mjaftë raste komerciale që nuk e paguajnë si duhet energjinë elektrike të konsumuar. Ne mendojmë se marrja e shpejtë e masave konkrete dhe të prerazi krahas atyre të filluar për sektorin e amvisni është e domosdoshëm për t'i eliminuar këto dukuri.

Bazuar në vështirësitë për importin të energjisë elektrike se si janë zvogëluar ofertat dhe janë rritur kërkesat dhe çmimet në treg. Këtu dëshiroj t' ju informoj se çmimet aktuale në import për periudhën e dimrit janë nivelit 75 deri 80 euro për megavat orë p.sh. Shqipëria ditë të fundit po paguan mbi 78 euro për një megavat. Aktualisht KEK-ut ju kanë afruar çmime deri në 150 euro megavatin për nevojat e importeve. Në këto kushte ka lind nevoja për të rishikuar një pjesë të planeve dhe programeve ekzistuese, jemi të gatshëm bashkë me Komisionin funksional t'i rishqyrtojmë me Qeverinë edhe një herë planet për periudhat e caktuara se ju e dini në tërë rajonin e Evropës juglindore posaçërisht në Ballkan mungojnë mbi 10 mijë megavat energji elektrike.

Prandaj, ne si Ministri kemi mbështetur konceptin e rehabilitimit të Kosovës A, ka qenë e domosdoshme se në qoftë se nuk kalofshim në rehabilitimin e disa blloqeve, dy blloqeve Kosovës A ne u varshim nga importi. Dhe duke ditur se çmimet e importit çfarë janë dhe duke ditur çmimet e prodhimit ne prodhojmë dikund me 32 euro megavatin, ne kemi mbështetur rehabilitimin e blloqeve të Kosovës A edhe pse jemi kritikuar si ndot të

mjedisit si probleme të tjera, mirëpo për neve ka qenë më e rëndësishme t'i ndihmojmë buxhetin dhe me këtë rast edhe një çështje duhet të ju informojë.

Të nderuar deputetë,

Se po mos të ishin këto politika që ju i cilësoni në qoftë ndoshta të mira dhe të këqija ne do ta kishim pasur mbylljen e Kosovës A. Do të kishim pas 1500 vende punëtorë të lënë jashtë Kosovës A dhe po ashtu do të kishim pasur diku një pjesë të madhe të buxhetit që ishim detyruar ta blejmë nga vendet e ndryshme e duke ditur që Serbia sa herë do e pengon blerjen e energjisë elektrike se kalon përmes Serbisë. Dhe ju e dini shumë mirë edhe qëndrimin e Ministrisë sa i përket ndërhyrjes së Serbisë te konsumatorët tanë dhe ne i kemi thanë jemi shumë të gatshëm ta marrim përgjegjësinë e furnizimit të gjitha atyre konsumatorëve të cilët janë të gatshëm të pranojnë obligimet e institucioneve të Kosovës dhe të cilët janë të gatshëm t'i kryejnë sidomos pagesat në çështjen e energjisë elektrike.

Pse nuk ka furnizim të rregullt të energjisë elektrike? Dua të nxjerri vetëm një kronologji shumë të shkurtër. Ju e dini gjatë periudhës së okupimit të Serbisë dhe unë nuk besoj që ka harruar dikush mes viteve 1990 dhe 1999 unë e shoh një okupim edhe në fazat e mëhershme por është një periudhë tjetër e konceptit tim. Shumë nga objektet e KEK-ut janë të degraduara tërësisht, janë shkatërruar tërësisht, janë vjedhur dhe janë plaçkitur. Një pjesë e tyre është tani në Serbi një pjesë tjetër e tyre janë edhe nëpër disa vende të tjera ku Serbia nëpër Republika të ish- Jugosllava ku Serbia i ka dërguar për komunitetin serb në atë periudhë.

Prandaj, gjatë as periudhe jo vetëm që është degradua, jo që s'është investua, por është plaçkitur në forma më të egra më të mundshme një kompani e cila në veti tani i ka 7 mijë e diçka punëtorë. 7 mijë e diçka punëtorë marrin të ardhura të punës në KEK. Dhe shpeshherë më kanë thënë dhe e them pse ke shkua në Bordin e KEK-ut. Kam shkuar edhe do të bëjë çmos që t'i marrë të gjitha ato përgjegjësi, pavarësisht a ka pas mundësi t'i kryejë të gjitha përgjegjësitë a s'kanë pas, ne kemi pranuar që të shkojmë të punojmë që t'i kryejmë posaçërisht për të përkrahur zhvillimin e sektorit energjetik dhe për ta përkrahë zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe për t'i përkrahë shumë familje të dëshmorëve dhe të invalidëve të luftës në Podujevë që jetojnë në kontinjera dhe të vetmin burim të jetës e kanë energjinë elektrike.

Prandaj, kam pranuar me tërë përgjegjësinë për të hyrë për të ndihmuar dhe për të bërë që është e mundur brenda mundësive tona t'i japim një punë dhe një rezultat. Dua të them edhe në Qeverinë e z. Rexhepi jemi munduar për ta bërë një punë të tillë, por asnjë nga ministrat e atëhershme nuk ka pranuar të shkojë në Bordin e KEK-ut edhe pse e kanë caktuar që të punojnë dhe të kryejnë punë që të ndihmojnë në ristrukturimin dhe në zhvillimin që kanë të bëjnë me KEK-un, por unë nuk dua t'i kthehem as periudhe.

Shkalla e rritjes së lartë e konsumit. Vetëm në periudhën 2000 – 2006 kemi rritjen e konsumit diku mbi 8% në gjithë nivelet e vendeve të ndryshme të Evropës kemi një rritje diku mes 2 e 3 ve po në Kosovë për periudhën 2000 – 2006 është arrit rritja e konsumit të bëhet mbi 8% dhe sidomos në amvisëri. Në amvisëri kemi diku rritjen mbi 70% të konsumit. Prodhimi aktual i termocentralit Kosova B, prodhimi vjetor është rreth 3.2

miliardë orë energji. Termocentrali Kosova A, prodhon rreth 1 miliardë, hidrocentralet të cilat janë rinovuar dhe janë në përdorim prodhojnë 0.12 miliardë, dhe për me i plotësua kërkesa që KEK-u të mund të furnizon qytetarët me energji elektrike 5 me 1 duhet të kemi edhe import 0.7 miliardë orë energji elektrike se nuk mund me këto kapacitete që i kemi nuk mundemi me pas një furnizim të rregullt dhe stabil me energji elektrike dhe në bazë të këtyre investimeve që janë bërë.

Menaxhmenti i KEK-ut. Ju e dini çfarë qëndrimi kemi pasur si Ministri rreth menaxhmentit. Janë 5 menaxhmente ndërkombëtare që kanë qenë në KEK dhe në periudhën kur Ministria është krijuar ne kemi trashëguar një menaxhment i nënshkruar i trashëguar dhe me përgjegjësi të plotë. Ne nuk e kemi mbështetur menaxhmentin e EZBIA-it jo pse ka qenë i huajë por pse nuk ka pas platformë vizion të qartë për daljen nga situata dhe nga kriza energjetike dhe në bordin e drejtorave ne nuk e kemi përkrahur asnjëherë një projekt të tillë që është vendos që ristrukturimi i KEK-ut të bëhet në bazë të donacioneve financiare që duhet të vinë nga vendet e ndryshme.

Çka më tutje. Ministria është e gatshme të bëjë rishqyrtimin edhe një herë bashkë me komision funksional të gjithë atyre politikave të cilën Parlamenti dhe Komisioni mund mendon që Ministria duhet t'i realizoj[dhe t'i merr përsipër. Ju e dini që është aprovuar strategjia, është aprovuar dokumenti për zhvillimin ekonomik të Kosovës edhe si draft. Prandaj, jemi të gatshëm të pranojmë të gjitha ato sugjerime që vinë nga komisioni, nga grupet, nga deputetët e caktuar që ta bëjmë një përmbledhje gjatë muajve të ardhshëm për ta parë se si është duke zhvilluar sektori dhe si është duke ecur energjetika në Kosovë. Faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. ministër, fjalën e ka Alush Gashi në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryesues. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka mirëpritur iniciativën që në një prej seancave të debatohet çështja e energjetikës. Të bindur se zhvillimi i energjetikës është një prej parakushteve të zhvillimit të vendit tonë.

Ne kemi prit sot që propozuesi për këtë debat në këtë rast Partia Demokratike e Kosovës do të del me rekomandime konkrete për tejkalimin e kësaj gjendje. Ne kemi mirëpritë fjalën e tyre, kemi mirëpritë edhe informatën nga ministri përkatës por mendojmë se për të mos mbetur kjo vetëm një deklarament retorik, kërkojmë që Komisioni funksional i Kuvendit të Kosovës së bashku me propozuesin dhe me Ministrinë përkatëse të përgatit rekomandimet për tejkalim të kësaj gjendje. Dhe ato rekomandime të vinë në Kuvendin e Kosovës dhe si të tilla nëse aprovohen këtu ta mandatojnë Qeverinë e Kosovës për zbatim të atyre rekomandimeve të asaj platforme.

Ne si Grup Parlamentar jemi shumë të interesuar që të jepim kontribut në këtë çështje por duke respektuar procedurat parlamentare dhe duke parë mangësinë në rekomandime e kemi zgjedhur rrugën që përmes Komisionit funksional dhe Ministrisë të provojmë me gjet një zgjidhje. Ju faleminderit z. kryesues.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. Gashi. E ke një minutë, replika një minutë edhe unë e caktoj kohën. Urdhëro. Deputeti Bislimi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. kryesues mirë së të ka ardhur shansi me caktua kohën, faleminderit.

Z. ministër unë kam qenë personalisht në termoelektrana e Kastriotit kam qëndruar gjysmë dite nga njerëzit kompetent jam i informuar që ka kapacitete për të prodhuar energji të mjaftueshme për Kosovën.

Kriza energjetike është e qëllimshme, është e planifikuar që ta qojnë siç u tha edhe këtu drejtë shkatërrimit përfundimtarë KEK-un që thëngjilli i Kosovës t'i epet kompanive të huaja dhe të bëhen termoelektrana që do të furnizojnë Ballkanin e ta zgjedhin krizën energjetike të Ballkanit, kurse pasojat do t'i kenë qytetarët e Kosovës.

Prandaj, në këtë aspekt z. ministër edhe puna që u tha këtu, për punën e pagesës duhet të jetë shumë e qartë që qytetarët tanë kanë aq shumë dëme që KEK-u nuk mund t'i paguajë edhe me e shitë tanë, se dëmet që po i bënë KEK-u janë shumë Faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit. Fjalën e ka deputeti Luzha.

DEPUTETI BERAT LUZHA – Z. ministër, ju u ankuat se keni pas një buxhet të varfër sivjet edhe vitin e ardhshëm. Unë mendoj se nuk e keni merituar as at buxhet që e keni pas për shkak se nuk keni bërë asnjë punë për shkak se Ministria juaj nuk ka asnjë kompetencë as në KEK dhe as në miniera edhe pse e keni Ministri e Energjetikës dhe e Minierave.

Ju thatë se e keni mbështetur KEK-un ,por nuk e di në çfarë aspekti e keni mbështetur. Nëse e keni mbështetur në ato rruga të majme që i ka pas atëherë është në rregull, por KEK-u ju e dini se i ka shkyç nga rryma edhe familjet e dëshmorëve dhe një nga ato familje është familja e doktor Lecit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. Luzha. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla, a flet në emër të AAK-ës ti a qysh flet, urdhëro.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Z. kryesues, z. Mazllom Kumnova ka fol në emër të grupit unë tash foli si deputete.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Atëherë Teuta e merr fjalën, në emër të ORA, ani ja kaloni Gencit pra.

DEPUTETI GENC GORANI – Z. kryesues faleminderit. Zonja dhe zotërinj deputetë. Grupi Parlamentar i ORËS është kyç mjaftë herët në çështjet e strategjisë sa i përket energjetikës për Kosovën. Veçanti kur janë shtruar parimet kryesore në strategjinë për energjetikë dhe në dokumentin tjetër që pasoj pas asaj çka ka të bëjë me tërheqjen e investitorëve strategjik për ndërtimin e energjetikës në Kosovë.

Në Kosovë që nga viti 2000 në sektorin e energjetikës instanca ndërkombëtare më të rëndësishme në Kosovë, ka ndërmarrë studime të hollësishme mbi arsyeshmërin dhe realizueshmërinë e eksploatimit të rezervave të limitit në Kosovë.

Përfundimet e tyre vetëm sa i konfirmojmë pohimet e kahershme të ekspertëve vendorë Kosova disponon rezerva të limitit dhe të parakushteve të tjera të atilla që eksploatimi i tyre me qëllim të prodhimit të energjisë është profitabile. Mandje shumë profitabil dhe për një periudhë kohore që mbulon disa gjenerata.

Por e sotmja e errët e Kosovës është rrjedhim logjik i një vargu të vendimmarrjeve në sferën e energjetikës, nënkuptohet dhe politikës. Veprimet dhe mosveprimet e vazhdueshme në sferën e energjetikës e ka sjell vendin në një gjendje të mjerueshme socio-ekonomike, por edhe një gjendje të pafuqisë së skajshme të politikës vendore, të vetme që mund të pretendoj që ka ligjimitet që buron nga elektorati. Por mjerisht politikës vendore i mungon sovraniteti. Kërkesa për energjinë në rajon, në Evropën Juglindore dhe më gjerë është duke u rritur me shpejtësi të madhe. Është një trend që me siguri të madhe në të ardhmen në të ardhmen do të ketë më pakë energji në disponim në krahasim me kërkesat. Mirëpo, energjia elektrike nuk mund të konsiderohet vetëm si një mall i zakonshëm komercial, sepse është faktor dhe determinues për zhvillimin tonë ekonomik. Dhe nëse jemi të zhvillimi jonë ekonomik në këtë kuvend dua ta rikujtoj se kohë më parë është miratuar Strategjia për energjetikë, ndonëse ne me Rregullore të punës nuk kemi paraparë një procedurë të miratimit të ndonjë strategjie. Ne kemi konsideruar se në një farë dore është miratua është votua me mbivotim, natyrisht, e jo me konsensus të plotë. Një varg vendimesh Ministria i ka konsideruar të miratuara që rrjedhin nga ky dokument. Shumë hapa që janë bërë më vonë nga Ministria dhe ato që më vjen keq që ta presupozoj që do të bëjnë nxjerr nga kjo strategji nga ky dokument strategji dhe shumë shpesh përdoret ky dokument që e ka karakterin gjenerik për të marrë vendime shumë specifike. Shumë shpesh këto vendime specifike faktikisht janë në kundërshtim me vetë strategjinë gjegjësisht interesat tona nacionale.

Kështu nuk përmenden ato që janë të mundshme, përmenden vetëm ato që janë të pamundshme.

T'ia nisi prej mundësive.

Qe sa vjet mëshehet mundësia që varshmëria jonë nga energjia elektrike të zvogëlohet me realizim të thjeshtë të projekteve ekzistuese shumë më të lira dhe të realizueshme. Për ilustrim, një ngarkesë jashtëzakonisht e madhe që ndodhë në sistemin tonë energjetik rrjedh për faktin e thjeshtë që ne popullsia ka nevojë për ngrohje. Vetëm Prishtina harxhon mbi 100 megavat të kësaj energjie. Projekti për bartjen e energjisë në formë të ngrohtësisë nga Kosova B, në Prishtinë ekziston kushton diku rreth 30 milion euro. Është i realizueshëm më pak se tri vjet. Askush nuk merret me këtë projekt, thuhet se është interesi jonë të kemi mangësi të energjisë dhe argument të fortë për ndërtimet e kapaciteteve më të mëdha se ata që na duhen. Ajo energji e ngrohtësisë do të ishte 12 herë më i lirë se kjo që ne e përdorim në formë të energjisë elektrike për ngrohje.

Investimet që bëhen në sistemin energjetik, bëhen shumë më pak aty ku do të kishim efikasitet të madhe p.sh. në sistemin e përçarjes dhe të dispaçingut do me thanë të shpërndarjes së elektricitetit dhe në mënyrë artificiale ne kemi humbje të cilat prapë futen në llogari thuese kemi nevojë për këto. Dhe në këtë mënyrë hap pas hapi vim deri te evaluimet që thojnë se ne kemi nevojë energji më tepër se që realisht kemi nevojë.

Në atë strategji në atë dokument të strategjisë që ka pas edhe në atë kohë plotë gabime, sot mund të lexohet se do të kemi nevojë shumë të madhe për energji elektrike, sepse në vitin 2005 dhe 2006 do të ketë rritje ekonomike 3, 4, 5% . Zonja dhe zotërinj, e dini fortë mirë se jemi stagnacion të plotë në komulim 2 vite nga 5% ju jep shumë më tepër se 10% kjo strategji ka nevojë të rishikohet sa më shpejtë dhe të kalojë në procedurë të miratimit në këtë Kuvend, për ndryshe ne operojmë me të dhëna të pasakta dhe e i nxjerrim konkludimet parësore. Në këtë kontekst Ministria e Energjetikës dhe Minerave ka filluar realizimin e një projekti zhvillimor energjetik i cili përfshinë komponentin në vijim po i ritheksoj, centralin e ri energjetik TCC, zhvillimin e një miniere të re të thëngjillit për njësitë ekzistuese të gjenerimit dhe të këtij centrali C nga 2000 megavat dhe rehabilitimi i disa njësiteve të termocentralit siç e theksoi edhe ministri ekzistues Kosova A. Për realizimin e projektit duhen rreth 1.6 miliard euro për fazën e parë rreth 3 miliard për fazën e dytë. Sipas MEM-it në Kosovë nuk ka burime financiare të nevojshme as publike e as private, natyrisht nëse e vëni pritshmërinë dhe synimin kaq të lartë nuk ka burime financiare, mirëpo sikur ne këto nevoja t'i kishim qitur në nevoja tona reale dhe mundësitë tona ne kishim mund të vijmë deri te një projekt shumë më i thjeshtë më i kapshëm për ne dhe më shpejt i realizueshëm që është hapja e Sibovcit juperendimor me rezerva prej diku 123 milion tonë dhe ndërtimi i një termocentrali prej diku rreth 500 megavatësh. Kjo do të na hapte rrugën që t'i hyjmë këtij projekti më shpejt me participim tonë të rëndësishëm dhe me kohë që do të fitonim për matjen e efektshmërisë të këtyre projekteve. Nëse i hyjmë projekteve 2000 megavatëshe e të ngjashme, kemi hyrë për llogari tjera jo për nevoja tona, hapja e Sibovcit juperendimor është poashtu shumë i rëndësishëm për kapacitetet ekzistuese nëse ne nuk punojmë në këtë optikë atëherë shturja që po kërkohet nga disa parafolës do të ndodhë në mënyrë automatike të termocentralit A dhe B. Kërkesa për shturje të termocentralit B të kapaciteteve të termocentralit B ka konsekuenca jashtëzakonisht të dobëta nuk është momenti ndoshta që t'i hyjmë kësaj por nëse duhet do t'i hyjmë. Sipas planeve të hartuara në ekzekutim e sipër investitori në fjalë për atë 2000 megavat, Sibovci 880 milion tonë do të zgjidhet deri në fund të këtij viti, gjegjësisht për tu shtyr për disa muaj, nga dhënia me konsesion dhe po i referohem një parafolësi që thotë se ne nuk duhet të sillemi si rrogë, e si po sillemi nëse ne po e japim një pasuri natyrore në formë të konsesionit, pra buxheti i Kosovës do të përfitonte diku rreth 150 milion euro dhe ate po e zmadhoj pak dhe do të krijoheshin rreth 1300 vende të punës, 150 milion euro, por ne e diskutuam buxhetin çka bëhet me 150 milion euro në ditë, për resurse me një kontratë deri në shterrje 40 vjeçare, në këtë mënyrë mund të realizohen të hyra buxhetore lehtë shpejt dhe pa rrezik, mirëpo kjo strategji ka të meta, për vetë faktin se i hyhet një procesi kompleks financiar në kohën kur për shkak të statusit aktual fuqi jonë negociuese dhe kontraktuese është e atillë që neve na mohohet edhe një kod internacional telefonik e ne kemi me dhjetra miliona humbje për shkak të kësaj. E meta më e madhe e këtij plani është se në vend se të propozohet një zgjidhje e atillë që të jemi edhe ne investitor të këtij

projekti, këtë rrol po ja japim dikujt tjetër dhe me këtë shpronësohemi nga projekti i vet dhe përfitimet kryesore nga përfitimet dhe funksionimi i projektit, në fakt do të mjaftonte të presim edhe disa muaj deri në statusin e ri të Kosovës shtet i pavarur. Unë e them dhe e themi ne të gjithë nga partija Ora, neve na duhet energjia, neve na duhet projekti por ne duhet të jemi pronar i projektit, ne duhet ta kërkojmë një partner të fortë ndërkombëtar dhe jo një operator komercial, i cili shikon se si mund të vijë deri te koncesioni për këtë eksploatim. Nëse ne pretendojmë që të kemi çfarëdo sovraniteti ne e kemi kapacitetin për të qenë partner i mirëfillt me partnerët tjerë, për ndryshe ne vetë faktikisht jemi duke ja hequr mundësinë e ndërtimit të këtij sovraniteti dhe të statusit në rajon, s'ka status me konsesion, ska jet në rend për ndryshe kishim jetuar shumë më mirë. Unë do ta përfundoj me kaq, sepse koha nuk mjafton. Shpresoj se në të ardhmen do të rihapet debati publik, nuk mund të shkojmë me vendime të marra nga lart. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. Gorani. Ministri lyp fjalën për replikë, unë lus të bëhemi më racional le t'i mbledh dhe ju përgjigjet pak më vonë është shumë më racionale edhe për Kuvendin edhe për problemin. Fjalën e ka Gjylnaze Sylja.

DEPUTETI GJYLNAZE SYLA – Faleminderit. I nderuari z. kryesues, të nderuar ministra zonja dhe zotërinj deputetë.

Ne të gjithë jemi qytetarë të Kosovës dhe nuk jemi të kënaqur me gjendjen e furnizimit me energji elektrike në Kosovë. Por furnizimi me energji elektrike dhe problemi i furnizimit nuk është i tanishëm ai ka ekzistuar edhe më parë.

Këtë problem nuk ka mundur ta zgjedh as UNMIK-u as Qeveria e parë gjithëpërfshirëse. Këtë problem edhe tani nuk ta zgjedh vet një subjekt dhe Ministria e Energjetikës dhe e Minierave e cila nuk ka kompetenca të plota mbi KEK-un.

Megjithatë ministri shprehu gatishmërinë dhe përkushtimin për të punuar edhe më shumë për përmirësimin e gjendjes. KEK-u si dhe ndërmarrjet e tjera publike ende gjenden nën administrimin e AKM-ës, e cila nuk ka qenë transparente dhe e cila duhet të jetë transparente. Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm që në fushën e energjisë duhen investime, pa investime nuk mund ta zgjedhim problemin e energjisë. Legjislacioni i nevojshëm është hartuar dhe aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Ky legjislacion ka qenë parakusht që Kosova të bëhet pjesë e komunitetit për energji të Evropës Juglindore i cili ka për qëllim ... e tregut të lirë të energjisë në Evropën Juglindore.

Në aspektin strategjik Ministria ka organizuar konferencën për potencialet investuese në sektorin e energjisë në Kosovë. Gjithashtu Ministria ka hapur tenderin për ndërtimin e Termocentralit C rehabilitimin e Termocentralit A dhe zhvillimin e mihjes së Sibovcit që do t'i garantojë Kosovës furnizimin e mjaftueshëm me thëngjill për 40 vitet e ardhshme. Realizimi i këtij projekti do ta sigurojë jo vetëm furnizimin e Kosovës me energji, por edhe eksportimin e rrymës elektrike. Ky do të jetë investimi më i madh në historinë e Kosovës pas luftës me vlerë prej 3.5 miliard euro.

Pra, politikat janë gati. Tenderi është në proces dhe pritët që realizimi i projektit ta krijoj KEK-un në njërin nga gjigantët më të mëdhenj të prodhimit të rrymës elektrike në rajon.

Natyrisht se ne shpresojmë se administrimi me KEK-un do të bartet tërësisht në duart e Qeverisë së Kosovës ngase administrimi ose menaxhimi nga ndërkombëtarët nuk është treguar efikas. Menaxhmenti nga një kompani e huaj u dëshmuar si një koncept jo efikas.

Problem tjetër është inkasimi për rrymën e shpenzuar nga konsumatorët dhe trajtimi i rasteve sociale, mos pagesa e rrymës nga qytetarët është një kontribut shtesë i qytetarëve në gjendjen e krijuar. Ne presim nga menaxhmenti i ri punë më të mirë se menaxhmenti i ESBI-së, transparencë më të madhe në rritje të inkasimit. Në periudhën afatshkurt këto parime do të na përmirësonin gjendjen e energjisë. Ndërsa në periudhën afatmesme dhe afatgjatë realizimi i projektit për ndërtimin e kapaciteteve energjetike do të sigurojë stabilitet të qëndrueshëm në furnizimin e energjisë.

Përfundimisht nuk mund të konstatoj se furnizimi me energji elektrike momentalisht nuk i plotëson nevojat e qytetarëve, duhet përkushtim dhe mbikëqyrje më efikase të menaxhmentit të KEK-ut, në mënyrë që të sigurohet prodhimtaria e mjaftueshme dhe qëndrueshmëria ekonomike e ndërmarrjes. Gjithashtu propozojmë që komisioni të involvohet më shumë në këtë punë dhe duke marrë parasysh propozimet nga ky debat dhe gatishmërinë e Ministrisë të punojë së bashku me komisionin t'ia bëjë rekomandimet Kuvendit për përmirësimin e gjendjes në energji. Faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. deputete. Fjalën e ka Rifat Krasniq.

DEPUTETI RIFAT KRASNIQ – Faleminderit z. kryesues.

Sayın Başkanvekili, Sayın Bakanlar, Değerli Milletvekilleri

6+ Parlamento gurubu adına elektrik enerjisiyle memnun olmadığımızı belirtmek istiyorum. Kosova vatandaşlarının vekilleri olarak bizler, bu memnuniyetsizliği bu gün bu Mecliste dile getirmek zorundayız.

6+ Parlamento gurubu milletvekili yanı sıra, yeni kurulan Mamuşa Belediyesinin üyesi ve vatandaşı olarak ben, elektrik enerjisi düzensizliğinin yan etkileri hakkında konuşmak istiyorum. Bilindiği gibi Kosova çok önemli bir dönemden geçmektedir. Bu yeni ve önemli dönemden başarılı ve güçlü bir devletin çıkması için en önemli unsurlardan biri elektrik enerjisinin düzenli olmasıdır.

Mamuşa Belediyesinde birkaç fabrika ve şirketlerimiz mevcuttur. Aynı zamanda Türkiye ve diğer yerlerden belediyemize yatırım yapmak isteyenler var, fakat bizler elektrik enerjisi sorunu yüzünden, yeni şirketlerin açılmasından çok, eskilerinin kapatılması endişesi içindeyiz. Bundan ötürü de Hükümet, bu yeni dönem içerisinde biraz daha fazla çalışmalı ve varolan imkanları sonuna kadar istifade etmelidir.

Konuşmamın devamında Mamuşa ve çevresinde bulunan köylerin karşılaşmış olduğu sorunlardan birine değinmek istiyorum. Belediyemizin merkez olması ve elektrik borcunu ödemeyen bazı köy ile mahallelerin belediyemize bağlı olması, bizim C grubunda yer almamıza neden oluyor. Boşnakların yaşamış oldukları bölgelerde de elektrik enerjisi sorunu mevcuttur. Bu sorunun bir an önce çözümlenmesini istiyoruz. Bu sadece Mamuşada değil, genelde Kosova düzeyinde uygulanan bir yöntemdir.

Düşünceme göre bu yöntem, iyi olmayan ve bir an önce değişmesi gereken bir yöntemdir. Türkçemizde bir atasözü vardır: **“Kurunun yanında yaş da yanar”** ve sanırım bu atasözü konuşuklarıma denk gelmektedir.

İlginize teşekkürler! Faleminderit z. kryesues.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. Krasniq. Demir Lima, Selviye Halimi flet, kur duhet të flas Demir Lima.

DEPUTETJA SELVIJE HALIMI – Faleminderit i nderuari kryesues, unë kërkoj falje po mu ka pështjell diku kartela derisa ta gjejë.

Unë kam marrë një informacion nga ministri i Energjisë dhe Minierave dhe dëgjova dhe fjalimin e tij në Kuvend, mirëpo në faqen e parë te hyrja në pasusin 3 thotë se sa i përket kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-ës për debat mendoj se ai duhet të mbetet në kufijtë e fushë veprimtarisë së MEM-it. Është krejt në rregull por është shqetësuese. Do me thanë na duhet të kufizohemi vetëm në këtë materialin ku na ka afruar ministri te shtojca 1, ku paraqitet rregullorja mbi bazën e cilës janë përcaktuar fushë veprimtaria Ministrisë së Energjisë dhe duhet të ndalemi dhe të mos diskutojmë për të gjitha problemet tjera të cilat po i shkakton mungesa e rrymës elektrike në vend.

Nëse nuk ka kompetenca së paku duhet të kemi informacione të sakta. Ministri paraqit miliardë orë e prodhuara të energjisë elektrike në dy pika ku prodhohen dhe energjinë elektrike të importuara që kërkohet për me i plotësua kërkesat në vend.

Unë kisha me bë një pyetje se tërë kjo orë e energjisë elektrike prodhohet dhe importohet, a po arrin vërtetë te konsumatorët a po regjistrohet në orë, sipas informatave që ka nuk janë zyrtare ato duhet të jenë zyrtare në mënyrë që mund t’i parandalojmë disa gjëra të tjera të këqija nuk arrin ajo humbet ajo nuk regjistrohet te konsumatorët dhe konsumatorët e ndershëm kur themi gjithherë se s’po paguhet nga konsumatorët dhe konsumatorët janë fajtorë ne në një formë po i degradojmë ata dhe po i ofendojmë ata, sepse nuk kemi arrit që të bëjmë një ndarje zyrtarisht të përpunuar dhe lista zyrtare se çka po ndodhë me energjinë që prodhohet dhe importohet. Kemi ardhur në këtë gjendje, qytetarët e Kosovës paguajnë energjinë elektrike përmes faturave, paguajnë energjinë elektrike përmes tatimeve, në një mënyrë indirekte nga buxheti i Kosovës që i epet ndihmë KEK-ut. Paguajnë për dëmet që u bëhen në mungesës të energjisë elektrike dhe kur ajo ndërpritet dhe vjen me fuqi të ndryshme dhe shkakton probleme të elektroteknikës që kanë në shtëpitë e tyre. paguajnë për dëme që u shkaktohen nga djegiet për shkak të dritës me qirinjtë apo në forma të tjera. Paguajnë për dëmet për shërim te mjeku për shkak të humbjes së aftësisë së dëgjimit nga gjeneratorët. Paguajnë kur shkojnë për shërim te mjeku për shkak të ftohjeve që u shkaktohen qytetarëve kryesisht në pjesët urbane. Konkretisht mund të flasim për Prishtinë, sepse shumica jemi t’u jetua në Prishtinë dhe e dimë në objektet e larta në mungesë të energjisë elektrike pompat e humbin fuqinë për të përçaruar ujin lartë në objekt dhe e humbin fuqinë për të përçaruar ngrohjen nga termokosi në pjesët apo nga katet e larta të objekteve të banimit. A thua kush duhet të jep llogari për të gjitha këto. Do të thotë KEK-u, burim i shumë problemeve që u bëhen qytetarëve.

Në kompetencat e tuaja pikën 7 te Rregullorja, te shtojca 1 thuhet: promovon veprimtari që kanë për qëllim zvogëlimin e ndotjes së mjedisit si rezultat i veprimtarive që lidhen me energjinë dhe minierat. Cilat janë ato veprimtari që janë bartë deri tash lidhur me mbrojtjen e mjedisit, pikërisht Kastrioti është pikë e nxehtë që shkakton ndotjen e mjedisit dhe absolutikisht ,përveç pamjeve tmerruese në televizione që paraqiten herë pas here për sëmundje që shkaktohen këtyre banorëve asgjë tjetër. Unë e kam shumë të qartë se vetëm një Ministri nuk mund të bëjë këtë. Por, ku janë ato prioritete të programit tuaj qeveritarë, kompletë qeverisë, që nuk bëjnë veprime kronologjike në mënyrë që të evitohet këto pasoja.

Për KEK-un dhe në emër të KEK-ut në Hade kemi krijuar një izolim të një numri të caktuar të banorëve i kemi larguar nga Hadja ata të cilët nuk kanë qenë shumë të rrezikuar në emër të asaj se është rrezikshmëri shumë e lartë edhe për 24 orë po shembet Hadja do të hiqen banorët. Por ka mbetur pa u larguar ata që pikërisht është dashur të largohet dhe mihja ka arritur në 60 metra afër shtëpive të banimit. Bile, bile nuk është bërë asnjë matje gjeomekanike lëvizjes se çka do të ndodh aty. Kemi kërkesa, kërkesa nga ata banorë i ka ardhur edhe Qeverisë të gjithë krye institucionalistëve me nënshkrimet e atyre banorëve dhe kërkesa që të trajtohen njësojë.

E tash flasim edhe për një zhvendosje tjetër në Sibovc edhe këtu paguajnë qytetarët e Kosovës përmes tatimeve duke i larguar banorët në mënyrë mund ta them shumë të pa të keq se mbajë përgjegjësinë për fjalën e thënë publike në mënyrë mashtruese u punua me Hadën, pavarësisht se kur është filluar dhe qysh është fillua mirëpo kemi ra në lajthitje si Kosovë. E tash çka. Tash a do të jetë një lajthitje tjetër me Sibovcin. Do ta furnizojmë Ballkanin, e do ta shkatërrojmë Kosovën, e bajshimë me shëndet mirëpo a do të tolerojmë ne si deputetë këtë në emër të qytetarëve.

Nuk mund gjithmonë të kemi arsye se s'patëm kompetenca. Aty ku s'ke kompetenca mos hynë ose dil publikisht edhe thuaj, për këtë është përgjegjës filan fisteku. Sa është numri i donacioneve që janë dhanë për KEK për shtatë vite, askush nuk e din sa është numri i parave apo mjeteve që kanë ardhur? A s'paska pas mundësi me tana ato donacione dhe mjete të dhëna nga Qeveria e Kosovës që të bëhen ato renovime që qenkan shkakua për 15 vite? Kjo nuk është e vërtetë dhe nuk ka njëri që mund të më bindë. Jo mua, por as qytetarët.

Andaj është një urgjencë e Qeverisë që të marrë hapa konkretë e jo gjithherë të dëgjojmë s'po paguan konsumatori, s'po paguan konsumatori, pikërisht te amvisëria. Nuk janë tu u bë ato prodhime t'u marrë me biznes nëpër shtëpiat e tyre apo nëpër banesa e tyre. Orientohuni te ndërkombëtarët ku janë të vendosur sa po paguajnë, te institucionet e te bizneset. Më pastaj le të vjen amvisëria në mënyrë të kategorizuar duke përfshirë të gjitha grupet e shoqërisë. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. deputete. Unë ju lajmëroj që kemi 10 njerëz që janë të interesuar të bisedojnë për këtë temë. Llogarit edhe dy në fund që ka të drejtë propozuesi dhe ministri përgjigjen do me thanë i bien 12 qe edhe njëri u paraqit

shpejtë e shpejtë u bë 13. Unë ju propozoj që të punojmë edhe nja 10 minuta do t'ju jap pushim deri në orën 3 dhe të vazhdojmë. fjalën e ka Gani Koci.

DEPUTETI GANI KOCI – Faleminderit z. kryesues. kur po i dëgjoj disa debate këtu rreth kësaj çështje po krijohet përshtypja se ne vërtetë po diskutojmë rreth ndonjë projekti të madh për energjinë elektrike ose segmentin energjetik në Kosovë.

Ndërsa tema më duket është shumë e qartë dhe shumë e thjeshtë, situata, kriza energjetike në Kosovë sot, në këto çaste, në këto momente dhe dalja prej kësaj krize.

Nga materiali që na ka ofruar ministri, nuk shoh se ka zgjidhje që të dalim nga kjo situatë dhe këtë dimër ta kalojmë pak më rehatshëm se dimra tjerë. Përkundrazi sipas të gjitha parashikimeve ky dimër do të jetë shumë më i vështirë në aspektin e furnizimit me energji elektrike se sa që i kemi pas më herët deri tani.

Është thanë shpesh dhe është diskutuar shpesh se KEK-u, sepse kur flitet për energjetikën ne gjithmonë e nënkuptojmë KEK-un dhe nuk kemi tjetër operator ta quaj kështu për energji elektrike. Është thanë se është investuar shumë gjatë këtyre 7 vjetëve dhe për 7 vjet diku, t'u marrë parasysht edhe donacionet edhe ato nga Qeveria shumë kalojnë 1 miliard dollarë. Dhe po të shndërroheshin këto në megavat të energjisë elektrike atëherë ne do të kishim kapacitetet të reja në Kosovës diku rreth 1000 megavat me këto, sepse shkon një me një, është çmimi ata që i dinë këto, megjithëse unë nuk kam ndonjë eksperiencë të madhe në këto çështje.

Çështja nuk është te inkasomi, çështja është te furnizimi me energjisë elektrike. Në vitin 2004 ne kemi miratuar tri ligje në bazë që rregullojnë këtë fushë. Ligjin mbi energjinë elektrike, Ligjin mbi energjinë dhe Ligjin mbi rregullatorin e energjisë elektrike. Në bazë të këtyre ligjeve, qytetarët e Kosovës, Kosova duhet të furnizohet me energji elektrike, ka qysh dhe si, duhet të furnizohet ajo. Dhe këtë obligim ligjor Qeveria deri më tani nuk e ka krye dhe problemin për këtë e hedh gjithmonë te inkasomi i energjisë elektrike. Nuk konsideroj se inkasomi i energjisë elektrike është problemi numër një i kësaj gjendje të energjetikës në përgjithësi. Për mua është problemi i fundit dhe si i tillë duhet të trajtohet.

Problem i parë, për mua është akoma edhe pse ligjet, këto ligje që i përmenda përcaktojnë se çfarë do të jetë statusi i KEK-ut ose i prodhuesve të energjisë elektrike, furnizuesve tjerë. Deri më sot nuk dihet dhe cili është statusi i KEK-ut dhe çfarë statusi do të ketë në të ardhmen. Këtu ka përmend ministri thotë hapat për ristrukturim dhe për shturje. Unë them për ristrukturim jo, për shturje në kuptimin negativ po. Shturja e KEK-ut në kuptimin negativ është nisë më herët, po vazhdon edhe sot dhe sikur ne shqiptarët jemi mësuar se nuk mund të ngrisim diçka të re pa e prishë atë që është pak më e vjetër. Edhe pse mund të jetë funksionale. Dhe krejt orientimi dhe përkundër zellit të madh që në fillim ka paraqitur ministri në këtë fushë, krejt orientimet janë shumë të koordinuara që të shkatërrohet KEK-u në tërësi dhe të filloj diçka e re në vitin 2012 dhe të vazhdojë deri në vitin 2018.

Tash përfundoj faza e parë në vitin 2012 dhe dikur ajo e fundit 2018 e nëse 2025-tën.

Pse Qeveria ka shkelë dhe po shkel me dy këmbët në ligjet të cilat i ka miratuar? Urdhëroni ju lutem angazhimi njëvjeçar në këtë vit nuk ka qenë në rregullimin e gjendjes të energjetikës. por me marrjen se si të ngriten kapacitete të reja duke i harruar këto të vjetrat dhe ka shkuar deri në atë shkallë sa ka propozuar edhe ndryshime të ligjit të energjisë elektrike dhe të rregullatorit të energjisë elektrike dhe kompetencat që kanë qenë të parapara në organin e Rregullatorit të energjisë elektrike t'i marrë për vetë veten e vet në mënyrë që të vazhdojë me procesin e tenderimit që thua tash për kapacitetet e reja.

Unë vetëm dua të bëjë një pyetje. Këtë çështje e kam shtruar edhe më herët. Si mund të flitet për koncesioni ose dhëna me koncesion kur në Kosovë nuk kemi Ligj të koncesioneve, cilat janë ato të mira të Kosovës të cilat mund të jenë objekti i koncesionit. Cilat janë ato të mira dhe në çfarë kushtesh duhet të open me koncesion. Ne nuk e kemi këtë, prandaj është një ngutje tepër e madhe edhe te formimi i atyre komisioneve tenderuese gjithnjë me ministra dhe me kryeministrin në krye dhe ngutja që ta kryejnë këtë fazë. Por kjo është një çështje tjetër.

Sa i përket furnizimit me energji elektrike, nuk është problemi ndoshta as te rrjeti që është shumë i dobët, nuk është problemi ndoshta as te inkasimi që vërtetë e dimë shkallën. Unë konsideroj se kapacitet që ka, me këto kapacitete ekzistues ne kishim me mujt me dalë nga kjo gjendje me ndonjë shtesë të vogël të importit të energjisë elektrike. Le të më thotë ministri cili është furnizimi sot me thëngjill i gjenerimit? Nga projektet që ka pas ky divizion në vit duhet 7 milion tonë thëngjill sa i prodhon sot në ditë. Në ditë do të duhej 20 milion a prodhon 9 milion tonë thëngjill do të thotë 50% të planit që këto kapacitete t'i japin maksimumin e tyre në energjinë elektrike. Duhet të them edhe një gjë tjetër. As Serbia, okupimi, nuk i ka shkaktuar minierat më shumë se sa menaxhmenti i sotëm i minierave që ka vepruar me to mbi 170 milion tonë thëngjill janë mbuluar dhe kërkohet hapja e minierave të reja. dhe a nuk është një konflikt interesi z. ministër kur babai është drejtor i divizionit të thëngjillit, ndërsa i biri drejtor i Departamentit të minierave dhe mineraleve në ministrinë tuaj.

Jo të vjetra, por janë shumë të reja këto informacione, keni filluar shpronësimin në fshatin Hade. Ju lutem në ç'fazë keni shkuar, keni nda mjete të cilat u dash KEK-u t'i realizoj sot, ku janë ato mjete, urdhëroni pyetni, ku janë ato mjete? Qytetarët po vinë edhe në dyert e KEK-ut, mjete nuk ka. Ku kanë shkua në cilën linjë buxhetore kanë shkuar. Mbi çfarë baze kanë shkua ato.

Në anën tjetër, unë nuk dua ta fajësoj njerëzit që ndoshta që punojnë në KEK, njerëzit e thjeshtë, por nuk ka pas një politikë mirëfilltë kadrovike në KEK, janë ardhur njerëzit në vend udhëheqëse që nuk kanë pas kur eksperiencë të fushën e energjetikës i kanë prurë bartësit e tyre që u qëndrojnë mbrapa, qëllimet dihen fare mirë.

Sa ekskavatorë punojnë sot mihjet e qymyrit, t'u ka mbulua ekskavatori në vlerë prej 10 milion eurove, a jep dikush llogari, kanë qenë dy avari të mëdha, a është marr kush në përgjegjësi. Në raste të tilla do të duhej të vepronin edhe gjykatat, do të duhej të vepronin edhe policia. Nuk ka vepruar as në rastin e parë, as në rastin e dytë. Dhe për këto edhe Qeveria i mbanë veshët e mbyllur. I mban veshët e mbyllur ndoshta nga pamundësia dhe jo nga kompetenca e duhur. Por së paku të thuhet publikisht, jo të mbahen në xhepa edhe

menaxherët edhe drejtoritë edhe ata që sjellin përfitime të caktuara, nuk bëhet zbulimi i mijës me traktorë, ju lutem. Shko këqyrni sa kompani private janë angazhuar për me nxjerr thëngjill edhe për me zbulua mihjet dhe sa ekskavatorë për të cilën thuhet janë dhënë mjetet për riparim, ju qëndrojnë të paangazhuar. Përgjegjësi e kujt është kjo;? Përgjegjësia është subjektive. Përgjegjësia është juaja, përgjegjësia është jona, përgjegjësia është e atyre që menaxhojnë KEK-un sot. Dhe në fund të fundit nuk dua të hedh përgjegjësinë te konsumatori i shkretë që as nuk ka energji kualitative, as nuk furnizohet me kohë. Tha rritja e inkasimit 37% nga viti i kaluar. Rritja është bërë në një mënyrë, kjo ka qenë rritje e rastit. Pse rritje e rastit? Qeverisë dhe institucioneve qeveritare që i kanë pasur borxh KEK-ut është dhënë një urdhër, të bllokohen llogaritë dhe të gjuhen. Nuk ka rritje. 50% e energjisë elektrike nuk dihet kah shkon. Nga 50% që faturohet të nxjerrë vetëm 25%. Urdhëroni angazhohuni në këtë drejtim dhe do të dilni prej situatës. Ju nuk na ofruat qartë cila është puna që duhet ta kryeni prej sot deri më 1 janar që ne të kemi rrymë elektrike.

KRYESUESI SABRI HAMITI - Ju faleminderit z. Koci. E keni një orë pushim për drekë. Të jeni këtu në ora 3,00.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Vazhdojmë me debatin, fjalën e ka Naim Maloku, mungon, Ibush Jonuzi.

DEPUTETI IBUSH JONUZI – Faleminderit i nderuari kryesues, edhe pse u tha shumë do të përpiqem me qenë shumë i shkurt në mënyrë që të mos përsëriten gjërat që u thanë deri më tani.

Materiali i përgatitur nga Ministria edhe pse u tha këtu, mendoj se është një material mjaft përmbajtësor dhe gjithëpërfshirës që meriton një përshëndetje për të gjithë ata që kanë punuar dhe ju kanë plasuar deputetëve për këtë temë mjaft të ndjeshme që po debatojmë sot. Ne si komision funksional nuk kemi ndejt në këtë drejtim, por jemi angazhuar për të mund me dhënë kontributin tonë për çka kemi obligim. Si komision funksional më 5 të këtij muaji e kemi organizuar një takim me temë të veçantë: “Situata energjetike në Kosovë” në të cilin takim kanë marrë pjesë strukturat më përgjegjëse të kësaj fushe që mund të them se nga ai takim si konstatim i përgjithshëm se takimi ka qenë mjaft konstruktiv edhe nga ana e deputetëve si dhe të pranishmit që kanë qenë prezentë, pastaj nuk jemi ndalur me atë dhe me 11 të këtij muaji kemi organizuar një vizitë pune në KEK nga e cila vizitë jemi pritur prej bordit të KEK-ut komplet, ku gjithashtu jemi njoftuar me hallet, problemet dhe preokupimet si dhe objektivat që i ka KEK-u për tejkalim apo për zbutje të situatës së rëndë të energjetikës. Një fakt që mund të na jep shpresë prej asaj vizite po e potencoj se këtu u tha se gjendja e rëndë e minierave në thëngjill sipas asaj që raportuan përgjegjësit kryesor thuhet se në asnjë vit deri më tani pas lufte nuk është punuar më tepër në djerrinë që është tejkualuar plani i prodhimit ajo është një garancë shumë e madhe se në perspektivë që do të thotë për vitin e ardhshëm ka gjasa që çështja e sigurimit të thëngjillit për termocentralet tona të jetë në nivel shumë më të mirë se deri më tani. Nuk do të ndalem shumë pse ka ardhur deri te ajo, por po them se është një shpresë e madhe se gjendja do të jetë më e mirë.

Është thënë më heret dhe u tha edhe tani se bëhen keqpërdorime të energjisë elektrike edhe në atë drejtim KEK-u nuk ka ndejtur por ka punuar si u raportua atë ditë me

vendosjen e njehsorëve në të gjitha daljet që numërojnë diku mbi 350.000 shfrytëzues që edhe kjo është një dëshmi se do të punohet për me mund që sadopak me mund me e zvogëlue keqpërdorimin e rrymës që bëhet në mënyra jo të mira, nuk janë vetëm këto probleme që ballafaqohemi ne, por pa e zgjatur e kisha përmbyllur me atë që e tha profesor Alushi që e mbështes plotësisht propozimin e tij se ne si komision funksional bashkarisht me ministrinë do të ulemi, do të punojmë që edhe deri më tani kemi punuar bashkarisht do t'i hartojmë rekomandimet dhe me ato rekomandime do të dalim para Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI - Faleminderit z. Jonuzi. Fjalën e ka Xhavit Haliti.

DEPUTETI XHAVIT HALITI - Faleminderit z. kryesues. Është një fakt që situata energjetike në Kosovë është bërë shqetësim jo vetëm për qytetarët të cilët kanë nevojë të përditshme, gjithçka që jeton ka nevojë për dritë, prandaj shqetësimin për situatën që e kemi mendoj se është i drejtë që është ngrit të diskutohet dhe është e mirë që po bëhen përpjekje për të gjetur rrugë dhe për të ndërtuar strategji të caktuar për të dalë nga kjo situatë. Kosova për të cilën po trumbetojmë shumë që po futemi në partneritetet ekonomike qoftë të rajonit, Ceftas, qoftë kudo tjetër është në një krizë të thellë ekonomike do të thoja dhe njëra ndër shkaqet kryesore të kësaj krize është edhe energjia të cilën nuk e ka. Kjo ekonomi ekzistuese e Kosovës, prodhuesit dhe investitorët e huaj partnerët e huaj strategjik kanë problem me ardhë e me investu në Kosovë pikërisht për shkak se nuk ka energji elektrike. Unë e kamë parasysh domosdoshmërinë e përpjekjes për të investuar, për të gjetur investitorë të cilët do të rrisnin kapacitetet prodhuese të termoelektranave të Kosovës e në veçanti kriza e madhe pas mbylljes së termoelektranave bërthamore në Bullgari ka imponuar ose më mirë të themi se ka dalur si variant ndoshta për t'i përmbushur disa nga nevojat me energji elektrike të rajonit edhe Kosova me pasuritë e veta dhe me linjitin që e ka. Unë nuk kam asnjë dyshim që kompanitë serioze të investimeve e kanë parasysh që investimet të bëhen në përputhje me standardet evropiane për mbrojtjen e ambientit dhe do të thoja me qenë se unë pak a shumë i kamë lexuar materialet dhe e kamë parasysh për kujdesjen e vet të ngarkuarve me këtë çështje që mënyra e eksploatimit të xeheve në Kosovë të linjtit të jetë e rregulluar me rregullat e standardet që i ka edhe Evropa. E kemi një situatë të rëndë tek popullata vendase e cila në një mënyrë ose në tjetrën çështjen e energjisë elektrike po e trajton si borxh të Qeverisë ndaj saj, unë ndoshta pak ma ndryshe do ta trajtoja këtë problem sepse ky është mallë vërtet që shitet, por aq sa ka njeriu shet dhe ate që e shet duhet me i marrë paret që e ka shitur. Keqpërdorimet janë të nivelit të papërgjegjshëm të atyre që i keqpërdorin, unë dua ta mbështes këtë tek një e vërtetë, në një fshat kanë shkuar me shiqu si është gjendja me energjinë elektrike dhe e kanë gjetur njeriun duke shkurtuar dru në oborr dhe me ngrohshen e ndezur pranë cungut të druve dhe i thojnë pse e ke qitur ngrohshen në oborr dhe thotë se po ngrohem këtu se me hy brenda po e zhyti tepihun në shpi, prandaj mendoj se edhe keqpërdoruesit ose ata që nuk kanë me e pagu Qeveria do të duhej të toleronte ose buxheti i Kosovës do të duhej të toleronte shpenzimin minimal të saj, por jo shpenzimin pa kriter me qenë se nuk ka kush e dërgon në burg, me qenë se nuk ka kush ja shkëput rrymën dhe ska kush merrë masa. Prandaj në përputhje me këtë unë do të kërkoja që të krijohen mekanizma të cilët kontrollojnë së pari mënyrën e blerjes së energjisë për Kosovën, e cila dihet tani se përmes saj korrupsioni është i hapur dhe është

vështirë me ditë se sa ke blerë sot dhe sa ke blerë dje, prandaj domosdoshmëria e investimeve në Kosovë është çështje urgjente. Por mendoj se për të investuar në sistemin energjetik të Kosovës ne duhet të jemi të kujdesshëm në këtë rast ata që kanë përgjegjësinë që të përzgjedhin partnerë strategjikë në investime në Kosovë dhe atyre t'ju jipet drita jeshile për të investuar. Çështje tjetër me qenë se borgjet janë shumë të mëdha të atyre që nuk paguajnë energji elektrike unë propozoj që Qeveria të bëjë një Projektligj dhe të miratohet në Parlament për amnestimin e të gjithë atyre që nuk kanë paguar energjinë elektrike deri në verën e këtij viti, e kamë fjalën për popullatën dhe qytetarët dhe në kuadër të kësaj Qeveria respektivisht KEK-u dhe Ministria e Energjetikës të formojë policinë e energjisë, dritave e cila do të merret drejtpërsëdrejti me kontrollimin e orëve, me kontrollimin e hargjuesve të energjisë elektrike dhe me denimin dhe denoncimin e atyre që hargjojnë dhe nuk paguajnë. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. Haliti, fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi.

DEPUTETI BAJRAM KOSUMI – Faleminderit i nderuari kryesues, të nderuar ministra, kolegë deputet.

Shqetësimi për mungesën e energjisë elektrike në Kosovë është i përbashkët për të gjithë qytetarët e Kosovës edhe për Qeverinë edhe për ministrin, edhe për neve deputetëve të pozitës dhe opozitës dhe për çdo qytetar të Kosovës. Dallimet në këtë shqetësim mund të jenë në termat dhe nocionet që përdoren për të shprehur këtë dallim, dikush thotë katastrofë, dikush është degradim psikik për popullin, dikush varfëri etj, por po duket hapur se esenca është e njejtë, jemi të pakënaqur me furnizimin e qytetarit të Kosovës me energji elektrike, por ne këtu edhe Qeveria dhe Kuvendi nuk jemi për të përshkruar këtë furnizim jo të mirë me energji elektrike, nuk jemi as për ta vajtuar këtë gjendje të mjerueshme, por jemi për të bërë propozime dhe për të gjetur zgjidhje eventuale si mund t'i zvogëlojmë efektet negative të kësaj situatë dhe si mund ta përmirësojmë këtë situatë që të shëndërrojmë në diçka shumë më pozitive. Në këtë drejtim propozimet e Kuvendit të Kosovës çoftë në formë të rekomandimeve ose propozime në formë të rekomandimeve të Komisionit përkatës në Kuvend që do të mund t'i bënte nga diskutimet që janë bërë këtu do të ishin të mirëseardhura edhe për neve, por edhe për Qeverinë dhe Ministrinë përkatëse. Më lejoni që problemet ekzistuese në furnizimin me energji elektrike t'i paraqes në mënyrë të përmbledhura do t'i ndaja në tri grupe të problemeve themelore. Në grupin e parë të problemeve janë problemet e natyrës që kanë të bëjnë me menagjmentin e KEK-ut dhe me kompetencat e Ministrisë së energjisë dhe minierave në fushën e energjisë elektrike, në këtë grup të problemeve dhe të vështirësive ne e dimë të gjithë se gjatë 7 viteve të pasluftës ka pasur vështirësi të mëdha në menaxhmentin e KEK-ut, asnjëherë nuk kemi qenë të kënaqur me mënyrën e menagjimit të KEK-ut, për më tepër para 3 viteve Qeveria Rexhepi ka nënshkruar një marrëveshje me një kompani ndërkombëtare për të menagjuar me KEK-un me shpresë se do të menagjohet më mirë e vërteta ka dalë se kjo kompani jo vetëm që nuk ka menagjuar më mirë, por ka shkuar duke rënë teposhtë, ka menagjuar më keq se sa që ne besojmë që ekspertët tonë vendorë mund të menagjojnë me KEK—un dhe kjo ka krijuar probleme gjatë tërë kohës, tash muajve të fundit është zgjedhur drejtori i Kosovës i KEK-ut znj. Pranvera Dobruna dhe unë mendoj se Ministria duhet të përkrahë dhe të ndihmojë menagjmentin vendor të

KEK-ut që ata të kapen me problemet dhe t'i zgjidhin problemet që janë të këtyre natyrave në KEK-ë që kanë të bëjnë me ristrukturimin ose me rrjetin shpërndarës ose me gjëra të tjera që janë kompetencë e menagjmentit të KEK-ut.

Unë besoj se Ministria ka bërë mirë dhe ministri ka bërë mirë kur është implikuar në ndihmën ndaj menagjmentit të KEK-ut, nuk mund të presim për shkak se e menagjon KEK-un një ndërmarrje ndërkombëtare që të presim që t'i dalë flaka KEK-ut dhe ne të themi se nuk patëm faj ne, Ministria duhet të involvohet edhe ku nuk ka shumë kompetenca edhe kur e ka një masë të vogël të kompetencave, duhet të ndërhyjë sepse KEK-u është i yni, KEK-u është i Kosovës dhe nuk mund që në fund t'i lajmë duart dhe të themi se e po na nuk patëm kompetenca, por dikush tjetër e pati fajin ose dikush tjetër e pati fajin dhe ne të dalim të terur në breg. Ministria ka bërë mirë që është involvuar, ministri ka bërë mirë që është involvuar dhe e gëzon përkrahjen e Kuvendit dhe të deputetëve në këtë Çështje, por do të ishte mirë prej Kuvendit që ne në rekomandimet tona të angazhohemi që kompetencat në menagjimin e KEK-ut të kalojnë komplet në duar të Ministrisë dhe KEK-ut.

Grupi i dytë i problemeve ka të bëjë me pagesën e energjisë elektrike, me borgjet ndaj KEK-ut dhe me çështjet sociale. Çështja e borgjeve të KEK-ut ndaj KEK-ut është një çështje e ndjeshme dhe Ministria së bashku me KEK-un besoj se duhet të hartojë një plan se çka të bëhet me borgjet e qytetarëve ndaj KEK-ut në rast kur borxhlinjtë e KEK-ut janë raste sociale që t'u folen ato borgje, por në rast se borgjlinjtë nuk janë raste sociale që të ndërmerren veprime konkrete që energjia elektrike e shfrytëzuar gjatë këtyre vjetëve të paguhet. Po kështu duhet të veprohet edhe me të gjithë qytetarët dhe ndërmarrjet e tjera që duhet të paguajnë për energjinë e hargjuar, po flasim për energjinë e përdorur, energjia është mallë si çdo mall në treg, ke shkuar në treg dhe ke blerë një mall duhet ta paguash edhe energjia është e tillë, për ndryshe KEK-u nuk mund të hec përpara dhe nuk mund të sigurojë rrymë.

Sa ju përket rasteve sociale edhe tash heq Qeveria një barrë të madhe prej buxhetit të Kosovës duke i paguar rastet sociale në energji elektrike, unë nuk e di përmendësh shifrën sa milion janë dhe sa njerëz në Kosovë nuk paguajnë, të cilëve ju paguan Qeveria energjinë elektrike, por duhet të bëhet një dallim i veçantë, në rastet sociale duhet t'u paguaj Qeveria por në rastet që nuk janë raste sociale KEK-*u me mekanizmat e vetë nuk duhet të toleroj mospagesën e energjisë elektrike.

Çështja e tretë dhe e fundit e problemeve si të gjendet zgjidhja, si të dalim prej kësaj situatë, qoftë brenda 2 -3 muajve të ardhshëm që na presin, qoftë brenda 10 vjetëve të ardhshëm. Prej 1 janarit 2007 gjendja në energji elektrike mund të jetë edhe më e vështirë se sa që është sot për shkak të mbylljes së dy termocentraleve në Bullgari, çmimi i energjisë elektrike do të shkoj duke u rritë dhe nuk do të zvogëlohet dhe kjo e vështirëson situatën tonë dhe buxhetin tonë dhe Ministria së bashku me Komisionin e Kuvendit duhet të hulumtoj edhe ato propozime që sot bën deputetët këtu qoftë me ngrohjen e Prishtinës ta zëm ku mund të reduktohen megavatët e hargjuar, qoftë me minicentralet ujqorë, hidrocentralët e vogël që janë etj, por të gjejë edhe forma alternative të prodhimit të energjisë elektrike, por çështja themelore është si ta zgjedhim problemin në vijë afatgjate, unë e përgëzoj ministrin dhe ministrinë dhe unë besoj se Ministria ka bërë shumë, ka vepruar shumë drejt që e ka filluar me kohë përgatitjen për ndërtimin e termocentralit të ri me 2000 ose sa megavatë, kjo një procedurë të gjatë që zgjatë me vite edhe përgatitja e dokumentacionit edhe hapja e tenderit dhe mbyllja e tenderit mund të

shkojnë edhe 2 vjet dhe të mos kryhen këto procedura, do të kryhet statusi final dhe unë besoj se do të kryhet përpara se të mbyllet tenderi për termocentralin e ri etj. Por do të shkojnë edhe 5-6 vjet të tjera deri sa të funksionalizohet termocentrali i ri, kërkesa për energji elektrike është në përputhje me ndërtimin e termocentralit të ri, kërkesa për energji elektrike dhe kërkesa për zvarritje të procesit për termocentral të ri kundërshtohen në mes veti, nëse kërkonti që të zvarritet procedura për termocentral të ri, përgatituni që të kërkonti ose të ballafaqoheni me mungesë të rrymës elektrike dhe e kundërta. Unë po i shpreh përkrahje dhe po e përgëzoj kryeministrin Çeku dhe ministrin e tij për punën e guximshme por edhe të mençur që e kanë bërë në këtë drejtim. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Fjalën e ka Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI - Unë nuk kam asgjë kundër që ish- kryeministri i Kosovës, Bajram Kosumi ka konsiderata për ministrin e vet Ethem Çeku mund të ketë edhe arsye personale, mirëpo ky nuk e ka të drejtën se askush në Kuvend nuk ja ka dhënë të drejtën që të shprehet se ministri e gëzon përkrahjen e Kuvendit. Në qoftë se ai e gëzon përkrahjen tënde ai nuk e gëzon përkrahjen e Kuvendit ose së paku nuk e gëzon përkrahjen e grupit parlamentar të cilit unë i takoj. Prandaj kisha pasur shumë dëshirë që herat e tjera kur folni në publik dhe kur të shprehni mendime hapur në publik të keni konsiderat për fjalët që i thoni sepse ky Kuvend funksionon në dy blloqe, ekziston pozita dhe opozita dhe nuk mund të kamuflohet këtu Kuvendi me punë të Qeverisë, dihen përgjegjësitë janë të ndara, ekziston ekzekutivi dhe ekziston legjislativi apo pushteti kontrollues, ne bëjmë kontrollin, ne nuk merremi me politika operative nëse ju e përkrahni është çështje e juaja, është shumë normale që e përkrahni sepse jeni pjesë e atij koalicioni, por ne si opozitë nuk e përkrahim Ministrinë me këto politika që po i bën, kur t'i bën të mira sigurisht që do ta përkrahim. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI - E dëgjuat replikën, atëherë fjalën e merë Bajrush Xhemajli .

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Faleminderit z. kryesues, përshëndetje për të gjithë, për ministrin Çeku.

Edhe unë dua të filloj se gjendja në energjetikë është tepër e rëndë pothuajse në kolaps dhe për më keq pa shenja përmirësimi përkundrazi, po vjen çdo dit e më shumë duke u përkeqësuar kjo gjendje, pastaj disa probleme siç u tha edhe këtu energjetike janë të hershme dhe nuk kanë lindur brenda natës por çështja shtrohet se përse nuk po pakësohen ato, por po ndodh e kundërta a thua se kush është fajtor për këtë dhe kush duhet të mbaj përgjegjësi, pa dyshim se përgjegjësia u bie edhe atyre që kanë edhe kompetenca në mënyrë proporcionale, tani menagjmenti ndërkombëtar Irlandez shkoi dhe kështu kemi pasur kalimi të kompetencave nga ndërkombëtarët tek vendorët, prandaj pa dyshim se përgjegjësit kryesor janë Qeveria, KEK-u dhe shtylla e IV e UNMIK-ut, që të tre këta faktor kyç pa dyshim se kanë qenë tejet të papërgjegjshëm dhe janë fajtor për gjendjen e krijuar. Këto lëvdata që janë në raport nuk i qëndrojnë aspak realitetit. Qeveria e në veçanti Ministria e Energjetikës dhe Minierave fund e krye ka pasur, ka politika të gabuara për zhvillimin e energjetikës në vend. Strategjia e MEM-it ajo afatshkurtër tani

më veç është e dështuar dhe Qeveria është treguar e pa aftë të bëjë diç në zgjidhje të problemeve aktuale dhe nuk ka as ide se si të dalë nga kjo gjendje, kjo Qeveri bën të kundërtën, çdo ditë proklamon planin e saj afatgjatë se si Kosova pas 15 vitesh do të bëhet fuqi rajonale e energjisë. Gabimi më i madh i saj, pra është e preokupuar se si do të furnizoj me rrymë Ballkanin e jo Kosovën, në vend se të përkushtohet se si të dilet nga kjo errësirë që na ka kapluar. Qeveria në vend se të merret me hartimin e politikave efikase dhe hartimin e një strategjie të zbatueshme dhe praktike shkon dhe përzihet duke u përzier në menagjimin e KEK-ut duke u futur në bordin udhëheqës të kësaj korporate hiq më pak se 3 përfaqësues të Qeverisë dhe njëkohësisht për post në këtë bord ministri Çeku bëhet edhe kryeinkasanti i KEK-ut pra e udhëheq grupin veprues për inkasim, prandaj dështimet e KEK-ut janë të vetë Qeverisë, nuk është ashtu siç thotë se shfajësohet se janë disa faktorë tjerë e tjerë, por para së gjithash është vetë Qeveria se është edhe KEK edhe Qeveria, kështu nuk besoj se ka dikund në botë që Qeveria të jetë e involvuar në korporata, kështu siç është e involvuar Qeveria Çeku dhe për kundër kësaj nuk ka kurrfarë rezultati të prekshëm, ama bash kurrfarë rezultati, as në menagjim dhe as në inkasim, prandaj edhe përgjegjësia është tepër e madhe. Ja po shkoj me radhë deri sa t'i hargjoj këta minuta. Dështimi i parë dhe më i madh janë minierat, planifikimi i gabuar për rezervat e qymyrit, krahasuar me gjendjen dhe kapacitetet prodhuese që i kemi nuk mund të punojnë me kapacitet të plotë për shkak të mungesës së qymyrit, pra qymyr sa të duash në Kosovë, por planifikimi është katastrofal, është thënë se do të ketë qymyr mjaft dhe pa pritmas vjen një konstatim i ri, se sasia e rezervave të qymyrit është konstatuar gabim dhe nuk do të ketë deri në vitin 2012 edhe sikur të ketë kapacitete të kuptohemi dhe për atë duhet punuar në kapacitete të reduktuara, për këtë çdo ditë humbin dhjetra mija euro, ndoshta edhe qindra mija, nuk është problemi te një mësues që nuk paguan rrymë, problemi është këtu.

Tenderimi për ndërtimin e kapaciteteve prodhuese që e lavdëroj z. Kosumi, 2100 megavat orë apo termocentrali C siç po i themi veç ka filluar dhe që në fillim ky lloj tenderimi është me plotë mistere që të bën të mendosh se përmes këtij tenderi shumë kush synon të realizoj interesa të caktuara, fillimisht është bërë kërkesë nga MEM-i që të bëhen ndryshime në ligjin për rregullatorin e energjisë dhe ligjin për energjinë në mënyrë që MEM-i dhe Qeveria t'i marrin vetë kompetencat për të bërë tenderimin, të mos i lihet rregullatorit, por t'i marrin vetë në dorë këto punë përmes një komiteti tenderues dhe në kundërshtim me ligjet ekzistuese dhe duke e injoruar punën e këtij Kuvendi me ndryshimin e këtyre ligjeve kryeministri i Kosovës dhe përfaqësuesi special e lidhin një marrëveshje me Bankën Botërore dhe bijnë një vendim për formimin e këtij Komiteti tenderues i cili shkel ligjet në fuqi dhe prejudikon çka është më e keqja ndryshimin e ligjeve të lartpërmendura dhe thjesht na kanë thanë, në dashit bëni ligjin, ndeshi mos e bëni, ndeshi ndërroni, ndeshi mos e ndërroni ne e kemi bërë një vendim që këtë kemi me e qua deri në fund çka të doni bëni, d.m.th është prejudikuar patjetër me ba siç thonë ata kjo natyrisht mund të ndodh vetëm tek ne, çështja shtrohet pse Kuvendi i Kosovës u qit para këtij akti të kryer, pse u bë kjo ngutje tejet e panevojshme vallë për Kosovën, unë nuk e besoj absolutisht, por kështu u ngut edhe afati tejet i shkurtër prej 34 ditësh për shfaqjen e interesit për këtë tender, kur dihet se është fjala për një investim prej më shumë se 2 miliard e gjysmë, kurse për investime shumë më të vogla afatet kanë qenë shumë më të gjata, ta zëmë r telefonin mobile është dhënë në dispozicion afati prej 75 ditësh, a thua se dikush ishte i interesuar që të ulë konkurrenca sepse me këtë ulet

konkurrenca, ska kohë me konkurs, me këtë ngutje apo çka është në pyetje, problemet lidhur me këtë tender vetëm se kanë fillur me një ngutje të pakuptimt dhe vërtetë pse po ngutemi ta bëjmë para statusit këtë tender, kur fuqia jonë negociuese para statusit edhe është aq minore sa që është e papërfillshme faktikisht, kur ne nuk mund të kemi çasje në marrjen e kredive në Bankën Botërore, as në fondin Monetar Ndërkombëtar, është e vërtetë z. ministër që Banka Botërore ju ka dhënë një karrem të them ashtu disa milion për të hyrë në lojë, por jo për ta fituar lojën, pse Banka Botërore nuk ke jep kredinë për ndërtimin e Termocentralit, po ajo nuk e jep se nuk kemi fuqi ne, nuk jemi shtet ende, po të ishim shtet sigurisht që po dhe atëherë të investojmë me një kredi dhe një investitor privat, po ne po domë me falë kështu si po domë dhe tash ne po e marrim si një lavdërim i jashtëzakonshëm por ta shohim se ku po na del.

Menaxhimi i keq dhe mosdhënia llogari për gabimet nga faktori njeri, keqpërdorimet vjedhjet dhe fshehjet e auditit janë vërtetë që e kanë prurë në këtë gjendje sot situatën energjetike. Ju në Qeveri dhe në KEK si problem vendimtar financiar e merr inkasimin, absolutisht nuk qëndron, në aspektin financiar problem themelorë para inkasimit është faturimi më së pari, 50% e rrymës nuk e dini se kah shkon, nga 50% të faturimit që e dini inkason edhe gjysmën dhe do të thotë që nga 100% të prodhimit inkasoni diku rreth 30% dhe thoni që 1 muaj e paskeni inkasuar, viti i ka 11 muaj, nuk e ka vetëm një muaj nëndorin se zakonisht në nëndor inkasohet gjithmonë më shumë dhe ju ate e dini siç e di unë. Këtu ka probleme shumë të mëdha, unë nuk e di sa mund t'i numëroj, por korrupsioni p.sh unë dua t'i marrë vetëm 2 shembuj sa për ilustrim se si bëhet ai korrupsion nga shumë shembuj të panumërt që mund të merren. Blehet 300.000 euro aparati për ta fikur zjarrin në miniera sepse shpesh ndodh dhe aty natyrë është dhe askush nuk ka faj pse ndizet zjarri por si me fik zjarrin dhe kurrë nuk është përdorur ai aparat dhe nuk e ka ndërmend me u përdor ai aparat, ne ishim si komision parlamentar në KEK dhe kurrfarë arsytimi nuk kishin, po nuk po mund ta përdorim, po pse e ke ble pasi nuk mund ta përdorësh me kënd u more vesh t'i që t'i japësh 300.000 euro me i dhanë edhe me lan aparatin aty, po korrupsioni qitu është, është marrë vesh me vikend dhe u krye puna. Është ndërruar një ngjitës që është përdorur tradicionalisht në KEK që është quajtur Tip-Top me njëfarë ngjitësi Nillos me këtë ngjitës 2 orë ma ngadalë bëhet ngjitja e shiritave, pastaj punëtorët janë të pa trajnuar, d.m.th shiritat transportues në miniera që ata donë kohë më së pari me i ngjit, në vend që të shpejtohet këta e kanë ngadalësuar edhe me siguri se ai kur e ka prurë atë ngjitës ka thënë që përfiton në Kosovë me siguri që kurrë se besoj, ka plot tjera korrupsioni është kështu dhe ndryshe nuk bëhet askund dhe as te ne nuk e besoj.

Këtu ka probleme shumë të mëdha 7 vjet janë bërë rrëshqitje të njëpasnjëshme për shkak të faktorit njeri, po i marrë vetëm ato që janë bërë për shkak të faktorit njeri, por është konstatuar nga INKOS-i me studime të veçanta që kjo punë është bërë nga faktori njeri, janë mbytur edhe njerëzit aty.

Po e përfundoj edhe pse Qeveria e ka proklamuar si prioritet energjinë me ato trijet e famshme ka ndodhur e kundërta “eja” ka derivuar në “kë” si do të duash mere por unë po e marrë Kolaps edhe po e marrë katastrofë. Ju zoti ministër keni përmendur se do ta stabilizoni gjendjen energjetike atëherë kur keni ardhur për 6 muaj, u bënë dy vite e ne po flasim për kolaps pa shtegdalje me një mundësi të vetme që pas 6 viteve diku nga viti 2012 me pas rrymë, kjo po i bie që 100 vjetorin e flamurit e festojmë me rrymë, situata

realisht nuk është e pa perspektivë dhe e pa shpresë dhe zgjidhje ka, madje një Qeveri me njerëz që dijnë të udhëheqin do të gjendet zgjidhja

KRYESUESI SABRI HAMITI – Të lutem racionalizojë kohën, unë thash se je profesionist. Ju lutem fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori.

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI - Z. kryesues, të nderuar ministra edhe kolegë deputetë.

Unë do të jem shumë i shkurtër në bisedë, sepse për këtë kemi biseduar jo shumë moti, ndoshta se ka as një vit, por është shumë me rëndësi çështja e energjetikës dhe do të mundohem që ndoshta që do t'i preku dy segmente si sugjerime që do të na shërbejnë edhe Kuvendit edhe Qeverisë për të përmisuar gjendjen në përgjithësi me furnizim me energji elektrike në Kosovë.

Aspekti i parë është aspekti afatshkurtër i përmirësimit të gjendjes në fushën e energjetikës Nëse i kthehemi materialit që e kemi marrë nga ministria dhe vërehen disa të dhëna, shihet se prej vitit 1999 deri në vitin 2006 në emër të energjisë së hargjuar dhe të pafakturuar në vlerë financiare kemi një humbje diku 368 milion kështu thuhet në material, çka dua të them me këtë, mendoj se ky segment duhet përmirësuar absolutisht duhet pa se ku energjia elektrike po mbetet prej prodhimit deri te faturimi, ky është segmenti i parë.

I dyti, çka mund të bëhet në ngritjen e shkallës së inkasimit sepse sipas të dhënave në këtë material shihet se borxhi është 280 milion, kjo u prek edhe prej kolegëve tjerë, ne shpeshherë me ministrin Çeku e bisedojmë bashkarisht edhe në kuadër të grupit të forcës së përbashkët dhe vërehet një angazhim i ministrit në këtë drejtim, por unë mendoj se çështja është te menagjmenti i KEK-ut absolutisht për këto dy segmente menagjmenti duhet përmirësuar rolin e vetë nëse dom një përmirësim po flas afatshkurtër të furnizimit me energji elektrike, ky është aspekti afatshkurtër.

Aspekti afatgjatë natyrisht se është ndërtimi i kapaciteteve të reja. Ministria ka filluar me hapat e parë, unë do të thoj se ka nevojë për ndërtim të kapaciteteve të reja për aq sa duhet të plotësohen nevojat e vendit, hapi i parë, hapi i dytë nëse kemi mundësi për kapacitete të reja për të furnizuar rajonin që unë nuk e mbështes shumë është çështje tjetër dhe e fundit të nderuar kolegë plani ABC është i dështuar, shumë konsumator të cilët janë të rregullt psojnë si rezultat e asaj që brenda këtyre kategorive ka edhe të atillë që se paguajnë dhe janë njëra nga kategoritë, nëse arrijmë të valorizojmë si duhet këtë projekt të planit ABC ne do të motivojmë njerëzit që të paguajnë më shumë edhe ata të cilët që janë të rregullt natyrisht po edhe ata të tjerët që do të shohin mundësinë që afër të tjerëve ka mundësi për të përmirësuar gjendjen në përgjithësi me furnizim me energji elektrike deri sa të krijohen mundësitë për investime të reja flas për fushën e energjetikës, unë mbështes nismën tonë për rekomandime të caktuara që do t'i shërbejnë Qeverisë natyrisht dhe institucioneve të tjera, me qëllim që të kemi një stabilizim të furnizimit me energji elektrike edhe afatshkurtër dhe afatgjatë, si nevojë e asaj për nxitjen e investimeve të jashtme dhe zhvillimit ekonomik të vendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit për fjalët dhe për idetë që i dhe. Fjalën e ka deputeti Naim Maloku.

DEPUTETI NAIM MALOKU – Faleminderit z. kryesues, ministra, të nderuar deputetë. Më lejoni që edhe unë të jap një kontribut në këtë debat. Sipas mendimit tim të hendikepuar për faktin se ne nuk e kemi një strategji alternative që ofron ndonjë grup deputetësh ose grup parlamentar i opozitës se si të dalim nga kjo situatë .Pra, nuk kemi një krahasim se cila strategji është më e mirë a kjo që e ofron Ministria e Energjisë dhe Minierave apo një grup parlamentar apo parti tjetër. Jemi të detyruar të debatohemi mbi strategjinë dhe informatën që e kemi marrë prej Ministrisë dhe ministrit Çeku. Më lejoni që të përgëzoj ministrin për punën e deritanishme për këto dy vite që ka arritë me e ngritë strukturën e Ministrisë me të gjitha departamentet ,me e ofru dhe me i kalu në Kuvend të Kosovës planin, strategjinë e zhvillimit të energjisë deri në vitin 2015 ,pastaj shumë ligje dhe normalisht hapat e guximshëm që i ka marrë Ministria në drejtim të hapjes së mundësisë dhe perspektivës së investimeve të reja në sektorin e energjisë. Ka kaluar rrethi i parë i seleksionimit të firmave që janë të interesuara në Kosovë, hapat e tillë të guximshëm do të sjellin vetëm një të mirë për Kosovën dhe qytetarët se do të shkurtohet afati i kësaj gjendje të paenergji e cila do të vazhdon edhe për një kohë.

Të nderuar të pranishëm, më lejoni që t'i sugjeroj ministrit që involvohet edhe më tepër në menaxhimin e KEK-ut dhe normalisht duhet të ketë një involvim dhe kontroll më të fuqishëm të kapaciteteve njerëzore në të gjitha nivelet, që nga prodhimi i minierave e deri te distribuimi në Koorporatën e KEK-ut. Më lejoni të them se dalja nga kjo situatë pa energji ,të nderuar deputetë, duhet të jemi të qartë dhe qytetarët e Kosovës ta kenë të qartë se energjia duhet të kursehet dhe të paguhet. Qytetarët e Kosovës harxhojnë në vit rreth 300 milion euro vetëm të telefonisë mobile të valës 900 rreth 250 milion euro në cigare dhe rreth 250 deri 300 milion euro në vit në lëndë djegëse për vetura, ndërsa në 6 vitet e fundit i kanë borxh KEK-ut hiq më pak se 285 milion euro. Energjia duhet paguar se me këtë sasi apo shumë të hollave më lejoni të them se ishte ndërtuar hidrocentrali i Zhurit projekti i të cilit është qe 20 vite dhe që kushton rreth 250 milion euro, pra një hidrocentral i ri me kapacitet rreth 300 megavat, pra qytetarët e Kosovës ja kanë borxh KEK-ut. Ministria duhet të përpiqet që të ofron në Kuvend të Kosovës në miratim ligjet të cilat sanksionojnë mospaguesit e energjisë elektrike dhe masat të cilat duhet të merren ndaj tyre. Në këtë aspekt dhe përmirësimin e faturimit dhe pagesave të energjisë elektrike duhet të kyçen edhe ministrinë e tjera, Ministria e Drejtësisë, e Rendit dhe të tjera. Më lejoni të përshëndes hapat që i ka marrë Qeveria e Kosovës për 3 vite unë llogarita 17 milion euro që janë dhënë nga buxheti i konsoliduar i Kosovës për të plotësuar një sasi të shpenzuar të energjisë elektrike për familjet të cilat janë në asistencë. Sipas ministrisë edhe për vitin e ardhshëm janë ndarë 4 milion e gjysmë euro inkurajoj Qeverinë dhe Ministrinë që edhe në të ardhmen të ketë kujdes Qeveria dhe Ministria edhe KEK-u edhe Ministria për punë dhe mirëqenie sociale për kategoritë të cilat janë në asistencë sociale dhe mendoj se edhe Kuvendi i Kosovës duhet të del me një mbështetje të tillë për këto masa, mirëpo 50% e energjisë elektrike të humbet në rrjet që shkon sigurisht në kyqjet ilegale në rrjet që duhet përshpejtuar dhe gjetur masa ligjore kundër keqpërdorimeve të tilla.

Më lejoni që t'i sugjeroj Ministrisë që të bën hapa të përshpejtuar me projektet për ndërrimin e njesorëve me njesorë me parapagesë ose me kartela, këta njesorë janë treguar të suksesshëm në ato vende ku kanë probleme me mospagesë të energjisë elektrike, mendoj se duhet të fillohet me një pilotprojekt sa ma shpejt dhe të shihen rezultatet e këtij projekti, të krahasohen dhe të merren rezultatet e atyre shteteve të cilat kanë pasur

probleme me mospagesën e energjisë elektrike dhe të ofrohet një zgjedhje e tillë, më lirë i kushton Ministrisë që nga buxheti i Kosovës të ndërrohen 400 mijë njehsorë të energjisë elektrike se sa të pritët deri sa nuk do të paguajnë të gjithë energjinë elektrike. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. Maloku, fjalën e ka Teuta Sahatçia.

DEPUTETI TEUTA SAHATÇIA – Faleminderit z. kryesues.

Gjatë debatit të sotëm një pjesë bukur e madhe e diskutimeve është bërë për Termocentralin “C” apo për termocentralin e ri, i cili pritët të tenderohet, të ndërtohet etj. Unë do të koncentrohem në problemet dhe veprimet afatshkurtëra. Çfardo investimesh që do të realizoheshin duhet të jemi të vetëdijshëm se në rastin më të mirë në 6 – 7 vitet e ardhshme ne nuk mund të llogarisim në infuzion të ri vendor, jashtë kapaciteteve ekzistuese të energjisë elektrike, çka do të bëjmë gjatë kësaj kohe në këtë periudhë, për një Qeveri si kjo që e kemi i vetmi shteg është ndonjë mrekulli e ngrohjes së përgjithshme të tokës në të cilën nuk do të kemi dimër dhe mundësisht dita të zgjatet së paku 22 orë. Në vend se të merret me shitjen dhe koncesionimin e thëngjillit me punë që nuk ka as kapacitet dhe parakushte dhe ambient të volitshëm negociues ajo duhet të na pregadis si ta përballojmë këtë periudhë në terr apo në gjysmë terr, nëse edhe më tutje vazhdon me këmbëngulësi dhe kokëfortësi ta shes edhe grandin e fundit të thëngjillit si për inat tonin dhe gjeneratave që do të vijnë atëherë duhet të na përgatisin për kohë më të gjatë ose të zgjidh çështjen kryesore pa të cilën nuk ka kuptim çfarëdo përpjekje për avancim, e kjo është të përmirësohet inkasomi. KEK-u i ka shndërruar ministrinë në ionkasanta, siç e pata thënë edhe në një prej seancave të kaluara në vend se gjegji ta kryej atë punë KEK-u e kryen. Gjithashtu KEK-u është një ndërmarrje e privilegjuar e cila merr prej buxhetit të Kosovës një ndërmarrje jo e suksesshme në vend se të jaapë që ta mbushë buxhetin. Duhet të fillojë ta krijojë një ambient normal për inkasim normal të energjisë së shitur. Dua t’jua përkujtoj se ngritja e inkasimit do të thotë edhe kursim i energjisë. Me ngritjen e inkasimit do të zvogëlohet shpenzimi i energjisë, keqpërdorimi vjedhja e energjisë elektrike nëpërmjet evidentimit dhe faturimit të vogël, bëhet kryesisht në bashkëpunimin e personelit të KEK-ut, kjo pjesë mund të vihet nën kontrollë, këtë e di edhe KEK-u edhe Ministria, por si duket kjo nuk është punë e denjë dhe e nivelit të tyre, janë disa masa të cilat duhet të ndihmonin në inkasimin. Kjo është ndalimi i mbindërtimeve dhe ndërtimeve të egra me apo pa leje të cilat i kanë ngarkuar kapacitetet aktuale dhe e cila gjë gjeneron problem në sistemin energjetik i cili është i dizajnuar për kapacitete të caktuara e jo për kapacitete të rritura.

Investimi urgjent në sistemet e ngrohjes qendrore dhe sistemet alternative të burimit të energjisë. Shitja e thëngjillit nga mihjet tona për nevojat familjare me qmime shumë të volitshme sa të mbulohen shpenzimet e transportit dhe ngarkimit jo vetëm për punëtorët e KEK-ut por për popullatën e sidomos për kategoritë më të varfëra do të shkarkonte sistemin energjetik dhe do të ndihmonte inkasimin. Çështja tjetër kryesore është sigurimi i thëngjillit. Të nderuar deputet edhe po t’i kishim kapacitetet për prodhimin e energjisë dyfish nga sa i kemi tani kot nuk ka thëngjill. Sigurimi i mjeteve për ngritjen e kapaciteteve për prodhim të thëngjillit është çështje mbi çështjet, të gjitha ballansimet apo riballansimet buxhetore e jashtëbuxhetore dhe energjitë tona duhet të orientohen kah ngritja e prodhimti të thëngjillit, në vend të shpenzimeve të pakuptimta për të gjithë, pos

për atë që i bëjnë që po bëhen në muajin dhjetor nga ana e qeveritarëve dhe sistemeve publike vetëm sa për t'i shpenzuar mjetet e paracaktuara. Ato duhet t'i drejtojnë në drejtimin e mihjeve. Këtu është edhe një pyetje a thua se kriza e skajshme në prodhimin e thëngjillit është objektiv dhe e paevitueshëm apo me qëllim po ashpërsohet gjendja për t'i shtyrë dhe mbështet projektet dhe interesat e qeveritarëve apo të qarqeve të lidhura me të, si do që të jetë nëse investimet në mihje aktuale njëmend nuk kanë kuptim mbetet të sigurohen mjete të nevojshme për hapjen e mihjes së re në Sibovc për nevoja të blloqeve aktuale me zgjerim të saj të mëvonshëm në një bllok deri 500 megavat. Çështja e tretë është kursimi. Me një të afërt të energjisë elektrike të zyrtë nuk do të ketë shtegdalje pa një kursim serioz në të gjitha lëmitë, në shpenzimet e benzinës të automjeteve, çdo zyrtar i lartë ka në dispozicion automobilin dhe benzinën standard që do t'u kishin për lakmi edhe zyrtarët e shteteve të forta me dritë që kanë 24 orë. Shpenzimet e telefonisë të reduktohen në normale, nuk duhet të tolerohen më trajnimet e truprojave etj .siç kemi pasur raste të dëgjojmë apo shpenzimet e pakuptimta për tesha e për syza etj. Duhet të reduktohet ndriçimi rrugor i lokaleve qeveritare dhe i atyre publike, të zbritet temperatura e ngrohjes për objekte qeveritare e të atyre publike, sa do që duken të vogla të gjitha kursimet duhet të drejtohen kah mihjet.

Çështja e katërt, stabilizimi i KEK-ut, zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimeve në KEK, ndalja e eksperimenteve në strukturimin e KEK-ut, identifikimi dhe mbështetja e personelit që kanë kapacitete profesionale dhe morale dhe KEK-u si ndërmarrje e pasuksesshme dhe e cila shpenzon mjete të shumta nga buxheti do të duhet të tregojë së paku një modesti dhe një bashkëndjnjë me qytetarët e jo me arogancë nga qytetarët të cilët e mbushin buxhetin dhe ndërmarrjet në vështirësi në të ardhmen. Pra . do të duhej që në ato kursime të ketë një modesti dhe shpenzimet për rroga së paku të jenë në një nivel të cilën e meriton një ndërmarrje që nuk ka sukses.

Çështja e pestë dhe më kryesorja se kjo Qeveri që nuk ka kontribuar në përmirësimin e gjendjes në asnjë lëmi të energjetikës, pos në ngritjen e konfuzionit sa herë që ka ndërhyrë dhe është përzier, nuk mund t'i zgjidh këto probleme, Ministria e cila nuk e ka asnjë referencë pozitive për 2 vjet të kaluara nuk ka të drejtë as kredi për blerje të mëtejshme të kohës, kjo vlen sidomos kur të kujtohen fushatat parazgjedhore në të cilën 24 orë, 7 ditë në javë janë premtuar energjia atëherë shihet thjeshtë një mungesë e vizionit dhe nuk mund të kërkohet prej opozitës që të jetë alternativa dhe të jetë programe të ndryshme sepse ju e keni marrë mandatin dhe është detyra e juaj, kur të vijmë ne atëherë ju jepna alternativa.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Parafolësja po ma jep shansin që të lidhem me situatën tonë. Opozita që e konsideron kaq të rëndësishëm këtë problem që ka kërkuar për ta biseduar unë ju tregoj se mua më duhet ta ndërprej bisedën që tash për deri sa të mos bëhen 40 deputet në sallë sepse rregulli thotë që një e treta duhet të jenë edhe kur të diskutohet dhe kur nuk bisedohet, ju tërheq vërejtjen që solidariteti i LDK-së e ka fundin, nuk është i pafund dhe ne jemi këtu, mirëpo nuk jemi të interesuar në këtë formë që t'i vazhdojmë bisedimet. 35 deputetë janë, unë i thërras deputetët që të kthehen në sallë, përndryshe e ndërprej diskutimin në bazë të rregullës së Parlamentit, pres 2-3 minuta. Vëreja shkon normalisht në opozitën që e ka kërkuar bisedimin, por kjo nuk do të thotë që i liron edhe të tjerët dhe mos të luajmë lojra fjalësh të mëdha, përgjegjësia shihet këtu. Kjo vlen për çdonjërin veç e veç, unë pres 4-5 minuta që deputetët të hyjnë dhe ta

bëjnë kuorumin për bisedë dhe ju lus që të zbresim nga retorika në probleme, përndryshe edhe ashtu ju e dini se edhe pak dhe nuk transmetohet në televizion kjo. Fjalën e ka deputeti Zef Morina.

DEPUTETI ZEF MORINA – Faleminderit z. kryesues, të nderuar ministra, kolegë deputetë.

Vërtet situata energjetike në Kosovë është mjaft e rëndë, por shihet se nga viti në vit ka përmirësime minimale. Po bëhen 7 vite që nga kriza e energjisë elektrike edhe pse sipas të dhënave që i kemi pasur deri më tani pothuajse janë bërë rreth 1 miliard investime në riparimin e termocentraleve, në riparimin e blloqeve kryesisht mjete nga donacionet. Mendoj se kriza energjetike nuk është vetëm krizë për çështje ekonomike, por do të ndikojë dukshëm edhe në implikimet politike, kur dihet se në cilën fazë dhe në çfarë shtate Kosova është politikisht sot. Ne dëshirojmë dhe shpresojmë që shumë shpejt të bëhemi shtet i pavarur, mirëpo, në qoftë se do të jetë kriza energjetike në këtë trend çfarë është sot, do të jetë pak problematike. Dëshiroj të fokusohem kryesisht në takimin që e kishte komisioni parlamentar funksional me përfaqësuesit e KEK-ut, me përfaqësues të Agjencionit Rregullator të Energjetikës me Ministrinë. Ishin të ftuar Agjensioni Kosovari i Mirëbesimit dhe përfaqësues të UNMIK-ut ,gjegjësisht të Shtyllës IV ,të cilët jo që nuk erdhën, por në një mënyrë na injoruan fare. Ishte vërtet një debat ose një njoftim mjaft i mirë nga ana e përfaqësuesve të KEK-ut dhe të Ministrisë, por ishte vërtetë një çështje mjaft e pakuptueshme, por nga vetë ata thuhet që mbi 50% të energjisë elektrike humbet. Unë për vete isha vërtet i habitur se si është e mundur të gjitha këto investime janë bërë dhe pas 7 viteve të thuhet që janë 50% humbje duke llogaritur në transmetues, në largpërçues dhe në keqpërdorues. Natyrisht, është shumë normale që teknikisht mund të lejohet ndosha nja 5% humbje në transmetues dhe largpërçues, por të lejohen mbi 30% humbje vërtet kjo as teknikisht e as moralisht është e papranueshme. Dua të them që pikërisht përfaqësuesit të cilët ishin përgjegjës për këtë nuk muarën pjesë sepse ata e kanë menaxhuar KEK-un deri sot. Strategjia e Ministrisë është shumë inkurajuese .mirëpo duhet të shiqojmë për një zgjidhje shumë të shpejtë afatshkurtër. Është shumë e pëlqyeshme që ne të jemi eksportues të rrymës elektrike, por së paku të mos jemi importues në këto vite që i kemi, sepse në një afat të gjatë natyrisht ndoshta për shkak të kapaciteteve që i kemi dhe pasurisë natyrore që i kemi të thëngjillit,, mund të jemi edhe eksportues,.Nëse e bëjmë një llogari shumë të thjeshtë nga buxheti i vitit 2007 parashihet që për energjetikën ndahen rreth 48 milion euro, pra kryesisht në import dhe po e bëjmë një analizë ku 50% do të kemi humbje do të thotë që ne japim 48 milion, ndërsa energji kemi vetëm 24 milion, kjo kishte me qen e njejtë sikur me një pronar të një lokali e blen mallin për shitje 50% e humb rrugës dhe 50% ja paguajnë ata të cilët e blejnë d.m.th 25% ai pronar nuk vlen për ta udhëhequr atë lokal, gjithashtu menagjerët e KEK-ut, menagjerët të cilët deri më sot e kanë menagjuar vërtetë janë të papërgjegjshëm dhe puna e tyre e ka prurë gjendjen energjetike deri në këtë situatë. Kërkoj nga Ministria që në çdo formë edhe Parlamenti t'i ndihmoj kompetencat të kalojnë në menagjim të tyre në mënyrë që të dihet se kush është përgjegjës, ne e kemi shtyllën IV e kemi AKM-në e kemi KEK-*un e kemi Ministrinë dhe në një mënyrë askush nuk e merr përgjegjësinë, nuk është e pranueshme që në planin ABC të mos kihet parasysh situata nëpër shkolla dhe spitale, nxënësit tonë nuk janë në gjendje me e mbajtë orën e mësimit sepse ndalet rryma elektrike, kjo nuk ndodh në botë, në qoftë se plani ABC është paraparë për

konsumatorët që nuk e paguajnë së paku për shkollat dhe spitalet është dashur të ketë një lloj diferencimi, kështu që mua më vjen shumë keq që në këtë seancë nuk janë, ndoshta nuk janë të ftuar por kaqenë dashur të vijnë edhe përfaqësuesit e AKM-së dhe të shtyllës së IV të UNMIK-ut sepse jo vetëm Ministria, por edhe ne si Parlament mund të debatojmë, mund të japim edhe opsione të mundëshme për zgjidhjen e këtij problemi, por asesi deri sa ta të mos na tregojnë drejtë, qartë kah janë shpenzuar mjetet dhe pse sot jemi pa energji, po them edhe njëherë se gjendja është më e mirë, ndoshta se vitet e tjera, por nuk është gjendja e mirë ,sepse atë ditë na është raportuar se gjendja mund të jetë edhe më e vështirë vitin që vjen. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI - Faleminderit z. Morina, fjalën e ka deputeti Xhelal Canziba.

DEPUTETI XHELAL CANZIBA – Faleminderit z. kryesues, të nderuar ministra dhe ju kolegë deputetë.

Nuk ka zhvillim ekonomik pa energji elektrike. Misioni i AKM-së ka qenë të ndihmojë në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, kurse njëri nga qëllimet kryesore të kësaj agjencie ka qenë të zbatojë mirë menagjimin efikas dhe me kosto efektive të ndërmarrjeve publike. Për plotësimin sa më me sukses të nevojave të qytetarëve. Bazuar në realitetin në të cilin ndodhemi AKM-ja nuk arriti misionin e vet, sepse në Kosovë nuk mund të flasim për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, kurse qytetarët po përjetojnë varfërinë nga numri i madh i të papunësuarëve. Çdo ditë përballet me mungesë të rrymës, ngrohjes, pra me shërbime publike që janë nën çdo nivel. Qytetarët në përgjithësi nuk janë të kënaqur me shërbimet publike, paguajnë fatura paushalle dhe nuk marrin shërbime të duhura. Pra, kampioni i pakënaqësisë padyshim është energjia elektrike. KEK-u nga paaftësia që të jetë e vetëqëndrueshme financiarisht deri më tani është varur nga donacionet e jashtme ,por edhe nga buxheti i Kosovës.

Buxheti i Kosovës deri më tani ka ndarë për subvencionimin e KEK-ut përfshirë edhe importin e energjisë elektrike rreth 400 milion euro, mjete këto që kishim mundur të orientohen kah shërbimet e tjera esenciale si: arsimit, shëndetësia etj.

AKM-ja ka marrë nga mjetet e taksapaguesve, pra nga Buxheti i Kosovës në vitin 2004 diku rreth 134 milion. Në vitin 2005, diku rreth 90 milion, në vitin 2006 janë nga rreth 68 milion, kurse në vitin 2007 janë planifikuar për këtë agjenci rreth 76 milion, Shtrohet pyetja: a janë shfrytëzuar me efektivitet mjetet e taksapaguesv?. Bazuar në gjendjen në terren dhe me problemet me të cilat përballen qytetarët, përgjigja është jo. Nga ana tjetër, prioritet i Qeverisë është energjetika, kurse suksesi i kësaj qeverie është prodhimi i krizës energjetike.

Premtimet e Qeverisë ishin që në Kosovë do të ketë dritë, kurse qytetarët po përjetojnë terrin dhe zhurmën e gjeneratorëve, kurse kohëve të fundit po përjetojnë edhe një hipokrizi të institucioneve , ngase disa ministri janë bërë vegël e KEK-ut. Kanë xjerrë udhëzime administrative me të cilat i kushtëzojnë shërbyesit civilë që të sjellin dëshmi për pagesat e rrymës nëse duan paga. Këto ministri, kjo ndodhë me hapat e ndërmarrë, për shembull Ministria e Tregtisë dhe Industrisë kushtëzon kryerjen e shërbimeve me faturat e KEK-ut në vend që të stimulojë biznesin dhe të krijojë ambient të përshtatshëm për zhvillimin e tyre. Është shqetësuese mosfurnizimi me rrymë i bizneseve. MEMI do të kishte qenë mirë që krahas shndërrimit të saj inkasant të rrymës të analizojë se sa i

kushton një biznesi pak më të madh çdo çkyçje e rrymës. Pra , çfarë humbjesh u ka shkaktuar bizneseve të vogla dhe të mesme plani A, B, C i KEK-ut?

Qeveria e ka nënshkruar **QEFTËN**, por si do të bëjë bizneset të jenë konkruuese në treg kur nuk ka energji elektrike? Ju faleminderit!

KRYESUESI I SEANCËS SABRI HAMITI - Ju faleminderit z. Canziba, fjalën e ka Fatmire Mulhaxha – Kollçaku

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU – Ju faleminderit z. kryesues

Megjithatë duhet të bëjë një konstatim që tash një kohë të gjatë të vetmit përfitues të kësaj situate janë individët e caktuar, si dhe firmat që mirren me shitblerjen e gjeneratorëve dhe inventarëve, ndërsa të tjerat e kanë një emërues të përbashkët, një krizë e cila ka, duhet t'i kenë marrë përmasat e një katastrofe. Duke pasur parasysh dëmet në ekonomi, që i bëhen mjedisit dhe repërokusioet direkte në shëndetin e njeriut. Me të vërtetë ka qenë një kushtëzim në këtë temë sot që të mos hyjmë më gjerë se atë që e ka paraparë sot ministri, por duhet theksuar qartë, që çdo raport që ka të bëjë me energjetikë është I pashkëputshëm, do të thotë nuk mund të ndahet asesi nga ajo që kjo krizë energjetike sjell direkt . dëmet në shëndetësi publike.

Po flitet për termocentralin e ri si një gjigant, tenderi i cili mund të them të drejtën është preokupim jo vetëm i këtij kuvendi dhe institucioneve, por preokupim i madh i gjithë qytetarëve të Kosovës. Për kë kjo mund t'ju them është temë e ditës? Ditëve të fundit dhe këtë duhet ta di shumë mirë Qeveria se ka një përgjegjësi të madhe edhe historike, në vendimet që i merr kur vendos ta shesë pasurinë e Kosovës dhe gjithë tregtarët e mirë e dinë cili është pazari një ditë para dhe një ditë pas pavarësisë. Kjo është temë që po përfolet këto ditë shumë.Në qytetin e Pejës, çka po ndërmer kjo Ministri për me e përmirësuar inkasimin. Është një shembull eklatant si, në vend që ata obliguesit e mëdhej që e kanë në listë që nuk po paguajnë shkon e shkëput rrymën në shkollë fillore siç është “Lidjja e Prizrenit” në Pejë, një shkollë që mban mësim në tri ndërrime dhe e bën temë të rendit të ditës te fëmijët e ciklit të ulët, sepse mësojnë edhe klasa e katërt fillore në ndërrimin prej orës 3:00 pas dite. Tash po kthena në dëmet që sjellin në shëndetin e njeriut. Ne po dom me kërkuar nga investitori i jashtëm që ka me eksploatuar pasurinë kosovare që të mendojë për shëndetin e qytetarëve dhe do t'i qesim kushte të cilat janë, por çka po bëjmë ne? Ne së pari duhet të mendojmë për qytetarët tanë, për shëndetin e tyre dhe mandej ta obligojmë dike që vjen nesër këtu, që shpresojmë nuk vjen ashtu siç është paraparë tash.

Mund të them me bindje të plotë se ekziston një pajtueshmëri në mes ekspertëve mjedisorë se ndotja e ajrit nga ndikimi i punës në sistemet termoenergjetike shkakton probleme shëndetësore të mëdha. Emetuesit e dëmshëm nga këto objekte me përdorimin e karburanteve fosil si dyoksid i sulfurit, oksidet e azotit e monoksidi i karbonit, thërmijat e ngurta, dyoksidi i karbonit e tjera, mund ta marr një shembull tjetër: si ndotja e ajrit nga pluhuri i prodhuar nga termocentralet e do të thotë që prodhojnë energji Kosova A dhe B dhe grumbujve të hirit paraqesin një problem kritik mjedisor dhe shëndetësor për këtë rajon, emetimet totale të pluhurit vlerësohen nën 167 mijë tonë në vit me 20.000 tonë nga trajtimet e transportit të hirit dhe 50.000 tonë në vit nga hedhja e hirit posaçërisht nga termocentrali Kosova A. Në një ditë të caktuar sasia mesatare e pluhurit që vendoset për metër katror afër minierave dhe termocentraleve

shtrihen mes 1000 deri 2000 miligram për metër katror duke kaluar shumë kufirin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, që është 300 miligram për metër katror përditë, ngjashëm bazuar në masat e kualitetit të ajrit, të materies partikulare më të vogël se 10 mikrometra, vlerat e kualitetit që ajrit që i atribuojnë depove të hirit në rajonin e Obiliqit, në distancë prej 5 km nga burimi janë mesatarisht mbi 50 gram për metër kub dhe në periudha të thata mbi 100 gram për metër kub, duke tejkaluar limitet e Bashkësisë Evropiane.

Shtrohet pyetja: A është angazhuar deri tani Qeveria që të financojë ndonjë projekt të karakterit shëndetësor të bazuar në ndikimin e sistemeve termoenergjetike në shëndet publik qoftë nga ajri, uji apo toka?. Vetëndezja e thëngjillit është problem akut mbase nga aty kemi emetime edhe më të rrezikshme si shembull: gazi i sienës, si CO2, etani, metani e tjera të ashtuquajtura gazrat e qelqit. Në një zonë të kuqe, pra të tejndotur ndërtojmë kapacitete të reja, së shpejti po na presin sanksionet e ndotësi paguan e ne po menaxhojmë ndërtimin e kapaciteteve të reja pa e përmirësuar gjendjen në kapacitetet aktuale pa planifikuar mjete reale buxhetore. A po mendon kjo Qeveri për popullin e vet nga e cila është sajuar apo nga tenderi i madh, ka humbur rrugën në oborrin e vet. I kisha theksuar edhe disa aspekte për të cilat kjo Qeveri duhet të angazhohet, duhet të merren masat për ndalimin e ndotjes nepërmasa të mëdha në kapacitetet e tanishme prodhuese si parakusht për zhvillimin e mëtutjeshëm do të thotë kapaciteteve të reja. Gjithashtu, duhet të merren dhe masa për eliminimin e ndotjes edhe nga sektorët si: trafiku, ndërtimtaria. Këtu pa marrë parasysh që nuk është temë, veç një shembull eklatant po e përmendi ndërtimi i parkingut gjigant në oborrin, ndoshta nuk është oborri, por para oborrit e Qendrës Klinike Universitare, Komuna e Prishtinës merr vendim e për këtë ka edhe ministri i Pushtetit Lokal ka përgjegjësi. Mendoni qysh kanë me pasur pacientët në Qendrën Klinike Universitare, ky vendim që o marrë edhe dijeni çfarë pasoja po merrni, çfarë vendime për të sëmurit që janë në Qendrën Klinike Universitare që nuk rrinë aty në baza ditore.

Ndërhyrje e Kryesuesit të Seancës – ta tërheq vërejtjen zonjë që po del nga teme në temë, energjetika – e ke atmen, situata energjetike

VAZHDIM FATMIRE MULHAXHA – E kam temën, më falni pra e kam, e kam atmen, u ndërlidhe me problemin, më falni pra, vetëm është shumë me rëndësi me u theksua se është gjithashtu ndotje e mjedisit. Si rrjedhim kjo kërkon një rehabilitim urgjentë infrastrukturës ekzistuese në pajtim me tregun e rritje të energjisë përderisa të krijohet dhe forcohet një qasje brendshme për t’u marr me çështjet mjedisore nga aktivitetet e prodhimit të energjisë dhe të inkurajoj standardet më të larta të qëndrueshmërisë mjedisore.

Do të thotë si përmbyllje kërkojmë nga Qeveria edhe pse e dimë se nuk mund të eliminohet plotësisht ndotja e mjedisit, por që d.m.th. që të minimizohet në minimumin e mundshëm që t’ju sigurojmë njerëzve, fëmijëve që jetojnë edhe në afërsi po edhe më larg, se nuk është vetëm ata që banojnë bash në afërsinë më të madhe të termocentrali që po planifikohet të ndërtohen një të ardhme. Ju lutem kur u përmend edhe zhurma pat buzëqeshje nga deputetët, por shëndeti publik edhe si punëtore e shëndetësisë publike do të thotë preventivës kam obligim para atë gjithë atyre punëtorëve të shëndetësisë publike t’ua tërheq vërejtjen që energjetika edhe gjithë ndërtimi i kapaciteteve të reja

në rend të parë duhet ta ketë parasysh mbrojtjen e shëndetit të njeriut, përkundër përfitimeve që po priten t'i kemi në të ardhmen nga gjigandet që po presim t'i furnizojnë edhe krejt Evropën me rrymë

KRYESUESI I SEANCËS SABRI HAMITI - Nuk dua të komentoj sepse edhe jam tue e udhëhequr por këtu ka mundësi edhe komenti. Ju lutemi shumë mos dilni prej teme, se masandej kur po ju them po ju vjen keq. Tema është situata energjetike, nuk është astronomia as medicina se ti po reagon, por edhe Alushi e ka të drejtë pedagogjike me na thënë runu prej pluhuri jo veç ti.
Fjalën e ka Hatixhe Hoxha

DEPUTETJA HATIXHE HOXHA – Z kryesues, të nderuar deputetë. Për mua është paradoksale fakti se derisa thuhet se Kosova ka rezerva të energjisë , në anën tjetër ne po përjetojmë një kaos energjetik. Më lejoni që edhe unë të paraqes shqetësimin tim për këtë gjendje. Mendoj se plani A, B,C, i cili u përmend edhe nga disa kolegë të mi, para meje pra, që po zbatohen ndaj qytetarëve për mua dhe qytetarët është i dështuar. Mendoj se çkyçjet kolektive të cilat po zbatohen nga ana e KEK-ut janë diskriminuese, sepse kështu shkelen të drejtat e qytetarëve dhe, sepse me këto sanksione apo masa selektive po ndëshkohen qytetarët që janë pagues të rregullt të energjisë së shpenzuar. Me anë të planit A,B,C, i cili edhe ashtu siç është planifikuar nuk po zbatohet, qytetarët që janë në kategorinë B dhe C ndodhë që gjatë gjithë ditës të kenë energji gjashtë me një në dobi të territ ose ndodhë të kalohet nga një kategori, për shembull nga B në C pa u informuar fare qytetarët.

Z. Ministër a e keni pasur parasysh Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve, sepse me këto shkyqje ku shkilen të drejtat e qytetarëve ta atyre që kanë kryer obligimet ndaj KEK-ut, ndërsa KEK-u nuk përmbushë obligimet ndaj tyre.

Ministria dhe përfaqësuesit e KEK-ut duhet të jenë të kujdesshëm se me keqmenaxhimin e tyre po shtojnë pakënaqësinë e qytetarëve, të cilët po reagojnë në format e ndryshme si përmes protestave siç ndodhi me qytetarët e fshatit Roganë të Dardanës ose edhe për shembull ata të lagjes Kulla të Gjilanit të cilit iu drejtuan KEK-ut me një petition të nënshkruar nga së paku 100 qytetarë apo edhe banorët e fshatit Mireshe të Gjilanit të cilët paralajmërojnë KEK-un që t'i furnizojë me rrymë në bazë të asaj se sa e kanë paguar rrymën, sepse për ndryshe do të ketë bllokime të rrugëve. Mendoj se vërtet është koha e fundit që sa më parë të hiqet dorë nga plani A,B,C. Ky plan i dështuar dhe të gjithë qytetarët të furnizohen me rrymë për aq sa edhe i kryejnë obligimet me ligj.

Dëshiroj të nënvizoj faktin se nëpërmjet ndërprerjes së rrymës po dëmtojnë rëndë dhe po shkatërrojnë bizneset dhe ekonominë familjare dhe ato në dimensione të ndryshme.

Ju z. ministër , përmendët kategoritë që janë në asistencë sociale. Edhe unë dëshiroj t'ju informoj se në një takim në fshatin Koronicë të Gjakovës, me gratë mbajtëse të familjes, ato na thanë se rrymë kanë gjatë ditës vetëm një orë dhe se përballen me çështjet e pagesës së rrymës dhe kishin kritika ndaj Ministrisë që e drejtoni ju z. Çeku.

Dëshiroj të theksoj se përkundër faktit se Kosova po përjeton krizë energjetike askush nuk jep përgjegjësi për keqmenaxhim përkundrazi menaxherët e KEK-ut vazhdojnë të marrin paga marramendëse. Fjalën time po e përmbyll me një shprehje të qytetarëve se shpresat e qytetarëve ndaj Qeverisë, Ministrisë se Energjetikës dhe të KEK-ut po fiken, ashtu siç po fiken në vazhdimësi edhe dritat tek ne. Ju faleminderit!

DEPUTETI ALI SADRIU – Ju faleminderit zotëri kryesues, nderime për ministrat, kolegë deputetë.

Tema që ne sot po debatojnë është një temë që involvohet në tërë procesin e jetës do të thosha, jo vetëm të procesit zhvillimor. Nga shumë diskutues, por edhe nga shumë analiza dalim te një e dhënë shumë e pakëndshme ku 50% e rrymës së prodhuar nuk i adresohet tregut. Është një çështje që do një trajtim të veçantë, një studim të thellë ku dhe si? Nuk mund të ketë kurnjëherë asnjë kompani çfarë do të jetë ku prodhimi në start i humbet 50%. Humbjet tjera, poashtu të natyrës të njëjtë apo të ngjashme i ka në mosinkasimin e mallit të ofruar.

Unë e di se KEK-u në raport me distribuimin ka pasur investime bukur të mëdha, ka edhe rezultate, ato vërehen dhe shihen, por nuk na le cifra 50% që të kemi kënaqësinë në këtë drejtim, prandaj kjo e donë një hulumtim, po them edhe një here në mënyrë të veçantë. U cek te pala tjetër të joinksaimi i bollshëm në solidaritet dhe forma tjera. Nëse e përcjellim në mënyrë kronologjike solidaritetin në raport me rrymën tek nevojtarët ka ekzistuar bile në emër të tij janë udhëhequr shumë politika, politika sociale, politika etnike e tjera e tjera që ne të gjithë i dimë ata që jetojmë në Kosovë. Mendoj se këtu ka pasur keqpërdorime të vrazhda në të kaluarën, ka edhe tani. Hapi që ka ndërmarrë Ministria, që rastet sociale t'i furnizojë apo t'i stimulojë për një sasi të energjisë të punësuarit ka qenë një hap shumë i drejtë, sepse nga ajo vijë e konsumit ka pasur shpenzime enorme qoftë në përdorimin jo të drejtë të energjisë, qoftë në solidaritetin e tyre ndaj të afërmëve të vet. Këto janë të dhëna që nga tereni kanë reflektuar. Një çështje tjetër që unë dua ta ngrit këtu Kosova dihet se ka energji termon kryesisht, dhe në të ardhmen është një burim mos të them i vetmi në Ballkan por edhe përmasa më të mëdha në Ballkan i këtij lloji të energjisë. Për ndryshim që i tërë rajoni kryesisht energjinë e ka në hidro. Në këtë relacion, por Kosova gjatë 24 orëve, nga informatat që unë i kam besoj se janë të drejta, Kosova disa here eksporton dhe importon të njëjtën kohë energji sepse kapacitetet prodhuese nuk mund t'i përshtaten nivelit të konsumit i cili varron gjatë procesit të vet, në këtë drejtim, e di se ka pasur disa angazhime, por nuk kam qenë i kënaqur as unë në kohën e mandatit të Qeverisë Rexhepi, nuk e di se çka ka ndodhur më vonë. Fatmirsisht rajoni në të cilin gjendet Kosova thash, kryesisht bazohet në energjinë hidro, ndërsa ne në termo dhe nëse kemi infrastrukturë, Edhe mua më pengon kjo, por nuk e di **kërpica**, nuk e di sa është e ndërtuar infrastruktura në relacion të këmbimit të energjisë, qoftë të marrjes apo edhe të dhënies. E di se po ashtu në këtë drejtim Kosova ka humbur shumë ,sepse thuaja se në tërësi importin e ka bërë me çmime shumë të shtrenjta, kurse eksportin ka shkuar në vija me çmime të ulëta, e di po ashtu se Shqipëria është njëri prej konsumuesve më të mëdhenj sepse e ka tërë energjinë në hidro, po ashtu e di se Shqipëria apo në relacion me Shqipërinë ne komunikojmë përmes Malit Zi që është një absurd edhe për shtetin shqiptar edhe për ne këtu. Në këtë drejtim, mendoj se Qeveria duhet të jetë këmbëngulës që ai 400 voltëshi në Prizren sa më parë të aftësohet dhe të kemi komunikim të drejtpërdrejtë. Kjo është edhe për proceset që i kemi tani, në veçanti për proceset që duhet të vijnë. U cek edhe ndë tjera: ndotja e ambientit nuk ka energji etj etj, Unë mendoj se ato vlerësime nuk qëndrojnë, në ndotjen e ambientit duhet të angazhohemi që të gjithë dhe duhet të

përdoren normat adekuate standarde , të cilat duhet të sigurojnë një ambient tjetër. Jam i vetëdijshëm se nga ajo që e ofrojmë në bazë të katalogut në realitet gjithherë duhet llogaritur edhe një përqindje tjetër, por megjithatë, kapacitetet ne që i kemi i kanë kaluar të gjitha normat dhe mendoj se kapacitetet e reja nuk guxojnë as për së afërmi të jenë të pajisura në nivelin çfarë janë këto. Element tjetër, u tha se nuk ka thëngjill, unë them se thëngjill ka, dhe nuk ka arsyeshmëri para opinionit dhe para vetvetes, në një mall që ta ka fal Zoti në këtë rast të mos e shfrytëzosh. Jam për atë që të mendosh për gjeneratat e ardhshme, por mos të harrojmë se Kosova kapacitete prodhuese të natyrave teknike tjera është në nivel të ulët dhe ajo diçka duhet të eksporton, diçka duhet ajo, një prej tyre e ki pra edhe minierat dhe tjera, por është shumë normale se në rastin e kontraktimit të qoftë konfeksionit, qoftë formave tjera, duhet jetë një studim paraprak.

Dua ta shtoj edhe një element tjetër.

Ligniti në Kosovë, jo vetëm për ka h sasia që i kalon shifrat të cilat ne i kemi mësuar në të kaluarën, në bazë të rezultateve të reja, ato janë shumë më të mëdha, por kualiteti i tij është shumë më i mirë se minierat e ngjashme që i kemi në Gjermani apo në Poloni. Unë po ua jap vetëm tri elemente: nëse në Gjermani në minierat që janë sipërfaqësore, mos të lëshona në minierat ku përdoren përmes tuneleve ku ka ujë, ku ka gazra, ku ka fatkeqësi të ndryshme, por ndalem tek minierat sipërfaqësore. Nëse në Gjermani duhen tre ton dhe të hiqen për një ton thëngjill në Kosovë është e kundërta, nëse atje shkalla e lagështisë arrin deri në 72% në Kosovë është 30 deri 35%, nëse atje gazrat toksik gjatë procesit i ki 1.7 në Kosovë është 0.8. Këto janë elemente që shtojnë interesimin e investitorëve dhe Kosova duhet ato adute t'i përgatitë dhe t'i lansojë dhe t'i ketë parasysh gjatë kontraktimit apo gjatë bisedimeve për investimet e ardhshme.

KRYESUESI I SEANCËS SABRI HAMITI Z. Sadriu ju faleminderit! Fjalën e ka Sala Berisha Shala

DEPUTETJA SALA BERISHA- SHALA – Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar kolegë deputetë, anëtarët e Qeverisë.

Se a po diskutojmë ta bindim njëri- tjetrin me opinionet tona apo po merremi me problemet si të dilet nga ky kolaps, sigurisht që kjo pyetje, kjo dilemë është para qytetarëve të cilët na përcjellin këtu.

Të nderuar kolegë deputetë të pozitës dhe të opozitës që të gjithë jemi qytetarë të Kosovës që përballemi për çdo ditë me kolapsin energjetik, andaj nuk ndihmohet situata në këtë mënyrë duke i bë himne Qeverisë apo edhe anasjelltas. Se fundja këtu jemi për të debatuar më shumë si të dilet nga kjo situatë e t'iu lehtësohet jetesa e qytetarëve tanë.

Problem serioz dhe i rëndësishëm që po përcillet vit pas viti është përballja e qytetarëve të Kosovës me mungesën e rrymës dhe sidomos me pasojat e saj. Mungesa e energjisë elektrike nuk është vetëm përballje me terrin, është një problem që reflekton në të gjitha poret e jetës. Mendoj, që kjo është njëra nga arsyeja e thirrjes së këtij debati. Qytetarit të Kosovës nuk i interesojnë projektet tuaja afatgjata z. Ministër që i proklamoni me aq kompozitet se në vitin 2030 apo 40 do të kemi rrymë me bollëk edhe për eksport. Kjo është një cinizëm i llojit të vet. Qytetari i Kosovës pret të mirremi edhe të mirreni me hallet e përditshme tij me pasojat shëndetësore nga papërgjegjësitë tuaja si Qeveri.

Unë e kam një pyetje se a ndalemi së paku për një çast të merremi me pasojat që u ka shkaktuar mungesa e rrymës bizneseve të Kosovës, ekonomive familjare madje drejtpërsëdrejti pasojave shëndetësore të qytetarëve siç është rasti, më lejoni ta marr, t'ua përkujtoj një rast të djegies së fëmijëve në Fortesë të Drenasit vitin e kaluar duke u munduar duke e ndezur një bombolë gazi për të bërë ndriçim në mungesë rryme dhe ata fëmijë sot përballen me probleme serioze shëndetësore, nuk kanë mundësi as të shërohen jashtë.

Sot në rend dite pra e kemi debatin rreth situatës energjetike në Kosovë. Nuk e di se sa do t'i ndihmoj ky debat stabilizimit të gjendjes së furnizimit me energji elektrike, e ceka qëllimisht furnizimit me qëllim se si hallkë e fundit kjo është e këtij zinxhiri të problemit energjetik.

Të nderuar deputetë!

Çasja ndaj këtij problemi e përqendruar vetëm në këtë segment nuk do t'i kontribuojë identifikimit të problemit e aq më tepër nuk do t'i ndihmojë në gjetjen e alternativës të zgjedhjes së këtij problemi. Energjetika është një nga çështjet e famshme të proklamuar nga Qeveria për të cilën nuk u bë qap e mos të flasim për hapa. Problemi energjetik në aspektin menaxheria e ka një adresë kjo është adresa e teshës Qeveri, përkatësisht Ministria e Energjetikës dhe e Minierave, KEK-u dhe UNMIK-u. Sado që ministri u mundua ta hedhë fajin dikund tjetër. Nga ana tjetër, problemi energjetik duhet shikuar jo si i shkëputur, por në tërësinë e tij duke filluar ndoshta nga konstatimi i rezervave të resurseve energjetike siç është ligniti në Kosovë. Problemet në këtë drejtim pra janë zinxhirore prej nxirrjes së qymyrit deri tek gjenerimi e furnizimi i furnizimi i qytetarëve me rrymë.

Të nderuar deputetë, se problemet fillojnë nga minierat, po ua përkujtoj vetëm një skandal që ka ndodhur kohëve të fundit, ky skandal është përmbytja e një eskavatori në Mirash që përveç humbjeve tjera me miliona euro të zhytura, sa kushton rotorori ka vështirësuar seriozisht heqjen e sterilit apo zbulimin e qymyrit e në vazhdimësi vështirësimin e furnizimit të termocentraleve me qymyr, dhe për këtë skandal nuk shkon askush në përgjegjësi as morale e as profesionale. Heshtet sikur nuk ka ndodhur asgjë, ndoshta dikush ka përfituar nga kjo përmbytje, sepse menjëherë kanë vërshuar kompanitë private për heqjen e sterilit, respektivisht zbulimin e qymyrit në KEK. Në miniera ka pasur edhe humbje të jetës së njerëzve për shkak të papërgjegjësisë profesionale të kompetentëve atje dhe për ironi ka ndodhur e kundërta, përgjegjësit e skandaleve janë avancuar në pozita më të larta menaxheriale.

Nga ministri u përmend strategjia për të cilën ne si grup parlamentar nuk e kemi votuar dhe i kemi arsyet për shkak që qasjes së gabuar nga ana e saj lidhur me këtë problem. Në qoftë se do t'i referohemi dokumentit të Ministrisë së Energjetikës dhe Minierave, politikat për tërheqjen e investitorëve strategjik në sektorin energjetik në të cilin dokument që në fillim thuhet se po citoj: “mungesa e energjisë në Kosovë në planin afatshkurtër dhe afatmesëm mund të tejkalohet vetëm me rehabilitimin e disa njësive të Termocentralit “Kosova A” ose nga importet” realiteti flet ndryshe. Siç e cekëm më lartë problemet janë më të thella. Ekzistojnë edhe në furnizimin e TC-ve me qymyr, do me thënë minierat vazhdojnë të jenë në gjendje katastrofave, dhe kësaj situatë natyrisht që nuk është i pafajshëm edhe UNMIK-u, po gjithsesi në bashkëpunim me Qeverinë. Kur them UNMIK-u unë nuk do ta cek AKM-në siç e thanë parafolësit e mi, por një segment tjetër të UNMIK-ut, siç është Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale,

në të cilin është një bord i minierave ku momentalisht ky bord nuk funksionon komplet, ngase dy anëtarët e tij ndërkombëtarë veç se e kanë lëshuar Kosovën pa paralajmërim. Problem në vete është forma menaxheriale nga ana e KEK-ut, aty i kemi dy borde: ai menaxheria dhe udhëheqës. Në bordin udhëheqës sigurisht që bashkëfajtores është këtu edhe Qeveria e cila i ka tre përfaqësuesit e vet dhe krejt në fund, kisha me e cekur se të gjitha këto diskutime projekt pro e kontra nuk i shterin të gjitha dobësitë dhe problemet që sot e ngarkojnë situatën energjetike, por nuk i kanë vënë në pah edhe të gjitha alternativat dhe mundësitë nga dalja nga ky kolaps energjetik. Ju faleminderit!

KRYESUESI I SEANCËS SABRI HAMITI- Ju faleminderit zonja Shala, fjalën e merr deputetja Brikenda Kryeziu

DEPUTETJA BRIKENDA KRYEZIU – Ju faleminderit z. kryesues.

Për shkak të çështjes e cila është mjaft me rëndësi shihet që edhe ky debat nuk konsumohet fare edhe pse shumë njerëz dhe shumë kolegë e debatuan. Së pari e falënderoj ministrin Çeku për informacionin mbi gjendjen energjetike të Kosovës, të cilën e ka ofruar. Flas në cilësinë e anëtares së Komisionit funksional në të cilin përsëafërmi kemi bashkëpunuar me Ministrinë e Energjetikës, si dhe me përfaqësuesit relevantë me Agjensionin Rregullator të Energjisë si dhe me KEK-un lidhur me gjendjen energjetike në Kosovë.

Fillimisht dua të them që Ministria , duke e parë situatën energjetike dhe krizën e tërësishme, për të bërë ndryshime, ka iniciuar ndryshimin e pakos ligjore e cila aktualisht ka kaluar nëpër Komisionin funksional , me qëllim të funksionalizimit sa më të mirë të energjetikës në të ardhmen.

Nga kolegët dhe parafolësit është diskutuar lidhur me Raportin edhe është potencuar çështja e planifikimit afatgjatë për të cilin nuk do të zgjerohem shumë, për shkak se rezultatet e këtij plani afatgjatë nuk do të shihet një perspektivë të afërt duke marrë parasysh që këto studime janë bërë në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Komisionin Evropian.

Çështja për të cilën më duhet të diskutoj shtrihet në disa pika duke filluar nga mihjet, çështje thelbësore dhe sfidë thelbësore aktuale është sigurimi i 6.8 milion tonëve tonë thëngjill të cilat nevojiten për të furnizuar me rrymë në proporcionin 5 me 1. Çështje e dytë: për shkak të mosfurnizimit KEK-u është i obliguar që të importojë rrymë edhe kjo njëkohësisht paraqet një sfidë të re , sepse importi i rrymës bazohet në përkufizimet e kapaciteteve transmetuese, të cilat nuk ofrojnë mundësi. Në të njëjtën kohë shfrytëzoj rastin të pyes ministrin Çeku në lidhje me përkufizimet e kapaciteteve importuese ,të cilat mund të ofrojnë rrymë si dhe humbjet që shkaktohen gjatë transmetimit të rrymës. Llogaritja dhe parashikimet janë bërë nga institucionet përkatëse për humbjen e rrymës së importuar,(është fjala për rrymën e importua). Çështje me rëndësi e cila vlen të theksohet është edhe pagesa e kategorizimit në kategoritë A, B dhe C, për të cilën mendoj se nuk është mjaft inkurajuese për qytetarët dhe nuk është kusht stimulues. Rast konkret mund ta paraqes edhe pse nuk është mirë të potencohen lokacione apo r qytete të ndryshme.Pra, deri me tash kjo është vërejtur në mbarë Kosovën, një situatë e tillë ekziston edhe në Gjakovë, në të cilën aktualisht aplikohet më shumë terr se rrymë në përgjithësi. Çështje e cila është mjaftë me rëndësi sa i përket inkasimit, vlerësoj se

janë identifikuar në bazë të bisedave që i kemi pasur me përfaqësuesit e KEK-ut si Komision, janë identifikuar daljet apo janë vendosur daljet për verifikimin e humbjeve dhe konsumit ilegal, i cili arrin në vlerën 50%. Është duke u punuar që përveç verifikimit dhe vendosjes së daljeve të verifikohen edhe të merren masa adekuate, masa disiplinore që këto çështje keqpërdorimet dhe çështjet e tilla të dalin para drejtësisë, sepse kjo është çështje për të cilën praktikisht duhet të punojë menaxhmenti i KEK-ut në bashkëpunim me ministrinë përkatëse.

Më lejoni të theksoj edhe diçka tjetër, të cilën z. Brajshori e ceku. Faktikisht është përmendur që një pjesë të madhe të përgjegjësisë lidhur me gjendjen energjetike në Kosovë e mbajnë KEK-u dhe menaxhmenti i KEK-ut. Si anëtare e Komisionit në bisedat që i kemi pasur me përfaqësuesit e KEK-ut e ndiej obligim që të informoj të gjithë kolegët deputetë që menaxhmenti i KEK-ut ka shprehur gatishmëri dhe kërkesë që krijojë një bashkëpunim shumë të ngushtë me Komisionin Funkcional për Energjetikë. Gjithashtu, vlen të ceket se kryetari i Grupit Parlamentar z. Alush Gashi ceku që, si propozim që Komisioni funksional do të ofrojë në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse dhe me institucionet e tjera relevante, do të ofrojë rekomandime për të cilat përfaqësuesit e Grupit Parlamentar që janë në këtë Komision do të jenë të gatshëm të bashkëpunojë në mënyrë të ngushtë me institucionet relevante për krimin e mundësive të reja dhe të opsioneve të reja për dalje nga kriza. Ju faleminderit!

KRYESUESI I SEANCËS SABRI HAMITI - Ju faleminderit zonja Kryeziu. Fjalën e ka deputeti Nazim Jashari

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Ju faleminderit z. kryesues i seancës, të nderuar ministra, ju përgëzoj për durimin. Të nderuar kolegë deputetë. Kisha pasur një fjalë falënderimi për Grupin Parlamentar të PDK-së që na e dha mundësinë që sot të diskutojmë për një problematikë jetike për ne si qytetarë të Kosovës, për qytetarë të privilegjum dhe për qytetarët e paprivilegjuar të Kosovës që janë shumica.

Është fatkeqësi që ky debat sot po zhvillohet në përfundim të vitit 2006, gati në vitin 2007, pra 7 vite pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe mbasi do t'i kishte pasur hije dy apo tri vitet e para, por në këtë fundviti, të diskutohet akoma për këtë problematikë edhe sot e kësaj dite. Do ta marr të drejtën të them se ka një peshë të njëjtë, siç e ka pasur thuaja në vitin 1999, posaçërisht sivjet, atëherë është kjo një dukuri brengosëse, sepse qasja ndaj kësaj problematike është një qasje e cila na bënë të pashpresë, d pikërisht për shkak të konceptit të Qeverisë. Me 3 dhjetor të vitit 2004 është konstituuar Qeveria, kemi dy vjet të konstituuar Ministrinë e Energjetikës dhe pas dy vitesh nuk e kemi as edhe një përparim në furnizimin e qytetarëve me energji elektrike. Kjo është esenciale, të gjitha të tjerat pastaj plane, projekte janë aspekte të cilat kanë të bëjnë me një të ardhme. Ne po flasim për sot edhe për gjendjen energjetike sot dhe kjo gjendje energjetike sot është, tash nuk ka tjetër term përveç katastrofike, sepse kur ke furnizim elektrik një orë po e pesë orë jo dhe prapë një orë po e pesë orë jo, unë nuk e di se si mund të quhet ajo. Ndërkohë që njerëzit, guximtarë në Kosovë, ata të cilët i kanë pasur mundësitë financiare e kanë marrë guximin që të hyjnë në projekte investive, ndërkohë që ata për shkak të pafuqisë dhe frustrimit na kontaktojnë, na marrin në telefon dhe përpiqen ta gjejnë një xhami ku të falen dhe t'i qajnë hallet e veta.

Situata është dramatike, mua më vjen shumë keq që shumica e deputetëve këtu nuk e kapën dimensionin e dramacitetit në tërë këtë problematikë. Ekzistojnë halle shumë, ekzistojnë probleme shumë, por ajo është një fakt që këto probleme nuk po vijnë duke u pakësuar, por më tepër po vijnë duke u shtuar, sepse procesi i tenderimit dhe procesi i investimit, procesi i ndërtimit të një termocentrali të rij C do të sjellë probleme të reja me këtë formë të qeverisjes dhe me këtë përgjegjësi në qeverisje.

Të nderuar kolegë deputetë, duhet të konstatohet këtu që KEK-u është një përmendore e paaftësisë sonë administruese, këtë duhet ta pranojmë. Është përmendore e paaftësisë administruese të shqiptarëve Kosovës dhe atë jo vetëm të nivelit të funksionerëve të KEK-ut, por edhe të nivelit politik. Edhe ne këtu si deputetë e kemi përgjegjësinë për shkak të moskrijimit të ndjeshmërisë të nevojshme për këtë problem. Duhet të ndalemi dhe ta kërkojmë strategjinë afatshkurtër nga ana e ministrit këtu nuk ka, nuk ka strategji afatshkurtër, ekziston strategjia afatgjatë. Ekziston Kosova C, ekziston projekti rreth Kosovës C, rreth fushës së Sibovcit por nuk kemi strategji afatshkurtër, dhe pa strategji afatshkurtër, siç e pranojmë edhe vetë zyrtarët nuk ka përmirësim afatshkurtër në furnizimi me energji elektrike. Do të kemi pra përsëritje vjet për vjet, sa here të vjenë dimri, do të kemi të njëjtën problematikë. Neve na ka ndodhur në pikë të verës të na godasë rrufeja dhe të mbesim me ditë të tëra pa energji elektrike.

Kam vërejtje në raportin e prezantuar këtu, sepse me asnjë fjalë ministri nuk i qaset edhe burimeve të tjera energjetike. Unë së paku jam munduar ta lexoj me kujdes, as nuk ka informacion për gazin, as nuk për naftën, pra të cilat janë projektet dhe cila është gjendja aktuale në furnizim me këto derivate, sepse këto janë procese të ndërlidhura një emergjent e shkarkon emergjentin tjetër, siç u tha më herët nga kolegët e mi. Në qoftë se ne si elitë politike nuk ia dalim të japim përgjigje afatshkurtëra dhe këtu, kjo varet shumë sigurisht nga i mbarë Kuvendi, po në rend të parë varet nga zyrtarët të cilët e kanë marrë të drejtën ta menaxhojnë ekzekutivin e Kosovës. Nuk mund të ndahet përgjegjësia në Kuvendin e Kosovës dhe thuhet që Komisioni parlamentar është ai i cili po punon, po bashkëpunon mirë me KEK-un, kemi mundësi bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me komisionet parlamentare, gjërat janë shumë të qarta. Janë Qeveria dhe është Ministria për Energjetikë që kanë përgjegjësitë dhe në qoftë se ne e kemi një përgjegjësi të këtyllë në KEK, një përgjegjësi përallorë tek udhëheqja e KEK-ut se punëtorët janë punëtorë, ata i marrin rrogat e veta të mjerueshme sikur krejt punëtorët e Kosovës, po flas se mund të jenë diçka më mirë, po në instancë të fundit punëtorët nuk shkojnë mbi 200 euro me rroga, të nderuar ministra, ani jepna informatë. Na nuk e kemi, po gazetata po na i bijnë informacionet për 4000 euro rrogë të drejtoreshës së KEK-ut, ndërkohë që në kushtet e mizershme në Kosovë të mos përpiqemi ta ndërtojmë një ekuilibër qeverisës, pra drejtësi elementare sociale. Të përpiqemi që KEK-un ta fusim në sistem, ne duhet t'i japim përgjigje kësaj pune. A është KEK-u pjesë e Kosovës apo nuk është pjesë e Kosovës, a jeton KEK-u me probleme të Kosovës apo nuk është pjesë e Kosovës, këto janë çështje fundamentale. Në qoftë se KEK-u jeton me probleme të Kosovës ai duhet t'i ndajë të mirat dhe të këqijat me popullin e Kosovës, jo t'i marrë vetëm të mirat, sepse këtu përmendëm 280 milion borxh që qytetarët ia paskan KEK-ut, por nuk u përmendën që 300 milion e më shumë euro i ka KEK-u borxh ndaj Buxhetit të konsoliduar të Kosovës që po ashtu mbushet nga qytetarët e Kosovës, kështu del që KEK-u i ka borxh që qytetarëve të Kosovës e jo qytetarët e Kosovës KEK-ut. Pra, çështja është që ky luks dhe kjo ndjenjë për prishje të parës në KEK duhet të

ndryshohet, dhe kjo nuk mund të ndryshohet nga ne që jemi në opozitë, kjo mund të ndryshohet nga ju dhe ju e keni atë përgjegjësi. Sigurisht mund ta kërkon ndihmën tonë po që se nuk mundeni vet, por nuk keni kërkuar asnjëherë deri sot, përkundrazi, ne e kishim me rastin e ndërrimit të drejtorëve. Njëkohësisht pat ndërrim të drejtorit në KEK dhe ndërrim drejtori në PTK. Ne po i shohim efektet e ndërrimit të drejtorit në PTK menjëherë, nuk po them situatën më të mirë definitivisht, mirëpo efektet e ndërrimit po i shohim, kurse efektet e ndërrimit në KEK as nuk po paralajmërohen. Kjo është e keqja e madhe dhe kjo duhet të merr udhë nga ky Kuvend. Ne jemi përfaqësues të interesit të qytetarëve edhe KEK-u është megjithatë pasuri pavarësisht që është korporatizuar është pasuri e Kosovës edhe është pasuri e qytetarëve të Kosovës dhe nuk mund të jetoj jashtë këtij sistemi, për ndryshe mua KEK-u gjithmonë ma asocion një metaforë të një aeroplani që fluturon dhe që e ka një vrimë në dikund karrocerinë e tij, dhe ai aeroplan me atë vrimë do të fundoset me siguri, edhe Kosova me këtë KEK në formë çfarë është do të fundoset me siguri. Prandaj, duhet të marrim masa një orë e përpara që atë vrimë ta mbushim, dhe unë nuk po e shoh që kjo qeveri dhe ky ministër është kah harxhon energjinë në mbushjen e asaj vrime, përkundrazi është fokusuar në Kosovën C, është fokusuar me tërë energjinë e veta në fushën e Sibovcit për arsyet që mund të jenë edhe prej atyre që përfolën nëpër nëpër popull se kanë blerë prona zyrtarët e ndryshëm nga ana e ndryshme në Sibovc dhe dëshirojnë ta materializojnë, ta evoluojnë blerjen e atyre provave në Sibovc, kurse me problemet e përditshme, këto probleme të cilat janë praktike dhe esenciale për qytetarët e Kosovës, për ata njerëz që kanë guxuar të hyjnë në prodhim në Kosovë me këto probleme nuk po merren. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI I SEANCËS SABRI HAMITI - Faleminderit z. Jashari, kolegë të nderuar, tash është fundi i këtyre diskutimeve të deputetëve. Më lejoni që unë nga ky vend ti them edhe vet nja dy- tri fjalë - mendoj që diskutimet për fat jo shumë të mirë edhe këtu u bënë më tepër politike se sa profesionale. Unë kam menduar që në diskutimet të tilla për rrymë edhe për prodhim të saj e kanë të drejtën të flasin ata që i njohin këto probleme e jo ata që donë me bë projekte sociale, por ky është Kuvendi dhe është e drejta e tyre.

Ajo që mua më ka bërë përshtypje shumë është një fjalor ekstrem për dhe kundër, taman fjalor tepër i ngjyrosur emocionalisht, i cili zakonisht nuk të lenë me pas arsyen e shëndoshë, ndërsa jeta është krejt jeta në mes të atyre dy ekstremeve: mohimit total dhe pohimit total. Mua nuk më pëlqejnë shprehjet katastrofike kaq të përdorshme dhe pa shpresa, po ju them nuk më pëlqejnë, sepse merrne fjalorin, kqyrne se çka është katastrofë kuptimi i saj. Ju do ta shihni që krejt pa funksion po përdoret se katastrofa është d.m.th. si figurë po por si kuptim jo, si figurë njeriu thotë e përsëritë dy here thotë po e përsërisë 100 here ajo është figurë, kuptimi katastrofës dhe kriza me një veprimtari nuk janë njësoj. Tutje, të lutem shumë, unë ju kam dëgjuar kujdesshëm ka 10 minuta secilin. Unë po diskutoj si deputet, ka nevojë me e shpreh qëndrimin. **Tutje**, unë mendoj që KEK-u me thënë ndërmarrja që e prodhon rrymën në Kosovë, nuk është vetëm një fabrikë, po tradicionalisht edhe pas luftës është një institucion edhe politik edhe social. Unë, nuk dëgjova këtu për këta faktorë që janë përcaktues për KEK-un as nga Ministria as gjithë deputetët e nderuar. E dimë shumë mirë të gjithë edhe

Qeveria, kjo e tashmja dhe ajo menjëherë pas lufte dhe ajo e Bajram Rexhepit, që këto dy elemente janë fundamentale të KEK-ut. Edhe qeveria e tashme, si dhe të gjithë deputetët besoj që e dinë shumica dhe ata që punojnë në KEK edhe më mirë se unë, prandaj ky diskutim nuk shkoi andej. Unë e di që është problem edhe politik edhe social edhe prodhues, po këto probleme sigurisht në një seancë nuk mund të zgjidhen. Unë, dua vetëm t'ua kujtojë edhe një problem, sepse e mbaj në mend që ky Kuvend edhe një here në mënyrë shterruese ka biseduar për KEK-un, dhe mund t'ju them që kemi bërë rekomandime dhe rekomandimet themelore të këtij Kuvendi kanë qenë që KEK-un ta menaxhojnë vendasit një prej pikave themelore, dhe ju e dini shumë mirë që pas një jave KEK-u i është dhënë një ndërmarrjeje të huaj që të qeveriset me 7 milion pagesa, mos të harrojmë se shpejtë po i harrojmë sendet, tek tash është prova që ajo farë ndërmarrje menaxhuese po shkon. Këto janë evidencat, këtu janë edhe njerëzit që i kemi hartuar bashkë ato rekomandime, do me thënë qeveritë kanë shkuar koftra rekomandimeve të Kuvendit. Pse kanë shkuar e dinë ato, këtu i kemi edhe disa ministra të asaj qeverie atëherë në sallë bile disa edhe folën.

Unë, veç për përkujtesë i thash dy tri fjalë, unë nuk dua të flas tutje. Fjalën e ka më së pari ministri i Ambientit më është lutur shkurt, të lutem sa më shkurt, masandej ministri i resorit Masandej e merr fjalën grupi që ka paraqitur kërkesën për diskutim.

Urdhëro z. Ministër!

ADRIAN GJINI – MINISTËR – Ju faleminderit i nderuar kryesues! Vetëm tri ose katër fjali për ato që u përmendën që kanë të bëjnë me mjedisin. Besoj se ministri Çeku do të flas pak për Hadën.

Çështja e hirit u përmend nga deputetja e ORA-s Ka filluar projekti i cili është kërkuar nga Ministria e Mjedisit, i cili financohet nga Banka Botërore për largimin e hirit i cili është deponuar nga “Kosova A”. Projekti është në zhvillim e sipër. Mjetet janë ndarë, shpejt do të shihen rezultatet.

Çështja e konsideratave mjedisore gjatë gjithë projektit të Termocentralit “Kosova C” ka qenë pjesë përbërëse unë, edhe vetë jam në Komitetin drejtues të projektit. Gjithë investitorëve përmes tenderit ju është kërkuar që djegia e lignitit në Kosovë të bëhet sipas standardeve më të larta ndërkombëtare, që do të thotë ato që lejojnë sot ato standarde, Sot lignit digjet pastër. Çka do të ndodhë me termocentralet C në momentin që do të vihen në funksion, ndotja në Kosovë do të ulet diku për 95% për shkak se do të eliminohen termocentralet ekzistuese. Të gjitha shifrat që i dhatë ju, janë shifrat të sakta të cilat janë nxjerrë edhe para vitit '98 do të thotë atëherë kur të gjitha blloqet A dhe B kanë punuar, që do të thotë ndotja ka qenë disa here më e madhe. E kam thënë një herë, po them edhe një here nuk është kurrfarë ristëie për qytetarët e Kosovës as të Kosovës Qendrore e as viseve të tjera me ua përmendur se sa ndotës është KEK-u, përkundrazi të gjithë ata që jetojnë rreth e rreth KEK-ut janë dëshmitarë se në disa prej blloqeve janë vendosur filtrat elektrolitik dhe ka filluar që të ulet niveli i ndotjes në krahasim me atë që ka ekzistuar më përpara. Këto i kam përsëritur shumë shpesh. Edhe një çështje tjetër: të gjitha veturat që parkohen sot në Qendrën Klinike Universitare të njëjtat do të futen në parking z. mjeke, do të thotë nuk do të shtohet numri i veturave, por do të hiqen prej Qendrës Klinike, do të largohen, për atë kritikën që e dhatë për komunën, nuk qëndron se do të rritet ndotja por do të ulet përkundrazi dhe do të ikin prej

parkingjeve të cilat sot ekzistojnë ashtu, ashtu por janë jo formale edhe mendoj se të tjerat do t'i thotë me siguri Ministri Çeku. Ju faleminderit!

KRYESUESI I SEANCËS SABRI HAMITI – Fajalën e ka Ministri Çeku.

ET'HEM ÇEKU MINISTËR – Ju faleminderit për shumë këshilla dhe kritikën e mira të na i jep për funksionalizimin e punës së Ministrisë. Unë i çmoj të gjitha ato, nuk dua të hyjë në polemikë për disa ato që nuk qëndrojnë fare për hir të korektësisë, kolegjalitetit nuk dua t'i keqpërdori, nuk dua t'i them tani se ka shumë çka absolut që nuk qëndrojnë, dhe dua të them me gjithë përkushtimin tim, dua t'i shërbejë punës dhe mandatit që ma ka dhënë Parlamenti i Kosovës dhe qytetarët e Kosovës.

Në qoftë se dikush nga deputetët e shtron çështjen se a kam unë prona në minierën e Sibovcit – ftoj Grupin, Komisionin që të hulumtoj të gjithë pasurinë, zhvillimet, të hyrat dhe të dalurat të Ministrit Çeku dhe të familjes së ministrit Çeku që do të ishte e njëjta edhe për ata që ngrisin shpifje dhe akuza të rënda qofshin për korrupsion dhe qofshin ato të tjera. I ftoj të bëjnë hulumtimet detale dhe jam i gatshëm të bashkëpunoj me rendin dhe drejtësinë për të gjitha ato edhe për pjesën e burgut tim, luftës sime dhe gjithçka që kanë bërë qytetarët e Kosovës dhe që jam i gatshëm t'i bëjë çdo herë për qytetarët e Kosovës. E njëjta gjë do të vlejë edhe për ata të cilët ndoshta duhet të dinë nga si dhe ku janë në zhvillimet e tyre, por kjo është çështje që unë i bëjë ftesë Parlamentit të Kosovës që jam shumë i hapur dhe transparent si ministër, si familje, si gjithçka që të hyjnë në proces të afërt. Sa i përket zhvillimit në fushën e energjetikës unë, e kam përpara një strategji që ju e keni aprovuar: afatmesme dhe afatshkurtër dhe kur Parlamenti i Kosovës e ndërron strategjinë, e hekë këtë dokument, ne jemi të gatshëm të ndërrojmë politikën. Derisa ky dokument është i aprovuar nga Parlamenti i Kosovës. Unë do ta respektoj dhe do të punoj në princip të aprovimit që ka të bëjë. Ne politikën tona janë për përdorimin e lignitit për përdorimin e burimeve tjera të ripërtëritshme siç janë hiroja dhe tani janë duke u bërë studime të përdorimit të energjisë alternative përmes erës, por studimet që kanë bëjnë me gazin mendojmë që politikisht edhe ekonomikisht janë tërësisht të paqëndrueshëm dhe ne si Ministri nuk e kemi një mandat të tillë të bëjnë politika sa i përket përdorimit të resurseve dhe mundësitë e përdorimit të resurseve në këtë drejtim.

Më lejoni vetëm edhe në disa çështje që duhet t'i ngritë. E kemi mbështetur rehabilitimin të “Kosovës A”, e kemi mbështetur, e din Komisioni Parlamentar e ka ftuar AKM-në dhe institucionet tjera nuk iu kanë përgjigjur ftesës, e vetmja Ministria jonë iu ka përgjigjur ftesës që ne brenda mundësive që i kemi të raportojmë, të pranojmë përgjegjësitë, t'i pranojmë obligimet dhe t'i pranojmë detyrat. I kemi mbështetur them edhe një herë dhe e mbështesim deri në momentin kur duhet të ndërtojmë kapacitete të reja.

Vetëm disa shifra në aspektin e çështjeve sociale. janë 100 mijë konsumatorë jashtë sistemit të kontrollit, sepse një pjesë e madhe e tyre janë nga rajonet e shkatërruara nga lufta që nuk iu kanë vendosur orëmatësit, nuk ka pasur mundësi KEK-u me i ble dhe për një kohë të gjatë ne jemi munduar dhe i kemi përkrahur që ata qytetarë mbas sanimit të gjendjes të fillojnë vendosja e orëmatësit dhe edhe orëmatësit elektrik, të cilët mundësojnë sado kudo zvogëlimin e keqpërdorimit të energjisë elektrike. Janë diku 1.3 miliardë kilovat orë elektrike që drejtpërdrejtë – indirekt shkojnë te këta konsumatorë

apo nga KEK-u, marrin në formë të ndryshme diku 600 mijë banorë. Vetëm për rastet sociale janë 34.307 rate sociale që marrin nga KEK-u energji, më falni 34.307 familje që marrin energji nga KEK-u aq sa ka, aq sa mundet KEK-u me ju dhënë. Unë tani kam dal në pozita për ta mbrojtur disi KEK-un, sepse e konsideroj se është një kompani e cila edhe për një kohë të gjatë ka përgjegjësinë e furnizimit të qytetarëve me energji elektrike, po ashtu janë 7000 e diçka punëtorë, të cilët sigurojnë të ardhurat e tyre në atë ndërmarrje, prandaj i kemi edhe elementin ekonomik por edhe elementin social. Kam thënë disa here – po të mundet Parlamenti, Qeveria ta marrin tërë përgjegjësinë e menaxhimit dhe ne të kemi kompetencë të vendosim drejtorë në nivelin ekzekutiv, Bordin e drejtorëve, ju lutem ne jemi aksionar atje, ju thoni se keni dhënë 400 milion, Jakupi e din, të gjithë e dinë 400 milion i keni dhënë për KEK-un ne institucionet vendore, 400 milion i kanë dhënë ndërkombëtarët për afërsisht të cilat nuk i kemi menaxhua ne, e dimë shumë mirë, nuk kemi mundur të ndikojmë në politikat e menaxhimit. Sot mund të them nuk dua të jem aksionar në KEK, jo ne duhet të jemi aksionar jo vetëm në KEK por në të gjitha kompanitë publike sepse kemi investuar, ashtu siç po kërkojmë me qenë edhe në Trepçë aksionar se i kemi investuar mbi 60 e diçka milionë në Trepçë, pak dhe shumë janë 60 milion, janë 400 milion atje, janë në hekurudha, në kompanitë e ujërave, në kompanitë e mbeturinave dhe janë taksat e qytetarëve të Kosovës të cilët ne duhet si institucione si qeveri. Prandaj, në qoftë se marr mbështetjen e Kuvendit për të ndihmuar në transformimin e përgjegjësisë, në krijimin e bordeve vendore, me kosovarizimin e plotë të bordeve. Unë e kam ftuar edhe komisionin funksional që të jetë në borde, dhe atëherë të shtrojmë ne se a e kemi realizuar tremujshin e parë objektive, jo gjashtëmujshin por tremujshin e parë objektive jo gjashtëmujshin, por tremujshin e parë e objektiv afatmesme të cilat i ka aprovuar Parlamenti i Kosovës. Sa i përket asaj se unë dua të tërheq dhe të marrë përgjegjësi për ndërrimet ligjore. Ne ia kemi drejtuar një kërkesë komisionit funksional, është diskutuar dhe e shohim nëse Parlamenti e sheh të arsyeshëm.

Unë edhe një herë do të kërkoj që të na mbështetni në infrastrukturën ligjore dhe e di se e keni atë gatishmëri, kemi bërë edhe rekomandime në bartjen e kompetencave dhe përgjegjësisë tek institucionet ose te qeveria dhe të mbështetet që përmes rendit dhe djretësisë të bëhet eliminimi i keqpërdorimeve në fushën e energjisë elektrike. Sa here që ne nuk mundemi ta bëjmë këtë e kemi rënien e inkasimit në KEK, sa herë kemi rënie të inkasimit ne jemi të detyruar dashtë apo pa dashtë për me nda për blerjen e energjisë, vetëm sivjet kemi blerë diku rreth 11 milion euro energji elektrike të cilët fare ne as që kemi marrë pjesë as që jemi pyetur, as që jemi konsoliduar se si të sillet, prandaj hapi i tretë është mbajtja në prodhim të blloqeve të Kosovës A derisa të kemi kapacitetet e reja ndërtuese, të cilat presin të fillojnë punën diku në fund të vitit 2008, i cili bllok do të jetë diku mes 800 dhe 1100 megavat për fazën e parë të prodhimit të energjisë elektrike. Unë edhe një herë do të jam shumë i hapur, faleminderit për të gjitha ato që m'i keni thënë. Jam shumë i gatshëm ti pranoj rekomandimet e Komisionit, por duhet të distancohem shumë, shumë, shumë nga të gjitha ato që është folur dhe është format e keqpërdorimeve dhe forma të tjera që ndonjëherë janë lidhur dhe janë atribuar si siç ishte rasti i fundit dhe nuk ishte një rast i cili duhet lajmë anash. Ju faleminderit.

KRYESUESI I SEANCËS SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. ministër. E ftoj përfaqësuesin e Partisë Demokratike të Kosovës që e ka kërkuar këtë debat, pra shefin e Grupit Parlamentar z. Jakup Krasniqin.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Ju faleminderit z. kryesues. Mendoj që kërkesa jonë që kjo çështje të del në rend të ditës, së paku ta kryejmë një obligim ndaj zgjedhësve në një masë mendoj që po jep rezultatet e veta.

Problemi i energjetikës së Kosovës është i vjetër. Mendoj se është thënë nga shumë diskutues dhe gjithashtu ne mendojmë se për të dalë nga kjo gjendje nuk është e mundur vetëm me anë të një strategjie afatgjatë që na e ka ofruar Qeveria, përkatësisht Ministria për Energji dhe Miniera.

Për të dalë nga gjendja në të cilën është Kosova tani edhe në këtë dimër, do të duhej Ministria përkatëse, ndoshta edhe me angazhimin e gjithë kabinetit qeveritar të na ofronin një strategji emergjente për të dalë nga kjo krizë e energjisë. Ne kohë më parë e kemi mirëpritur strategjinë e Qeverisë edhe të Ministrisë sidomos të Qeverisë të tri-reve, të energjisë, të edukimit dhe të ekonomisë, por jemi të bindur se pa e realizuar strategjinë e parë të es së parë të energjisë nuk mund të realizohen as strategjitë tjera, të dyerve tjera. Grupi parlamentar i Partisë Demokratike kohë më parë ka pasur vërejtjet për strategjinë e energjetikës të ofruar nga Ministria për Energjetikë dhe Miniera, por konsideroj se vërejtjet e Grupit parlamentar nuk janë marrua parasysh. Përsëri ne kemi pasur dhe i kemi vërejtjet tona me mënyrën se si po tentohet të veprohet me privatizimin e minierave të lignitit, të Sibovcit dhe të minierave tjera. Kjo është një fakt se institucionet e Kosovës, Qeveria e Kosovës edhe në mandatin e dytë nuk ka arritur ta hartoj në strategji të interesit nacional dhe nuk e di fare se cila vërtetë është strategjia e interesit nacional e Qeverisë dhe e Institucioneve të Kosovës.

U fol shumë se në Qeverinë e kaluar është pranuar një kompani për menaxhimin e KEK-ut e Irlandës. Në fakt atë kompani e ka sjell AKM-ja dhe Qeveria e atëhershme veç sa e ka dhënë pëlqimin e saj se është kërkuar që edhe ajo ta jap një pëlqim. Mirëpo këtu mu më shqetëson një praktikë tepër inferiore e institucioneve të Kosovës edhe ndoshta edhe e deputetëve edhe e qeverisë që kemi ndaj faktorit ndërkombëtar. Po e them se asnjë qeveritar pa marrë parasysh përgjegjësitë që i ka për çështjet e caktuara, me gjithë dëmet, me punën apo me mos punën e vet i ka bërë Kosovës në asnjë rast nuk janë në gjendje të japin përgjegjësi politike – morale se për ligjore mos të flasim. Do të thotë, njerëzit që dretonin institucionet e Kosovës sikur po krijonin një praktikë se janë të gatshme të largohen nga postet pozitat që i kanë zënë vetëm nëse e kërkojnë zyrat apo administrata e UNMIK-ut, kjo të nderuar deputetë është shqetësuese. Unë mendoj që janë larguar një kryeministër, është larguar edhe kryetari i parlamentit nga pozita, por jo pse e ka ndie përgjegjësinë ata, jo pse ne e kemi ndie përgjegjësinë për paaftësinë e tyre, por pse është kërkuar diku tjetër, është kërkuar jashtë nesh, kjo është një praktikë...

NDËRHYRJE E KRYESUESIT – z. Krasniqi nuk je në temë tash, kthehu në temë të lutem të seancës

JAKUP KRASNIQI - VAZHDIM - E pranoj dhe u ktheva në temë. I thashë këto z. kryesues për të mos folur gjatë, por për ta thënë një përvojë timen. Unë kam qenë në

bord gjatë mandatit të kaluar, jam tërhequr për disa arsye dhe unë mendoj se ato arsye kanë mbetur edhe sot e kësaj dite.

Unë mendoj se sa i përket A,B,C Ministria përkatëse dhe menaxhmenti i KEK-ut duhet të heqin dorë nga kjo formë për shkak se kyçja e shfrytëzuesve të rrymës është individuale, kurse dënimi po bëhet kolektiv. Kjo politikë e ndjek Qeveria krijon hapësirë që i dëshiruari të privilegjohej ndërsa i padëshiruari të ndëshkohet, andaj kjo politikë mendoj se duhet të hiqet. Tjetër, u tha nga të gjithë 50% e rrymës nuk regjistrohet. Pse është kjo? Pse ndodhë kjo? Kjo do të thotë se në KEK si nga menaxhmenti si nga Bordi politik si nga Qeveria që më tepër se 7 vite nuk janë ndërtuar kapacitete për menaxhimin dhe administrimin e KEK-ut dhe pa krijuar kapacitete për menaxhim dhe administrim mos të presim përmirësim të KEK-ut.

Ne mendojmë se Qeveria për të dalë nga kjo gjendje i propozojmë Qeverisë ta hartojë strategjinë e interesit nacional, të harton një strategji emergjente që ne të kemi rrymë, që menaxhmenti i ekzekutivit të KEK-ut të ketë ndryshime rrënjësore dhe mos të sillen në dsarejtimin e KEK-ut njerëzit që deri me tani janë sjellur dhe nuk kanë bërë asnjë punë të mirë aty, nuk kanë bërë asnjë ndryshim dhe të bëhet bartja e kompetencave të plota dhe të përgjegjësive nga ndërkombëtarët te vendorët. Të ketë një menaxhim ndryshe të kapitalit njeri, unë mendoj se gjatë këtyre nuk është menaxhuar mire dhe si duhet me kapitalin njeri. Mendoj duhet një menaxhim ndryshe për kapitalin para. Në KEK kanë hyrë shumë para dhe nuk dihet se kah kanë shkuar ato, pa ndryshuar menaxhimin e kapitalit para, unë nuk mendoj dhe nuk shpresoj se ne do të kemi rrymë. Menaxhimi më i keq i mundshëm në KEK është bërë në miniera dhe Ministri e dinë mirë se në miniera drejtor i njëjti drejtor që ka menaxhuar jo vetëm 7 vite pas luftës, por edhe më herët. Këtu ka edhe konflikt të interesit se i biri i tij është dhe i banë politikat e Ministrisë së Energjisë dhe Minerave. Mendoj që kjo praktikë e menaxhimit të tillë sidomos me miniera duhet të eliminohet. Pa eliminimin e saj, e kësaj politike të menaxhimit të ndjerave nuk do të ketë energji në Kosovë dhe kësaj duhet shtuar pa një menaxhim ndryshe të termocentraleve ku janë harxhuar mjetet më të mëdha financiare nuk mund të ketë ndryshim dhe nuk mund të ketë energji për qytetarët e Kosovës. Mendoj se pa i bërë këto ndryshime është vështirë të presim atë po e dëshirojmë.

Krejt në fund, unë kisha dëshiruar si shumë të tjerë që i thurën lëvdën Ministrisë për materialin, një letër që na e ka sjell. Edhe unë do të kisha dëshiruar ta lavdërojë për këtë punë dukje, por nuk e di si do të më kuptonin qytetarët që janë pa rrymë elektrike. Ju faleminderit!

KRYESUESI I ESEANCËS SABRI HAMITI – Faleminderit z. Krasniqi. Sipas rregullit diskutimi për këtë temë ka mbaruar.

Unë vetëm ju njoftoj kolegë të nderuar se nesër në orën 10,00 do të vazhdojë punën Kuvendi.

Rendi i ditës është i ditës së kaluar, do të vazhdojmë nga pika 4 me Shqyrtimin e dytë të projektligjeve dhe me shqyrtimin e parë të projektligjeve.

Pra ,nesër në orën 10,00 me agjendën e vazhdojmë mbledhjen e djeshme, ndërsa sonte kryetari i Kuvendit ju fton në orën 6,00 në një takim koktej për fundviti. Ju faleminderit.

Mbledhja përfundoi në orën 17:30 minuta.